ExLibris

ISSN 2708-4876

E PËRJAVSHME LETRARE KULTURORE

Themelues • Kryeredaktor BUJAR HUDHRI

E SHTUNË, 14 GUSHT 2021. NUMËR 143 VITI IV I BOTIMIT. ÇMIMI 50 LEKË. WWW.EXLIBRIS.AL EMAIL: INFO@EXLIBRIS.AL BOTIM I ONUFRI SHPK

Onufri nxjerr sot në shitje librin e ri me kujtime të birit të shkrimtarit të famshëm Gabriel García Márquez

"LAMTUMIRË GABO DHE MERCEDES"

Këto faqe janë kronika më intime dhe më e ndershme e ditëve të fundit të një gjeniu, e shkruar me një saktësi të admirueshme dhe me largësinë e duhur të një dëshmitari të jashtëzakonshëm: vetë Rodrigo Garcia

Kujtimet e birit për humbjen e prindërve të tij dhe fundin e një epoke në letërsinë kolumbiane

DASHURI NË KOHËRAT E FAMËS

Nga Boyd Tonkin

Wall Street Journal



SALI BUTKA, POETI I MAJAVE TË GRAMOZIT

Nga Bardhyl Londo

Emrin e Sali Butkës, e kisha takuar shumë më parë se të kuptoja atë që marr vesh sot nga jeta, bota, letërsia, poezia, lufta dhe paqja, agresioni dhe mbrojtja kundër tij, atdheu dhe krahina, fqinjësia dhe shovinizmi, paqja dhe orekset grabitqare të pushtuesve. Sali Butka kishte ardhur tek unë ashtu siç vijnë gjithë luftëtarët zulmëmëdhenj: diçka midis realitetit dhe legjendës. (fq. 6)

Libri "Lamtumirë Gabo dhe Mercedes"

DY BIJ, DY RRËFIME PËR DY DASHURI

Andreas Dushi (fq. 3)

PËRBALLË ZIJA ÇELËS, NJË SHKRIMTARI TË MADH

Nga Ali Aliu

Pikërisht ky ngjyrim shpirtëror i letërsisë e bën krijimtarinë e Zija Çelës të jetë e dallueshme ... (fq. 8)

BOTA E MAGJISHME E PIKTORIT FATMIR HAXHIU

Nga Enver Kushi

Fatmir Haxhiu, nga të rrallët piktorë shqiptarë, ndoshta dhe i vetmi, figurën e kalit e ka të pranishme në shumicën e tablove kompozicionale të tij dhe në shumë (fq.9)

Libri për Kadarenë i Bajram Sefajt, "Përballë Kolosit"

KONTURET E PAKRYERA PËR NJË VEPËR TË PËRKRYER

Nga Shaip Beqiri (fq.11)

Premisë për interpretimin e prometeikes në letërsinë shqipe

MOTIVI ROMANTIK I MALIT

Nga Skënder Karriqi (fq.14)

Libri "Britmat e muzgut modern" të Marash Mirashit

NEOREALIZMI I NJË POETI MODERN

Nga Emrije Krosi (fq. 15)

TONY MORRISON

TË SHKRUARIT ËSHTË E VETMJA GJË PËR TË CILËN JAM KRIJUAR (fq.20)

Intervistoi: Branka Bogavac

Dhjetë vjet më parë u nda nga jeta përkthyesi i shquar Ramon Sanchez

SPANJOLLI QË E DESHËM TË GJITHË

Nga Mira Meksi

(fq.22)

BIBLIOTEKË

Arben Ndreca (fq. 16)
Vorba e Eumeut

AlisaVelaj (fq. 18)
Epikë për një dre

Istref Haxhillari (fq. 10)
Flutura e nënës sime

Stefan Martiko (fq. 17)
Trishtimi në heshtje

Shqiptar Oseku (fq. 19)
Zgjidhja më e mirë

Osamu Dazai (fq. 19)
Në pritje

RISITË QË SOLLI POEZIA E KADARESË

Nga dr. Jolanda Lila (fq. 5)

Kadareja jo vetëm zgjeroi kufijtë tradicionalë të poezisë lirike, ku përmes shprehjes së re theu konvenca të njohura artistike, por solli edhe elemente avanguardiste...

Roland Gjoza: poezitë – 14 libra

EGOJA DHE ALTEREGOJA E NJË POETI NË AMERIKË

(fq. 12)

12 tetor, 1982, mëngjesi kur u shpall Çmimi Nobel.

Fragment nga libri

"LAMTUMIRË GABO DHE MERCEDES"

Nga Rodrigo García

Pjesën më të madhe të shkrimeve të papërfunduara të babait i shpëtoi mamaja fshehurazi tij, sepse ai ishte rreptësisht kundër tregimit apo ruajtjes së punëve të pambaruara. Gjatë fëmijërisë, na thërriste shpesh mua dhe vëllain në studion e tij dhe na thoshte të uleshim përtokë për të grisur versione të tëra të mëparshme të librave të tij dhe për t'i flakur në plehra. Jam i sigurt se kjo do të ishte një pamje e trishtuar për koleksionistët dhe studiuesit e veprave të tij. Shkrimet dhe biblioteka e tij i kaloi Qendrës Ransom në Austin, Teksas, ku ceremonia e hapjes së koleksionit e kënaqi mamanë pa masë. Të dyja familjet tona, imja dhe e vëllait, ishin të pranishme në të dhe nëna u lumturua në shoqërinë e nipërve dhe mbesave. Mbesat në veçanti e gëzonin pa masë dhe kjo i vinte, besoj, për faktin se kur nipërit e mbesat filluan të rriten, vajzat vazhduan të tregonin më shumë interes për shqetësimet e saj të përditshme dhe i ndiqnin problemet shëndetësore të saj më me vëmendje. Ajo u dhuronte çantat e saj të vjetra dhe bizhuteri, ndonjëherë me kaq bujari, saqë vajzat ngurronin t'i pranonin, ndonëse jo dhe aq shumë. Njëra nga vajzat e mia mendonte se i ngjante më shumë nënës dhe krenohej për këtë, por, nga të gjithë ne, mbesa ishte pa dyshim më e pranishme fizikisht në vitet e saj të fundit. Vajza tjetër ishte shumë e kujdesshme në kontaktet që mbante me të nga jashtë dhe tepër e dashur. Vetë gjyshja e sime mëje kishte qenë një figurë që bënte ligjin në jetën e saj, një matriarkë që e respektonin dhe i trembeshin të gjithë, dhe besoj se kjo ishte një arsye për dobësinë që nëna kishte për mbesat. Edhe djemtë e vëllait i donte, por ishte e mendimit se kur rriten djemtë mbyllen në botën e tyre dhe e pranonte këtë si fakt. Pa dyshim që këto janë vetëm teoritë e mia që, po t'i kish dëgjuar ajo, do të ish thartuar në fytyrë e do të më kish kthyer shpinën me nervozizëm.

Dy vjet pas vdekjes, hirin e babait e çuam në Kartagjenë. E vendosëm brenda piedestalit të një busti (që i ngjante në mënyrë të çuditshme), në oborrin e brendshëm të një ndërtese koloniale e cila tani ishte e hapur për publikun. Ishte një ceremoni zyrtare, e paraprirë dhe e pasuar nga një pritje e hapur me kokteje në shtëpinë e prindërve, që ishte një rit i detyruar. Sikundër pritja e parë me kokteje në kohën e vdekjes së babait, edhe kjo vazhdoi për disa ditë, por, meqë atmosfera ishte më e gëzueshme, mamaja mori masa që të kishte muzikë deri natën vonë. Ato ditë më janë dukur disi emocionuese dhe ndoshta pak të lodhshme, por, për çudi, në atë kohë nuk m'u dukën të tepruara. Gjithçka ishte plotësisht e përballueshme. Në ditën e fundit të qëndrimit tim, në mëngjes herët shkova tek oborri për t'i hedhur edhe një sy të fundit hirit. Ishte diçka e pabesueshme të mendoje se hiri do të ishte aty, se do të ishte aty për një kohë tepër të gjatë, mbase shekuj, shumë më gjatë sesa të gjithë të gjallët e sotëm do të kishin ikur nga kjo jetë. Udhëtimi për në aeroport ishte i trishtuar dhe njëzet e katër orë pasi mbërrita në Bogota u shtrova në spital me një infeksion të fshikës së urinës dhe një pikë gjaku të mpiksur në këmbë. Mbase ditët e mëparshme kanë qenë më të lodhshme sesa më ishin dukur.

Kanë kaluar vetëm tre muaj që nga ikja e nënës dhe habitem se sa shpejt figura e saj është rritur në sytë e mi. Nuk mund të kaloj pranë një fotografie të saj pa ndaluar dhe pa e vështruar. Fytyra e saj më duket më e dashur dhe më e bukur se më parë, edhe në moshë të shkuar. Duke qenë një njeri që gjatë gjithë jetës vuajti nga ankthi (ndoshta pa e kuptuar), ajo ishte gjithsesi jashtëzakonisht e aftë të gëzohej dhe të shfaqte një interes të pashtershëm për jetën në përgjithësi dhe për jetën e të tjerëve, në veçanti për jetën e babait. Ndjenjat që kam pasur për babain, me gjithë dashurinë për të, ndërlikoheshin nga fama dhe talenti i tij, duke e shndërruar atë njëherazi në disa persona, të cilët duhet të përpiqesha t'i shkrija në një të vetëm, duke përjetuar përherë emocione të ndryshme. Gjithashtu, të ndërlikuara janë edhe ndjenjat e lidhura me lamtumirën e gjatë, të dhimbshme, që ishte humbja e kujtesës së tij, dhe me fajin që ndonjëherë kënaqesha që për momentin mendërisht isha më i fortë se ai. Ndërsa ndjenjat që kam për nënën tani janë çuditërisht më të thjeshta. Kjo që them është diçka që terapistët i bën të ngrenë sytë me habi, por, megjithatë, është e vërtetë. Ajo i trembej shprehjes së madhe të emocioneve dhe në fëmijëri na nxiste që të mos e bënim veten kur kishim ndonjë hall. Por, me kohë, fillova ta kuptoja se kjo ishte diçka që ajo e kish trashëguar nga prindërit të cilët, me shumë gjasa, edhe vetë duhet ta kishin të trashëguar. Madje, ajo nuk e dinte që e kishte këtë ndjenjë dhe sa herë që i sugjeroja se do t'i bënte mirë të shkonte në terapi, përgjigjja e saj ishte e palëkundur: *No. No soy una histerica*. Jo. Nuk jam histerike.

Ndihem fatlum që munda ta kuptoja këtë kur ishte akoma gjallë dhe ta pranoja, kështu ajo çka më ka mbetur është vetëm afeksioni për të dhe dashuria për forcën jetësore që buronte prej saj. Ajo ishte e hapur dhe e fshehtë, kritike dhe shpirtmadhe, por rrëmujës i druhej. Mund të tregohej e sertë dhe gjykuese, por edhe falte shpejt, sidomos kur personi i hapte zemrën për hallet që kish. Atëherë ajo mbante anën e tij përgjithmonë dhe fitonte adhurimin e tij. Me mua dhe vëllain nuk e shfaqte dashurinë me gjeste fizike, por qëndrimi i saj tregonte dashurinë që kishte për ne, e cila me kalimin e viteve erdhi e u shtua. Personaliteti i saj kompleks pa dyshim duhet të ketë luajtur një rol në magjepsjen time pas grave gjatë gjithë jetës, veçanërisht pas grave me shumë plane, enigmatike, të cilat mendoj se, pa të drejtë, janë konsideruar gra të vështira.

Tani adhurimi im për prindërit është përforcuar. E pranoj se kjo perspektivë (disa do ta quanin revizionim) nuk është e pazakontë. Mungesa na bën të tregohemi më të dashur dhe të falim më shumë, duke e kuptuar se prindërit duhet të kenë pasur dobësitë e tyre, si gjithë të tjerët. Në rastin e sime mëje, duke pasur parasysh periudhën dhe vendin ku u lind, habitem se si erdhi e u bë personi që qe, duke ia dalë mbanë me sukses, ose edhe duke komanduar botën që suksesi i babait ua bëri të mundur. Ishte një grua e kohës ku jetoi, pa arsim të lartë, nënë, bashkëshorte dhe kujdestare e shtëpisë, por të cilën shumë gra më të reja se ajo, me jetë të rëndësishme dhe karriera të suksesshme, e admironin hapur, duke ia pasur zili guximin, qëndrueshmërinë dhe të qenët vetvetja. Miqtë e njihnin me emrin La Gaba, nofkë e mbështetur në nofkën e babait Gabo e, megjithatë, të gjithë ata që e njihnin besonin se nuk ish bërë tjetër, veçse një version më i madh i vetvetes.

Dy vjet para se të vdiste ishim në një restorant dhe mamaja më tha se pas saj, që kish qenë fëmija i parë, nëna kish lindur dy foshnja që kishin vdekur në foshnjëri. U çudita që nuk ma kish treguar këtë ndonjëherë. E pyeta nëse i kujtohej gjë dhe më tha po. E mbante mend mjaft mirë nënën me foshnjën

e vdekur në krahë. Përkuli krahun e majtë, duke më treguar se si e mbante. "Përse nuk ma ke treguar këtë më parë?" - e pyeta. "Sepse nuk më ke pyetur ndonjëherë", - m'u përgjigj. Ç'budalla! Pas njëfarë kohe e pyeta përsëri, i etur për të mësuar hollësi të tjera, por ajo ma mohoi që më kish rrëfyer një histori të tillë, por edhe se kishte parë ndonjëherë një motër apo vëlla të vdekur. Mbeta pa gojë. Nuk e kishte nga pleqëria apo nga demenca. Kujtesa e saj vazhdonte të ishte e hekurt. Unë këmbëngula. "Jo, nuk ka ndodhur ndonjëherë", - më tha, me një ton të padiskutueshëm. E lashë atë punë për momentin, por isha i vendosur t'i kthehesha përsëri në të ardhmen, me shpresë se ajo do të ndërronte mendje, por koha nuk më priti. Po ashtu, kalova pesëdhjetë vjet të jetës duke mos e ditur se babai nuk shikonte me qendrën e syrit të majtë. Këtë e mësova kur po e çoja te mjeku okulist dhe vetëm se e përmendi mjeku pas ekzaminimit. Do të doja të dija se si prindërit e mbanin mend veten të rinj, ose të kisha qoftë edhe një ide të vogël se si e shihnin vendin që kishin në botë në kohën kur jetët e tyre ishin të kufizuara në qytetet e vogla të fëmijërisë në Kolumbi. Çfarë nuk do të kisha dhënë për të ndenjur një orë me babain kur ishte një çapkën nëntëvjeçar, apo me nënën kur ishte një vajzë e gjallë njëmbëdhjetëvjeçare, kur nuk kishin si ta përfytyronin jetën e jashtëzakonshme që i priste. Dhe kështu, në kokë më rri vazhdimisht ideja se ndoshta nuk i njoha sa duhet dhe pa dyshim më vjen keq që nuk i pyeta më shumë për hollësi të jetës së tyre, për mendimet më të fshehta, për shpresat më të mira dhe për gjërat që i frikësonin. Ka të ngjarë që edhe ata të kenë ndier të njëjtën gjë në lidhje me ne, sepse kush është ai që i njeh plotësisht fëmijët e tij. Jam kureshtar të di se çfarë mendon im vëlla për këtë gjë, duke qenë se shtëpia është një vend shumë i ndryshëm për secilin prej banorëve të saj.

Unë dhe vëllai duhet të marrim një vendim për të ardhmen e shtëpisë. Neve na pëlqen shumë të vizitojmë shtëpitë-muze të shkrimtarëve dhe artistëve të së kaluarës dhe të njerëzve të tjerë të palumtur të suksesshëm të sojit të tyre, kështu që jemi më shumë për këtë gjë. Megjithatë, çuditem pak me veten që tregohem i gatshëm të hap dyert e shtëpisë së familjes për ta parë gjithkush. Ka të ngjarë të jetë një goditje e dëshpëruar ndaj ikjes së kohës, ose të paktën ndaj përjetimit të dhimbjes së zbrazjes dhe shitjes së shtëpisë një të huaji.

Vdekja e prindit të dytë është njëlloj sikur një natë të kërkosh me teleskop në qiell për një planet që ka qenë përherë aty dhe të mos e gjesh më. Ai është zhdukur, bashkë me fenë, shprehitë, zakonet dhe ritualet e tij të veçanta, të mëdha apo të vogla. Ka mbetur vetëm jehona e tij. Babain e mendoj çdo mëngjes kur fshij shpinën me peshqir, gjë që ai ma mësoi në moshën gjashtëvjeçare kur pa se sa vështirë e kisha të fshihesha vetë. Shumë prej këshillave të tij i kam përherë në mendje. (Një që më pëlqen shumë: Fali miqtë që edhe ata të të falin ty.) E kujtoj nënën sa herë që shoqëroj një mik deri te dera e jashtme kur largohet, sepse, të mos e bëje këtë, për të do të ishte e pafalshme, por edhe sa herë që përdor vajin e ullirit. Ndërsa vitet e fundit, i shoh të tre në fytyrën time, tek vështrohem në pasqyrë. Jam përpjekur gjithashtu që jetën time ta drejtoj sipas rregullës të rrallëpërmendur, por të paqortueshme: mos u bëj njeri maskara.

Një pjesë e madhe nga kultura e prindërve tanë mbijeton në njëfarë forme në planetët e rinj të krijuar nga vëllai dhe unë me familjet tona. Një pjesë është shkrirë me ato që gratë tona kanë sjellë, ose ato që kanë zgjedhur të mos i sjellin, nga fiset e tyre. Me kalimin e viteve kjo ndarje do të vazhdojë dhe jeta do të vendosë në botën e prindërve njëra mbi tjetrën shtresa të jetëve të tyre të jetuara, derisa do të vijë një ditë kur askush në këtë rruzull nuk do ta kujtojë më praninë e tyre fizike. Tani kam arritur pothuaj moshën që kish babai kur e pyeta se çfarë mendonte natën pasi fikte dritën. Ashtu si ai, edhe unë nuk kam filluar ende të shqetësohem, por jam i vetëdijshëm për kohën. Hëpërhë, jam ende këtu, duke menduar për ta.

Përktheu Engjëllushe Shqarri

Në fund të viteve 60', kur duhani të bënte ende mirë.



Gonzalo, Gabo, Rodrigo. Los Angeles, 2008.

Dy bij, dy rrëfime për dy dashuri

Andreas *Dushi*

Kur lexojmë *Jeto për ta treguar*, episodet "magjike" të *100 vjet vetmi* marrin një tjetër trajtë, pasi vëmë re se janë momente e incidente të jetuara nga vetë Gabo, shndërruar më pas në letërsi. Por jo vetëm *100 vjet vetmi* është *magjik* nga letërsia e Márquez-it: Gjithçka ai shkroi, krijon te lexuesi përjtimin e magjishëm të një lloj këneqësie që rrallëherë letërsia ta jep, përfshirë këtu edhe *Dashuria në kohërat e kolerës*, sidomos *Dashuria në kohërat e kolerës.*

Vetë Márquez-i, pasi tregon se si ishin njohur prindërit e tij, thotë se *Historia e këtyre dashurive të kundërshtuara përbënte një çudi për mua kur isha i ri. Ngaqë e kisha dëgjuar sa e sa herë nga goja e prindërve, nga të dy së bashku ose veç e veç, e dija thuajse të plotë kur shkrova "Gjethurinat", romanin tim të parë, në moshën njëzet e shtatë vjeç, po gjithashtu isha i ndërgjegjshëm se më mbetej shumë për të mësuar në artin e të shkruarit. Që të dy ishin rrëfyes të shkëlqyer, me kujtimin e lumtur të dashurisë, porse arritën të apasionoheshin aq shumë në rrëfimet e tyre saqë, kur më së fundi, pasi i kisha kaluar të pesëdhjetat, vendosa ta përdorja te "Dashuria në kohërat e kolerës", nuk i dalloja dot kufijtë ndarës midis jetës dhe poezisë.*[1]

Një ndër romanet më ikonikë jo veç të Márquez-it, por të gjithë letërsisë botërore, është shkruar duke metamorfizuar lëndën reale të dashurisë së pridërve të tij në lëndë letrare të një dashurie që vijon të tërheqë lexues edhe dekada pas botimit të parë.

Ndërsa tani është djali i Márquez-it, Rodrigo Garcia ai që merret me dashurinë e prindërve të tij, por jo ashtu sikurse bën i ati. Ai nuk provon ta kalojë në poçari krijuese jetën dhe dashurinë e Gabo-s dhe Mercedes-it, por përkundrazi, e tregon ashtu sikurse ishte, pa asnjë kompleks gjykimi a paragjykimi, kjo e ardhur ndoshta edhe për hir të lirshmërisë së Gabriel Garcia Márquez-it sa herë fliste dhe tregonte për veten.

Janë ditët e tij të mbrame, kur fillon të bëhet i vetëdijshëm se jetës po i vjen fundi. Te kujtimet e tija, shkruan: *Gjer në moshën pesë vjeç, vdekja kishte qenë për mua një fund i natyrshëm që u ndodhte të tjerëve. Kënaqësitë e qiellit dhe mundimet e ferrit më dukeshin thjesht mësime për t'u nxënë përmendsh në katekizmin e padre Astetes. Ato s'kishin të bënin fare me mua...*[2] Po tani, kur vdekja, si fundi më i natyrshëm i tij është kaq pranë?

Si shumë shkrimtarë, edhe ai është i fiksuar pas humbjes dhe vdekjes, shfaqjes më të madhe të saj. Vdekja si rregullsi dhe parregullsi, si e logjikshme dhe e pakuptimtë, si e pashmangshme dhe e papranueshme.[3]

Kujtimet e tij në trajtë autobiografie, Márquez-i i konceptoi si një triologji; si një rrëfim i gjithë formimit të tij si shkrimtar dhe si njeri. Pjesa e parë mbaron pikërisht në kohën kur u martua me Merceds-in, gruan që do ta shoqëronte përgjatë gjithë jetës. Nuk i mbaroi, dhe fillin ku kjo dëshirë e tija u këput, e shtrëngon fort Rodrigo. Ai tregon se si, për shembull, *një pasdite të vitit 1966 në Qytetin e Meksikos shkoi në dhomën ku mamaja po lexonte në shtrat dhe e njoftoi se posa kishte mbaruar së shkruari për vdekjen e kolonelit Aureliano Buendia.*

"E vrava kolonelin", - i tha i tronditur.

Ajo e dinte se sa i rëndësishëm ishte ai për të dhe të dy qëndruan në heshtje me lajmin e trishtuar.[4]

Pra, Rodrigo na jep kështu pasqyrimin e Márquez-it në sytë e Mercedes-it dhe jetën e këtyre syve pasi prej tyre rrodhën lotët e vdekjes së të shoqit.

***

Kemi përballë dy histori dashurie. Njëra, e treguar me mjeshtëri të rrallë nga një bir shkrimtar, duke krijuar një ndër metaforat më të bukura të dashurisë ndërsa tjetra, treguar me sinqeritet të rrallë nga biri i shkrimtarit, duke treguar një ndër realitetet më të bukura të dashurisë.

[1] "Jeto për ta treguar", Gabriel García Márquez, "Onufri", fq. 54 – 55.

[2] Po aty, fq. 157.

[3] "Lamtumirë Gabo dhe Mercedes", Rodrigo Garcia, "Onufri", fq. 40.

[4] Po aty, fq. 63.

12 tetor, 2012, tridhjetë vjet më vonë, i njëjti vend, e njëjta pemë, e njëjta veshje për rastin.

Kujtimet e të birit për humbjen e prindërve të tij dhe fundin e një epoke në letërsinë kolumbiane

DASHURI NË KOHËRAT E FAMËS

Nga Boyd Tonkin
Wall Street Journal

Mercedes Barcha-s i pëlqente t'u rikujtonte dy djemve të saj që "ne nuk jemi figura publike". Burri i saj këmbëngulte gjithmonë që "çdokush ka tri jetë: atë publike, private, dhe të fshehtë". Fëmijët e tyre u rritën në një shtëpi ku "vija mes publikes dhe privates" ruhej rreptësisht. Sidoqoftë, Rodrigo Garcia, djali i madh i Mercedes-it dhe Gabriel García Márquez-it, tashmë ka shkruar një kujtim të hollë, personal mbi ditët e fundit të një prej çifteve letrare më të njohura të planetit.

Laureati kolumbian i Nobelit i cili shkroi "Njëqind vjet vetmi", "Dashuria në kohërat e kolerës" dhe vepra të tjera që rikonturuan edhe hartën kulturore të Amerikës Latine dhe konturet e trillimit modern, vdiq në shtëpinë e tij në Mexico City në Prill 2014. Ishte 87 vjeç. Pas një miqësie të gjatë, ai u martua me Mercedes Raquel Barcha Pardo në Barranquilla në 1958. García Márquez pohon se e ka takuar fillimisht rreth 1941 kur ajo – po ashtu si ai, fëmija i një farmacisti nga qytetet përvëlues të bregut të lumit Magdalena – ishte 9 vjeç dhe ai 14. Në fillimet e 1945, ai kompozoi një sonet për nxënësen me

prejardhje pjesërisht egjiptiane të cilën e lëvdoi si "herët në mëngjes / po aq e pabesueshme sa çdo histori".

Martesa do të vononte më shumë se një dekade: Bashkimi i tyre do të zgjaste deri në vdekjen e tij. Për Gerarld Martin, biografi i autorizuar i Gabriel García Márquez, Mercedesi i solli "freski dhe metodë jetës së tij" dhe i imponoi "ndjenjën e saj legjendare të rendit" në punëtorinë e tij krijuese. Ajo vetë vdiq në gusht 2020. Vdekja e saj e shtyu Rodrigo Garcia-n, lindur në 1959 në Bogotá (kryeqytetin gri, malësor e me shi të Kolumbisë, të cilin babai i tij karaibian e kishte kaq shumë inat) që të shkruante për prindërit e tij. Ose më mirë, të evokonte javët e fundit të babait të tij si një invalid i goditur nga kanceri, me kujtime joshëse mbi të kaluarën e tyre të përbashkët.

Z. Garcia është një shkrimtar-regjisor-producent i bazuar në Los Angeles: Veprat e tij përfshijnë filmat "Albert Nobbs" dhe "Last Days in the Desert" si dhe serialin e HBO-së "In Treatment". Në shtyp, ai paraqet skena të shkurtra, nga afër, të një shtëpie të zënë të një burri duke vdekur, të mbushur me kujdestarë dhe familjarë. Zëri i z. Garcia mbetet i butë dhe modest, sytë e tij të qëndrueshëm, stili i tij mrekullisht pa zbukurime. Ai vështron më shumë seç reflekton. Vetëm një episod të kujton paksa atmosferën e ethshme, ekstravagante dhe të çuditshme të trillimeve më të njohura të babait të tij, kur një zog përplaset me murin prej xhami të verandës. Ogur i mirë apo i keq? Stafi i shtëpisë nuk bie dot dakord. Sidoqoftë, trupi i tij i pajetë bashkohet me një papagall dhe një këlysh në ngastrën e varrezave të kafshëve për të cilën romancieri i përndjekur nga vdekja nuk dinte gjë (ai "do të ishte shqetësuar prej kësaj").

Gerald Martin e pa ngurrimin e hekurt publik me të cilin "Gabo" dhe Mercedesi ruanin martesën e tyre si "një lojë e luajtur mes dy njerëzve shumë të fortë, shumë ironikë dhe shumë privatë." Dashuria e tyre jetëgjatë shfaqet rrallëherë në kujtimet "Jeto për ta treguar" që García Márquez botoi më 2002 (*në shqip: Onufri, 2016*), pas një periudhe të vështirë me kancerin. Edhe ndërkohë që ai sheh babain e tij tek merr lejen e fundit, z. Garcia përpiqet të respektojë privatësinë e tyre. Nuk marrim exposé spektakulare por pak shkrepje devijuese, ndërkohë që Gabo i bën një tribut të papritur Elton John-it (atij "boleristi të pabesueshëm") ose bën shaka me infermieret e mbledhura "No me las puedo tirar a todas" (S'mund t'ju palloj dot të gjithave). Z. Garcia përpiqet t'i shmanget "tundimit për të rritur famën vetjake në kohën e vulgarizimit", ndërkohë që kamerat grupohen në derën e jashtme. "Duhet të jemi të përgatitur pasi do të jetë si në kopsht zoologjik," paralajmëron Mercedesi Rodrigon. Është – megjithëse miqësor".

Nëse portreti fragmentar i të birit për Gabo-n zbulon pak gjë, Mercedes-i – "e hapur dhe e fshehtë, kritike dhe shpirtmadhe, por që i druhej rrëmujës" – na shfaqet në intervale nga pas maskës së kompetencës të çeliktë e të shkathët që gjen dhe në përshkrime të tjera. Një skenë nga dasma e saj tregon pasiguritë e hershme: Mercedes-i nuk u vesh derisa Gabo arriti në kishë, "që të mos kishte shans të braktisej në altar e veshur me fustanin e nusërisë".

"Lamtumirë Gabo dhe Mercedes" godet notën e tij të trishtimit jo falë ndonjë dramaticiteti në shtratin e vdekjes – Gabo ndërron jetë qetësisht dhe në heshtje. Përkundrazi, shqyrtimi pas fakteve i z. Garcia mbi punën e vështirë të vdekjes e lejon peshën e humbjes të mblidhet thuajse pa u parë derisa bie si një gur mbi të mbijetuarit. Pasi vdes Gabo, Mercedes hyn në dhomë për të marrë punët në dorë, si përherë, por shikon në fytyrën e të "pobrecito" (shkretit) dhe, siç nuk bën kurrë, qanë pak. Lotët e saj të menjëhershëm kanë forcën e breshërisë së një automatiku". Nuk ka asgjë tragjike për këtë vdekje të parathënë të një 87-vjeçari të nderuar i cili ka shijuar "një nga jetët më fatlume dhe më të privilegjuara të jetuara ndonjëherë nga një latino-amerikan" – përveç mungesës së tij të plotë. "Qué barbaridad," vajton agjentja e tij e përkushtuar, Carmen Balcells.

Çfarë barbariteti, vërtet, që një mendje e tillë të shuhet ndonjëherë. Kur e ndjek nga pas dhe Mercedes-i, z. Garcia e lidh vdekjen e prindit të dytë më zhdukjen e një planeti nga qielli. ("Ai është zhdukur, bashkë me fenë, shprehitë, zakonet dhe ritualet e tij të veçanta, të mëdha apo të vogla".) Lexuesit e rinj të Gabriel García Márquez-it ndonjëherë vijnë te librat e tij në kërkim të ekzotikes, fantastikes, të huajës. Ata qëndrojnë për të njerëzishmen, intimen, universalen. Po kështu, "Lamtumira" e z. Garcia, të prek kur del butësisht nga jeta publike në atë private për të na treguar mbylljen e njohur të kësaj bashkëjetese unike. Sa për jetën sekrete, e cila banon diku tjetër – e sigurt në artin e pakrahasueshëm të babait të tij.

Përktheu E. H,

RISITË QË SOLLI POEZIA E KADARESË

Nga Dr. Jolanda LILA

Në mendimin kritik shqiptar është pranuar gjerësisht se vitet ’60 shënjojnë valën e parë të poetëve që risuan poezinë shqipe. Gjatë kësaj periudhe, gjëllijnë në bllok prirje të ndryshme letrare, me larmi stilesh dhe mjaft të pasura në planin lëndor. Ndryshe nga shfaqjet e modernitetit me tipare ishullore të viteve të mëparshme (vitet ’30), pas viteve ’60 poezia shqipe njohu zhvillime tërësore të rëndësishme, si në aspektin strukturor ashtu edhe në atë tematik, aq sa segmente të kësaj poezie janë të krahasueshme me poezinë moderne evropiane.

Pjesë e gjeneratës që shënjuan kthesën cilësore të poezisë shqipe të gjysmës së dytë të shekullit të XX, madje një ndër prijësit kryesor të saj, qe edhe Ismail Kadare.

Ndonëse ishte vetëm 18 vjeç kur botoi vëllimin e parë poetik “Frymëzime djaloshare”, ai spikati për origjinalitetin, thjeshtësinë dhe natyrshmërinë e vargut, gjë që u përvijua më tej edhe me vëllimin me poezi “Ëndërrime”. Edhe pse në këto dy vëllime poetike, janë të ndjeshme një varg dobësish, të përligjura me moshën dhe përvojën artistike të autorit, sërish një pjesë e madhe e këtyre poezive parashenjuan ardhjen e njërit prej zërave më të rëndësishëm të poezisë shqipe.

Nëse këto dy vëllime mund t’i quajmë si një fazë eksperimentale e autorit, në vitin 1961, me botimin e librit “Shekulli im” mund të themi se shpërfaqet plotësisht individualiteti krijues i Kadaresë. Në këtë fazë, poezia e tij vjen si një gjedhe origjinale në poezinë shqipe bashkëkohore dhe poeti vjen si një revolucionarizues i botëkuptimit letrar dhe si një autor avangard, në një kohë kur nuk lejohej avangardizmi. E për këtë, nga shumë studiues (vlen të përmendim studiuesit Bashkim Kuçuku dhe Agim Vinca) Kadare është quajtur një Majakovsk shqiptar. Jo vetëm përmes krijimtarisë poetike, por edhe përmes shkrimeve kritike të botuara në shtypin e kohës (përkatësisht, gazeta “Drita”, 1961) ai doli kundër poezisë anemike, e cila qëndronte larg jetës së gjallë dhe kohës së vet dinamike, apo që qëndronte brenda korniza metrike e fjalorit standard, duke harruar fondin e gjuhës së përditshme, i cili shpreh më së miri zhvillimet e kohës.

Duke përçmuar këtë trajtë uniformizuese të poezisë së ashtuquajtur “tradicionale” , duke qenë i konsoliduar në mendimin e vet poetik e duke pasur si kredo kryesore pasurimin e poezisë në planin përmbajtjesor dhe për pasojë, edhe në mjetet shprehëse të saj, ai lëvroi zhanrin e poezisë për rreth 14 vjet, duke botuar edhe një sërë vëllimesh të tjera poetike, si: “Përse mendohen këto male” 1964, “Vjersha dhe poema të zgjedhura” 1966, “Motive me diell” 1968 dhe më 1976 edhe vëllimin me poezi “Koha”. I gjithë ky korpus veprash sendërton një tërësi të madhe vlerash e risish për poezinë shqipe në përgjithësi dhe një vatër interesante kërkimesh, pikëpamjesh e konceptesh të reja, ende të pastudiuara sa duhet.

Poezia e Kadaresë ka shëmbëlltyra origjinale me forcë të madhe shprehëse për realitetin shoqëror në të cilin jetoi autori, por edhe për botën e brendshme intelektualo-emocionale të tij. Kjo larmishmëri poetike, e komplikon ravijëzimin e tipareve të kësaj poezie, mbi të gjitha nëse rrekemi ta kanonizojmë atë brenda një rryme letrare të caktuar. Megjithatë, duke parë dinamikën e zhvillimit të stilit nga poezitë e para, tek ato më të fundit, rezulton se poetika e Kadaresë karakterizohet nga dy trajta kryesore ligjërimore:

Së pari, nga ligjërimi i drejtpërdrejtë, pa ngarkesa dhe ornamente që krijojnë mjegullnajën semantike. Vargu nuk ngarkohet figurativisht, megjithatë shfrytëzohen dendurisht figurat e diksionit dhe në shumë raste, përdoren edhe figura të mendimit, të sintaksës etj. Kështu, disa nga figurat stilistikore më të shpeshta në vargjet e Kadaresë janë: metafora, metonimia, krahasimi, hiperbola, personifikimi etj.

Së dyti, është ligjërimi abstragues, herë me nivel të thellë e herë disi më sipërfaqësor, me shumë lakadredha metaforike e simbolike dhe nivele kuptimore të ndryshme. Ky lloj ligjërimi vihet re sidomos në vëllimin e fundit poetik “Koha”. Në të dyja trajtat ligjërimore, ai është i pangjashëm me asnjë tjetër, sepse pikëmbështetja krijuese ngrihet mbi disa referenca, herë reale e herë surreale, të cilat ndërtojnë figurën poetike.

Ligjërimi i drejtpërdrejtë sendërtohet kryesisht nga referencat përngjasuese konkrete mjedisore, por që janë të ndryshueshme vazhdimisht. Pikërisht kjo ndryshueshmëri i jep ritëm dinamik vargut, ku nuk mungojnë as tonet shqetësuese e nervoze. Në librin me poezi “Shekulli im” vihet re veçanërisht ndikimi nga futurizmi rus, pasi në vitin 1962 përktheu edhe manifestin futurist “Re me pantallona” të Majakovskit. Kështu, në vargun kadarean të kësaj periudhe ndihet një lloj fryme superioriteti ndaj brezave të mëparshëm dhe një lloj lufte e hapur ndaj të vjetrës e konservatores në jetë dhe në art.

Njëlloj si tek futuristët rusë, edhe tek Kadareja, lufta kundër tradicionalizmit nënkuptonte luftën kundër elementeve penguese të progresit dhe jo nihilizimi i elementëve më të rëndësishme të saj, pasi në poezinë e tij pasqyrohen elementet më të rëndësishme të traditës shqiptare. Madje, shëmbëlltyra e etnitetit shqiptar është mbizotëruese në shumë vëllime poetike. Kjo shëmbëlltyrë formësohet nga ndikimi i folklorit; nga ritet e dasmave, këngëve, valleve, veshjeve popullore; nga traditat e zakonet me vlera morale e kombëtare; nga natyra e bukur shqiptare (*malet, shirat, ylberët, gurët* etj.) dhe nga historia e lavdishme ndër shekuj.

Shpesh, në referencat historiko-mitologjike, gjejmë shëmbëlltyra mendimore-emocionale të frikshme e të ankthshme që zhvillohen me ligjërimin e tërthortë dhe abstragues. Kështu në poezinë “Ikja e Moisi Golemit”, tradhtia e Moisiut ndaj Skënderbeut trajtohet në një rrafsh tepër psikologjik, gjë që e universalizon këtë dukuri. Ky lloj ligjërimi është i ndjeshëm veçanërisht në poezitë e fundit të autorit dhe përdoret simbolika e shumëllojshme për të fshehur mendimet politike kundër regjimit diktatorial. Për shembull, në poezinë “Pritja” përfshihemi në një atmosferë surrealiste, ku përzihet e zakonshmja a e përditshmja me mitologjinë e folklorin. Kështu, teksa subjekti lirik pret një personazh/referent të papërcaktuar, telefoni merr një sy gjumë dhe në qilimin e dhomës përbindëshat dremitin. Kur personazhi vonohet, atëherë përbindëshat fillojnë të lëvizin me leshra të kërleshura mbi qilim.

Telefoni po merr një sy gjumë para ardhjes sate
Abazhurët varen të heshtur mbi pritjen.
Përbindëshat mbi qilimin e dhomës dremitin
të qetë.

Ora kaloi.
Ti u vonove.
Drita e abazhurëve u bë e keqe.
Si i vrarë telefoni ka rënë përmbys e s’merr frymë.
Tani përbindëshat filluan të lëvizin,
Ja, po zgjohen me leshra të kërleshura mbi qilim.

Ti do vish patjetër të qetësosh gjithçka.
(Poezia “Pritja”, 1966)

Atmosfera poetike e pritjes vërtitet në tre përbërës kryesor: *telefoni, abazhurët, përbindëshat* dhe në pamje të parë, të krijohet ideja e ankthit të padurimit që e kaplon subjektin lirik për t’u takuar me të dashurën e vet. Megjithatë, shpejt kjo ide të përngjan

e pamjaftueshme teksa analizon fushën izotopike të poezisë, ku mjafton të përmendim disa nga fjalët e sintagmat çelës për të nxjerrë në pah nëntekstin e poezisë: *gjumi, pritja, përbindëshat, ora, drita e keqe, i vrarë, ka rënë* përmbys, s’merr frymë*, leshra të kërleshura.* Kjo tërësi fjalësh krijon klimën e dhunës psikologjike dhe fizike, klimë e cila është shëmbëlltyrë e rrethanave politike në Shqipëri gjatë diktaturës komuniste, kur mendimi dhe veprimi i lirë konsiderohej herezi dhe censura ishte mbizotëruese në çdo skaj të veprimtarisë njerëzore. Dëshmues të këtij konotacioni janë edhe tre elementet poetike: *telefoni* (akti i dëgjimit), *abazhuri* (metaforë e dritës, që nënkupton aktin e shikimit) dhe përbindëshi (sistemi totalitarist që mbikëqyr gjithçka, “gjithë sy e veshë”). Këto elemente paraqesin trysninë e censurës dhe aktet makabre të saj për përçudnimin e qenies njerëzore.

Katalizatori i ankthit është i papërcaktuar dhe kjo e rrit akoma më shumë efektin dramatik të vargut. Efekti bëhet më i fortë përmes kontrastit mes ankthit e trazimit të subjektit lirik dhe heshtjes e ftohtësisë së referentit të jashtëm që shenjohet përmes telefonit që hesht, nga njëra anë dhe përmes abazhurit që varet heshturazi dhe drita i bëhet e keqe. Kjo poezi përshkohet nga një emocionalitet i lartë, ku mbisundon mendimi më shumë sesa ndjenjat. Telefoni është figura që paraqet thelbin e mekanizmit funksionues dhe të realitetit totalitarist, pasi pas çdo shkrimi, botimi, apo veprimi nga ana e krijuesve dhe funksionarëve të atij sistemi, gjithnjë pritej me ankth telefonata “nga lart”, që barte kumtet përkatëse. Telefoni ishte përcjellësi i parë dhe pikënisja e hierarkisë së tmerrit dhe bartësi kryesor i ankthit. Është kjo figurë poetike që sjell humbjen e lirisë së subjektit lirik (i cili shpreh doza vartësie ndaj këtij objekti), shkakton stres, pagjumësi, përndjekje. Sa më shumë kalon koha dhe telefoni hesht, aq më shumë rritet niveli i ankthit të subjektit lirik. Heshtja është pasojë e një shkaku. E, meqenëse nuk ka pasojë pa shkak, atëherë heshtja vetvetiu e përmban edhe shkakun, që është parësori dhe e përcakton pasojën. Sipas kësaj logjike, në poezinë e marrë në shqyrtim, telefoni është një nga trajtat e shkakut, sepse ai është burimi i turbullimit të brendshëm, e njëherësh është shprehës i gjendjes psiko-emocionale të një qenieje të frustruar, si pasojë e dhunës psikologjike. Figura e përbindëshit që herë dremit e herë ngrihet i gatshëm për përleshje, është shënjues i gjendjes së rënduar psikologjike, deri haluçinante, ku nën peshën e etheve të pritjes, herë qetësohesh e herë alarmohesh. Përbindëshi qëndron midis realitetit dhe ëndrrës, midis të përkohshmes dhe të përjetshmes, gjë që dëshmohet edhe nga përdorimi i foljes “filluan” në kohën e pakryer, si kohë që shenjon pafundësinë.

Ëndrra, ankthi, revolta e brendshme për telefonin që hesht, por dhe shumë elemente të tjera përmbajtjesore na çojnë tek thelbi i trinomit surrealist: liri-dashuri-poezi, ku të tria formojnë një realitet absolut që përbën realitetin e humbur të subjektit lirik. Vënia e referencave kohore në fund të poezive (vitit kur është shkruar një poezi, 1966) na orienton për zbërthimin e botës së figurave dhe si lidhen ato edhe me vetë jetën reale të poetit.

Këto tipare të përgjithshme të poezisë së Ismail Kadaresë dëshmojnë se ky autor, është karakterizuar nga guximi për të “pushtuar” hapësira të reja poetike dhe ka sjellë një mënyrë të re të organizimit të poezisë. Kadareja jo vetëm zgjeroi kufijtë tradicionalë të poezisë lirike, ku përmes shprehjes së re theu konvenca të njohura artistike, por solli edhe elemente avanguardiste në përgjithësi dhe futuriste e surrealiste në veçanti, gjë që përbën edhe origjinalitetin e vet poetik, por edhe larminë e poezisë shqipe bashkëkohore shqipe.

SALI BUTKA, POETI I MAJAVE TË GRAMOZIT

Nga Bardhyl Londo

1.

Emrin e Sali Butkës, e kisha takuar shumë më parë se të kuptoja atë që marr vesh sot nga jeta, bota, letërsia, poezia, lufta dhe paqja, agresioni dhe mbrojtja kundër tij, atdheu dhe krahina, fqinjësia dhe shovinizmi, paqja dhe orekset grabitqare të pushtuesve. Sali Butka kishte ardhur tek unë ashtu siç vijnë gjithë luftëtarët zulmëmëdhenj: diçka midis realitetit dhe legjendës. Përfytyrimi im nuk besoj se ndryshonte nga përfytyrimi i të tjerëve: një burrë gjithmonë në lëvizje, të cilit nuk i zinte kurrë këmba dhe', siç thuhet. Një burrë me pushkën në krah, që nuk i ndahej kurrë dhe që i ishte bërë si gjymtyrë e re në trupin e tij. Një luftëtar që veshët i mbante ngrehur dhe sytë gjithmonë hapur nga kufjtë shqiptarë, sidomos nga kufjtë jugorë. Fati kishte dashur që Sali Butka të lindej pikërisht në skajin juglindor të kufjve tanë të sotëm, ku historia e marrëdhënieve tona me fqinjët grekë, në ato vite të turbullta të shpërbërjes së perandorisë otomane dhe të fillimit të luftës së parë botërore, jo vetëm që nuk ishte e paqtë dhe e qetë, por ishte tejskarisht e turbulluar, madje e përgjakur dhe e dhimbshme. Ishte fat për Shqipërinë që Sali Butka lindi në ato troje, jo vetëm për qumështin patriotik që thithi, jo vetëm për edukimin dhe kulturën tradicionale të atyre zonave me të cilat u ushqye shpirti i luftëtarit të ardhshëm, por edhe sepse atje gjeti një terren ku do të shpërthente gjithë gjenia e tij prej luftëtari, gjithë gatishmëria e tij për të sakrifkuar veten dhe familjen në emër të mbrojtjes së tokave shqiptare dhe të lirisë nga sulmet dhe pushtimet e huaja në momentet vendimtare të historisë së Shqipërisë.

Natyrisht, Sali Butka do të donte të mos ta kishte provuar kurrë këtë lavdi. Do të kishte pranuar të jetonte si fshatar i thjeshtë në Butkën e tij të dashur e të bukur, të shkonte herë pas here në Frashërin historik prej nga i kishte rrënjët, të rriste nipër dhe mbesa, të hapte sytë në mëngjes dhe t'i mbyllte në mbrëmje me hallet e përditshme njerëzore. Por fati i tij ishte krejt ndryshe. Historia i kishte paracaktuar fatin e luftëtarit, fatin e Perëndisë mbrojtëse të truallit shqiptar, të zakoneve shqiptare, të qenies shqiptare. Dhe Sali Butka e kreu këtë si rrallë kush në historinë shqiptare.

Ndërsa fati personal i Sali Butkës ishte gati fatalitet. Në luftë ai humbi dy djemtë, njërin kundër me xhonturqit në Frashër, tjetrin kundër haxhiqamilistëve në Pogradec, vetë humbi syrin në betejën e Nikolicës për të mbrojtur Korçën nga grekët, por ky fatalitet vetjak (duket shumë cinike edhe sot kur e shkruan apo përmend) ishte vërtet fat i ndritur për shqiptarët, sidomos ata të Jugut dhe të Juglindjes që kishin një mbrojtës si Sali Butka. Kushedi si do të ishte fati i atyre trevave të bekuara në rast se nuk do të ishte Sali Butka dhe homologët e tij. Ndoshta duket pak jo njerëzore, madje edhe makabre, të pranosh se historia e lirisë dhe e pavarësisë së disa krahinave, por edhe e vetë Shqipërisë, është e lidhur ngushtë me sakrifkim jetësh njerëzore: dy djem të rinj vetëm nga një derë, nga dera e Butkajve, pa përmendur të afërmit e tjerë po nga kjo derë, që janë aq të shumtë, syri ihumbur i Sali Butkës në betejën e Nikolicës, privimet dhe tensionet e pafundme shpirtërore të krejt familjes dhe fisit nëpër vite. Por, sado që mund të ngjajnë të hiperbolizuara si në një film me superheronj, gjithçka është e vërtetë. Liria shqiptare i ka rrënjët në legjendën e Rozafës shekullore: as mund të mendohet dhe të parafytyrohet pa sakrifkimin e njerëzve më të afërt e më të dashur. E ndërsa ky imazh i Sali Butkës tashmë është tepër i njohur dhe familjar për gjithë njerëzit që e duan vendin e tyre, madje jo vetëm vendin e tyre por respektojnë edhe popujt e tjerë veçanërisht fqinjët, është i afërt për njerëzit që e duan lirinë dhe personalitetin e individit, që e duan paqen dhe bashkëjetesën mes popujve, ndërsa mua, pak më vonë, kur botën fillova ta kuptoj dhe ta ndjej më mirë, më erdhi një imazh tjetër i Sali Butkës, një imazh që më habiti dhe më mrekulloi njëkohësisht. Nuk e dija fare se Plaku legjendar i Butkës ishte edhe poet, madje kishte lënë një numër të konsiderueshëm vjershash, të cilat po i paraqiten lexuesit. Cili ishte, pra, imazhi i ri i SaliButkës që më shkrepëtiu në mendje "si nga i madhi Zot", siç ka shkruar Naim Frashëri?

Krejt rastësisht (rastësia shpesh herë është nënë e mrekullive dhe çudirave), nuk e mbaj mend se ku lexova vargjet e mëposhtme:

Në kohë të pleqërisë,
më erdhë plagë të rënda,
për shkakun e Shqipërisë,
që s'u bë si ma kish ënda.

Është me të vërtetë një imazh sa befasues aq dhe tronditës. Një thjeshtësi depërtuese deri në shpirtrat

më të ndërlikuar e më të sofstikuar. Po a nuk është arti i vërtetë një thjeshtësi e kulluar? Një humnerë zhgënjimi që të gëlltit brenda dhe s'të lë më mundësi veprimi? Po a nuk është zhgënjimi një mesazh i artit të vërtetë? Një dëshpërim njerëzor deri në kufjtë e vetëvrasjes, një dhembje e dëlirë, e pastër, që shfaqet pa asnjë pozë, pa asnjë pasthirrmë deklamuese nga ato që duan të tërheqin vëmendjen e opinionit dhe t'i thonë atij "shikomë mua sa po vuaj, vetëm për çështjen tuaj". Një klithmë e thekshme për jetën e një njeriu, të një vendi, të një kombi, jetë që, përfat të keq, ka shkuar kot "është djegur si qiriri", por e kanë shkelur pa mëshirë, me brutalitet të pashoq "derbederët, mercenarët...".

Imazhi i këtyre vargjeve ka vite që më ndjek. Madje them se jo vetëm mua, por shumicën e shqiptarëve edhe ata që nuk i kanë lexuar dhe nuk e dinë fare se ekzistojnë katër vargje të tillë. Janë vargje që riprodhojnë artistikisht të njëjtën gjendje shpirtërore që provon Shqipëria sot, kur zhgënjimi dhe humbja e shpresës janë ngjyra kryesore e peizazhit hallemadh shqiptar. Aq shumë më pëlqyen këto vargje sa edhe sot e kësaj dite i citoj shpesh me vete për të ilustruar gjendjen time shpirtërore. Jo rrallë ua deklamoj dhe miqve për të ndarë me ata diçka që mua më trondit sa herë e dëgjoj. Disa herë i kam cituar nëpër shkrime dhe ese të ndryshme.

Sali Butka hyri tek unë me këto katër vargje. Deri atëherë as nuk e dija që ai kishte shkruar edhe poezi. Është fat i madh për një poet kur hyn në botën e tjetrit me vargjet më të mirë të tij, sepse e ka më të lehtë komunikimin, por edhe pranimin, e ka të sigurtë ngrohtësinë e strehëzës ku troket.

Poeti i Butkës hyri tek unë nga porta kryesore e zemrës dhe jo nga dyert dytësore, apo deriçkat e parëndësishme dhe shpesh herë të rastësishme. Hyri përsëri ashtu siç kishte ardhur vite më parë: luftëtar, gjysmë njeri gjysmëlegjendë, me gjysmën e poezive që vazhdojnë të jenë vazhdim i krismave dhe flakëve të pushkës së tij të paepur, dhe gjysmën tjetër që janë ofshama dhe dhimbje për zhgënjimin e madh dhe të pashoq shqiptar, për "malet e Gramozit që qajnë" dhe "Tomorrin që oshëtin".

Por, ndërsa Sali Butka luftëtar besoj se njihet mirë, çfarë mund të themi për të si poet tani kur kanë kaluar shumë vite dhe historia është paqtuar, ndërsa gjykimi është i ftohtë nga emocionet dhe dobësitë e ndryshme njerëzore, që të bëjnë nganjëherë të gjykosh me anësi?

Jam i sigurtë: Sali Butka është po aty, është po ai që ka qenë. Syri i shëndoshë i tij, i cili në të vërtetë shikon sa dhjetëra sy të zakonshëm njerëzorë, vrojton si gjithmonë kufjtë e shenjtë, ndërsa shpirti ofshan përsëri "malet e Gramozit qajnë në moshën e pleqërisë së thellë... "

Sali Butka lindi më 1852 dhe vdiq në Butkë më 1938. Pra, siç vetëkuptohet, veprimtarinë vjershëtore e ka shtrirë në periudhën e Rilindjes Kombëtare dhe në atë që në historinë e letërsisë shqipe njihet me "Letërsia e periudhës së Pavarësisë". Megjithëse ka një prodhimtari të konsiderueshme vjershëtore, emri i Sali Butkës si poet asnjëherë nuk është përmendur zyrtarisht. Kam parasysh antologjitë që hartoheshin për shkollat, tekstet e letërsisë, të leximeve jashtë klase etj. Them zyrtarisht, sepse në popull, tek lexuesi, sidomos i viseve ku jetoi dhe luftoi poeti për të cilin po flasim, vjershat e tij njiheshin gjerësisht. Shumë prej tyre mësoheshin përmendësh dhe njerëzit i këndonin në gëzime apo trishtime të jetës.

Edhe sot e kësaj dite bëjnë jetë aktive këngë të tilla si "Të erdhi një letër nga një holandez, o Gani medet medet", "Ke tre vjet në Komitet", "Qëllimi", "Abdyl Frashërit", "Mësimi në çetë" dhe "Një natë dimri" (këngë e shkruar për Hasan Qinamin). Vetë vjershëtori i Butkës i shkruante vjershat në atë mënyrë që ato të kapeshin shpejt, të mësoheshin menjëherë, pa vështirësi, dhe t'u përshtateshin ritmeve muzikore të cilat gjallonin në krahinën e Kolonjës, Korçës, Skraparit, Përmetit, Beratit, Strugës e më gjerë.

I njohur dhe i pëlqyer masivisht në popull, zyrtarisht Sali Butka ishte lënë në harresë të plotë, ishte injoruar, për të mos thënë se ishte mohuar qëllimisht. Po vallë kaq e pasur me emra është letërsia shqipe e viteve të Pavarësisë sa të mohojë emra të tillë si Sali Butka? Përse vetë ne kemi prirjen ta varfërojmë sa më shumë letërsinë tonë, ashtu siç kemi prirjen të zvogëlojmë përmasat e historisë sonë, duke mohuar, dënuar e dëbuar personalitete të shquara, duke u rrekur me mish e shpirt për t'u ngjitur atyre ndonjë bisht apo përbaltje të padenjë, edhe kur shumica e jetës së tyre ka qenë thjesht një jetë për Shqipërinë?

Është vështirë t'i përgjigjesh pyetjes pse u injorua dhe vazhdon të injorohet zyrtarisht Sali Butka. Kushdo mund të mendojë se kur u duhej, apo kur nuk kishin si e fshihnin të vërtetën e bëmave të tij, e dekoronin. Por pas çdo decorate,



të cilën ishin të detyruar ta akordonin, autoritetet shtetërore mbanin gati dajakun. Dhe ky dajak kishte formën e injorimit, mohimit, mënjanimit. Natyrisht Sali Butka nuk është një poet elitar (në periudhën e letërsisë së Pavarësisë të tillë ka shumë pak). Ai nuk mund të studiohet as për "mrekullitë" artistike, dhe as për "personalitetin" e madh krijues. Por ai është, ekziston, frymë merr, jep e merr me lexuesin, shumë e dine përmendesh, një shumicë edhe më e madhe këndojnë me ritmet kolonjare tekstet e tij patriotike, nganjëherë pa e ditur se ato vargje kanë rjedhur nga qenia dhe shpirti i poetit të Butkës. Mjaft prej tyre kanë vlera të mirëfillta artistike.

Çfarë ka më tepër, fjala vjen, Mihal Grameno, publicistikën e të cilit ne e kemi mësuar nëpër shkolla dhe kemi bërë shumë mirë? Ashtu siç është bërë shumë gabim që na është fshehur, mohuar dhe vjedhur Sali Butka. Për të respektuar të vërtetën dhe historinë duhet të themi se veç përhapjes spontane në popull që ishte për t'u konsideruar, përkundrazi, poezitë e Sali Butkës janë shkruar dhe përmbledhur edhe në një libër të veçantë me titullin "Ndjenja për atdhenë" në vitin 1920 në Korçë nga shtypshkronja Dhori Koti. Bazë e kësaj përmbledhjeje është edhe libri që i japim sot lexuesit. Ndërsa Andrea Varfi ka botuar prej vjershëtorit të Butkës një libër me poezi të zgjedhura të mara nga libri i mësipërm, por edhe nga shtypi i kohës.

Duke prekur një temë të tillë kaq të ndjeshme dhe që ende plaga nuk i ka zënë kore, (mënjanimin apo

mohimin e poetëve) m'u kujtua një ngjarje e fundviteve gjashtëdhjetë gjatë praktikës pedagogjike mësimore në shkollën e mesme të Kuçovës (atëherë Qyteti Stalin). Isha pothuajse në moshën e maturantëve, të cilëve më qëlloi t'u shpjegoja një prozë të Mehmet Shehut, me të cilën fillonte antologjia letrare e maturës. Kur mbarova shpjegimin ose më saktë leximin e pjesëshëm, se çfarë mund t'i shpjegoje atij teksti fare të zakonshëm, një djalë i gjatë, i hequr, simpatik, u ngrit dhe pa iu trembur syri fare, tha gati me revoltë: "E çfarë ka ky tekst që hap antologjinë e letërsisë për maturën e shkollave të mesme? Apo e kanë futur në antologji vetëm se autori i tij është kryeministër?"

Ktheva kokën dhe shikoja nga dritaret peizazhin kuçovar të sterosur nga gazi dhe nafta, që digjej. U interesova për djaloshin, e quanin Shpëtim Gina. Dytre vjet më vonë u fol gjatë për talentin e tij si dramaturg (arriti të botojë disa drama, madje, në mos gaboj, ndonjëra mund t'i jetë venë edhe në skenën e Teatrit Popullor (kështu quhej atëherë).

Por behari i lulëzimit të Shpëtim Ginës ishte i shkurtër. Dimri i tmerrshëm e priste me një kosë të pamëshirshme në dorë. Nuk vonoi dhe u përhap lajmi se dramaturgu i ri i talentuar nuk ishte mirë mendërisht dhe ishte mbytur në një nga kanalet e Myzeqesë. Natyrisht, këtë nuk e besuan edhe vetë ata që e kishin përhapur: përkrahësit dhe sponsorizuesit e letërsisë kryeministrore. Edhe atëherë, edhe sot njerëzit mendojnë ndryshe: Shpëtim Ginën e vranë pikërisht ideatorët, përkrahësit dhe sponsorizuesit e letërsisë kryeministrore.

Përse atëherë të mos mendojmë që Sali Butkën vjershëtor e mënjanuan apo mohuan pikërisht këta përkrahës? Ky lloj mënjanimi Sali Butkës nuk i është bërë vetëm në kohën e diktaturës komuniste. Ai ka filluar herët sepse ai ishte qemalist (mbështetës i Ismail Qemalit), fanolist dhe antimonarkist. I lidhur ngushtë me atë që ndodhte në botë, poetit nga Butka i vinte rregullisht nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës gazeta "Republika" në të cilën ishte abonuar. Mjaftoi ky fakt i thjeshtë që në një shkresë ndalimi drejtuar Zogut nga ministri i brendshëm i asaj kohe për të gjithë ata që lexonin këtë gazetë, emri i Sali Butkës të ishte në krye. Ndërsa kur poeti Lasgush Poradeci shkroi në vitin 1938 një nekrologji për vdekjen e poetit të Gramozit, gazeta "Drita" e kohës ia refuzoi shkrimin me arsyen se luftëtari dhe poeti Sali Butka ishte kundërshtar i mbretit Zog.

E pra, hallet, ndalimet, privimet, mohimet dhe mënjanimet e poetëve janë shumë të lashta dhe gjithmonë të zymta, të errëta si një hapsanë.

2.

Nuk është e vështirë të dallosh shqetësimin poetik të Sali Butkës, të identifkosh rrënjët e tij poetike, frymëzimin dhe tokën mbi të cilën ka hedhur rrënjë dhe ka rritur shtatin muza e tij poetike. I rritur në një familje dhe mjedis të lidhur ngushtë me Shqipërinë, hallet dhe problemet e saj, gëzimet dhe hidhërimet, shpresat dhe zhgënjimet, lotët dhe gëzimet, dasmat dhe vdekjet, ftoret dhe disfatat, Sali Butka qesh dhe qan bashkë me Shqipërinë, lind dhe vdes bashkë me të. Poezia e tij nga fllimi në fund ka vetëm një kryefjalë: Shqipërinë, atdheun të cilin jo rrallë here e quan edhe mëmëdhe, shqiptarët, Kosovën e Çamërinë, por dhe vendlindjen, Kolonjën.

Rrallë gjen një vjershëtor t'i këndojë kështu vendit të vet, popullit të vet. Ky burrë që prej kohësh jeton në kufjtë e legjendës për trimërinë dhe sakrifcat që ka bërë për lirinë dhe mbrojtjen e tërësisë tokësore shqiptare, përpara Shqipërisë ndjehet një fëmijë i pafuqishëm, një burrë i dorëzuar pa kushte, pa rezistencën dhe lëkundjen më të vogël. Ai që nuk u dha kurrë para breshërisë së plumbave, nuk u dorëzua para dhembjes, kur pa dy djemtë e tij shtrirë pa jetë nga plumbat e armiqve, që nuk nxori asnjë tingull ankimi kur i operuan pa narkozë në Bari (e kërkoi vetë) syrin e dëmtuar nga një plumb në betejën e Nikolicës, është gati të kthehet në një qënie delikate dhe të pambrojtur para bukurisë së vendlindjes, është gati të "digjet për bukurinë":

Burime, ju vijmë pranë
në të mira e në të liga;
neve dhembjen për vatanë
dhe ju lotët pika – pika.
(Burimet).

Cila antologji poezie do t'i rezistonte për ta përfshirë në gjirin e saj këtë strofë të kësaj vjershe?

Ujët që ju del nga shpirti
nuk të ftoh, po të ndez gjinë;
të digjesh për bukurinë,
të shkrihesh për Shqipërinë.

"Të digjesh për bukurinë... " Kush nuk do ta kishte zili këtë varg? Kush do të mbetej i ftohtë dhe i paprekur nga imazhi që të zgjon ky varg? Naimi thotë "do të shtritem/ të venitem/ si kandili kur s'ka vaj". Butka është më i prerë: do të digjem...Jo vetëm kaq. Nuk mjafton vetëm djegia. Në mënyrë paradoksale djegia shkaktohet nga uji, uji brisk i ftohtë i Gramozit, siç thonë nga ato anë. Nga uji që përdoret për të shuar zjarrin. Por poezia e Sali Butkës e përdor atë për të ndezur zjarrin në gji. Butka që na ka habitur me bëmat e tij prej luftëtari, tani na habit me imazhet e befta poetike:

Ujët që ju del nga shpirti
nuk të ftoh, po të ndez gjinë:

Aq e fortë është lidhja e Sali Butkës poet me Shqipërinë, vendlindjen, atdheun ose mëmëdheun

(i përdor të dyja format, si për të na treguar se vetëm "atdheu" apo vetëm "mëmëdheu" nuk e nxë dashurinë e tij për Shqipërinë), sa pothuajse në çdo vjershë kryefjalë mbetet nga fllimi në fund Shqipëria, mëmëdheu ose atdheu. Një statistikë domethënëse. I shtyrë nga kureshtja numërova se në vjershat e këtij libri, Sali Butka përdor 103 herë fjalën "Shqipëri", 32 herë fjalën "shqiptarë", 29 herë fjalën "kolonjarë", 64 herë fjalën "atdhe" ose "mëmëdhe".

A nuk tregojnë këto statistika që mund t'i verifkojë kush të dojë se në zemrën e Sali Butkës poet rrihte vetëm Shqipëria, se zemra e tij rrihte vetëm për Shqipërinë?

"Për lirinë, për lirinë,
Lum kush vdes për Shqui[përinë!"
("Lirija")

3.

Nganjëherë më duket se Sali Butka luftëtar i bie nëqafë Sali Butkës poet. Duket sikur i pari përpiqet ta zbehë apo ndoshta ta lërë edhe në harrim të dytin. Natyrisht, pushka e Sali Butkës flakëriti aq shumë sa iu tregoi edhe miqve dhe armiqve, por edhe atyre që nuk shihnin mire apo që nuk donin të shihnin, se kush ishte Shqipëria dhe shqiptari, se kush ishin trojet dhe kufjtë shqiptarë. Por dihet edhe një diçka tjetër, saga heroike e Sali Butkës do të ishte më e varfër pa ditarin poetik. Them "ditarin poetik", sepse kushdo i lexon këto poezi, kupton se ato janë shkruar pas betejave. E shtëna e pushkës është pasuar menjëherë nga e shtëna e penës. Të dyja janë të lidhura aq ngushtë, sa do të ndjeheshin keq pa njëra tjetrën.

Poezia është ditari i jetës dhe betejave të Sali Butkës. Por është edhe një pjesë e mirë e historisë sonë, e ngjarjeve kryesore të saj, e heronjve dhe personaliteteve historikë të saj. Kur u bë Shqipëria, u shkëput nga Turqia dhe u kthye nga Perendimi, Sali Butka ringjall Abdyl Frashërin:

"Ngehu, Abdyl Bej Frashëri
Se t'u mbarua qëllimi
Hidh sytë nga Perëndimi"

Bajo Topulli, themelues i Komitetit të fshehtë në Manastir "Për lirinë e Shqipërisë" anëtar i të cilit ishte edhe Sali Butka, na flet nga poezia "Bajo Topulli" për historinë. Sali Butka poet nuk mund të heshtëte për asnjë ngjarje që lidhej me historinë dhe fatin e Shqipërisë. Në këto beteja, ranë qindar dëshmorë, të cilëve u këndon Sali Butka, për t'i bërë të pavdekshëm, si "Trimit Spiro Ballkameni, Gani Butkës, Jake Panaritit, Nasi Spiro Qafëzezint, Nuçi Trebickës, Qazim Panaritit, Iljaz Butkës e të tjerë, që "u ndrittë shpirti dhe varri".

Të gjitha ngjarjet kryesore të Shqipërisë kalojnë në vjershat e Butkës si në një ekran. Përballimi i ushtrisë

turke të Xhavit Pashës në frontin e lumit Vjosa (vjershat "Vlorës", "Yjet e Shqipërisë", "Ismail Qemalit" etj). Lufta për të mbrojtur kufjtë nga ushtritë greke: vjershat "Mbreti i Greqisë", "Lufta e Qesarakës", "Qaf e Martës" dhe veçanërisht "Një përmendore" kushtuar betejës së Nikolicës, një nga betejat më të njohura ku luftëtari poet humbi njërin sy të cilin e operoi pa narkozë në Bari, për të rrëfyer qëndresën e shqiptarit. Aq jehonë ka bërë kjo ngjarje sa tani ka kaluar në një bëmë që tregohet kudo dhe sa më shumë tregohet aq më tepër kërkohet, sa më shumë vjetërohet, aq më shumë rinohet. Ndodh që edhe ata që e tregojnë të shtojnë pa të keq diçka nga vetja. Kështu ndodh me ngjarje të cilat tejkalojnë protagonistin, fshatin apo krahinën ku kanë ndodhur dhe bëhen pronë e të gjithëve, e gjithë vendit.

Ngjarjet e mëvonshme në kohën e Princ Vidit, të Luftës së Parë Botërore, Republika e Korçës, Kongresi

i Lushnjës, Lufta e Vlorës, Konferenca e Ambasadorëve në Londër, Çamëria, Kosova apo gjithçka që vijoi pas viteve 20 në Shqipëri kalojnë nëpër skanerin poetik të Butkës, ashtu siç kanë ndodhur, ashtu siç kanë qenë. Ato janë ndjerë nga një zemër që rrihte vetëm për Shqipërinë, janë mbrojtur nga një pushkë që qëllonte vetëm në emër të Shqipërisë dhe janë kënduar nga një shpirt i kulluar shqiptar.

Krahas përpjekjes poetike për të shënjuar ngjarje historike, shohim qartazi edhe portretizimin e personaliteteve historike, botën e tyre të brendshme, arritjet, zhgënjimet, gëzimet dhe hidhërimet, të shkrira edhe me ndjesitë e vetë poetit.

Fjal'e tij, fjal'e një plaku,
Zemr' e tij si zemër djali.
Na u ngroh dhe na u ndez gjaku,
për mendimet që na fali.
("Dhëmbje")

Si çdo poet, edhe Sali Butka e ndien dhimbjen dhe gëzimin e krijimit poetik dhe të këngës, nga marrin jetë vjershat e tij:

Ç'është o ç'është këngë e shkretë:
është gaz e është dehje,
është duf nga zemra vetë,
është dhëmbje, është prehje.
(Ç'është kënga")

Ja sesi në dy vargje bën portretin e Shahin Kolonjës, si rilindës, si pionier i shtypit shqiptar:

Ësht'i gjallë Shahin Kolonja,
i derdhur në ato shkronja...

Poeti e përfytyron pavdekësinë jo në bronx, por të derdhur nëpër shkronja, një imazh i papërsëritshëm në letërsinë shqipe.

Ndërkohë që në poezinë e Sali Butkës, gjejmë, krahas epikës, edhe ndjeshmërinë lirike, krahas bukurisë njerëzore edhe bukurinë e natyrës, veçanërisht tek vjershat: "Në mëngjes dola pa gdhirë", "Dit'e verës",

"Frashërit", "Fshati im", "Kolonj' e bukur Kolonjë" etj.

Nuk e di pse në mbyllje të këtyre shënimeve m'u kujtuan fjalët e Luigj Gurakuqit kur e vizitoi bashkë me Mihal Gramenon Sali Butkën në spitalin e Barit, pas operimit të syrit të dëmtuar në betejën e Nikolicës. Bejtes së Gurakuqit "ku je lulja në lëndinë", butkalliu iu përgjigj po me bejte: "Nuk jam lulja në lëndinë/ po guri në rrokullimë".

Nuk ishte frika nga vdekja. Ishte pezmi se kishte mbetur pa njërin sy që i duhej aq shumë për pushkën, por edhe për penën. Edhe pse mbeti me një sy, ai deri në fund të jetës pa aq qartë sa nuk shikojnë as ata që kanë sy shqiponje, siç thuhet. Sepse pa dhe ndjeu vetëm Shqipërinë, pa dhe ndjeu në emër të saj.

PËRBALLË ZIJA ÇELËS, NJË SHKRIMTARI TË MADH...

nga Ali Aliu

Zija Çela është i veçantë dhe i papërsëritshëm për format shkrimore në prozën e sotme shqipe. Ai është krijues i dëshmuar i një bote letrare, që në vetvete ngërthen epoka të tëra të njerëzores dhe të njerëzimit. Pikërisht ky ngjyrim shpirtëror i letërsisë e bën krijimtarinë e Zija Çelës të jetë e dallueshme si për nga vlera artistike dhe ndjeshmëria krijuese, po ashtu për vizionin jetësor e filozofik. Të gjitha veprat e Zija Çelës shpalosin urtësinë se rrugët, ku ecën krijuesi, çojnë drejt së bukurës, drejt përsosmërisë, që është cak i paarritshëm, prandaj të gjitha ato udhëtime mbeten peng i ëndrrave për majat e papushtuara. E më pas nuk mbetet tjetër, përpos t'ia fillosh rishtazi udhëtimit, çka Zija Çela e bën me çdo vepër, si një fillim i ri që ndërthuret me ato të mëparshmit dhe që, së bashku, përbëjnë një udhëtim madhështor drejt shijimit të jetës, shijimi që ngërthen në vetvete të gjitha shfaqjet jetësore, bukuritë, shëmtitë, dramën, komiken, dhembjen, gëzimin, egoizmin, patjetër humanizmin. Veprimtaria krijuese e Zija Çelës ka të pranishme në vete një dimension të pashtershëm, një bërthamë të veçantë: të vërtetën se njerëzimi asnjëherë nuk ka qenë bosh, në mjegull, pa vizion, pa vizionarë. Duke lexuar veprat e Çelës, e kupton se asnjë epokë nuk ka mbetur pa Homer, pa Dante dhe Shekspir, pa Da Vinç dhe Betoven... Arti i Çelës i ndien dhe i parasheh të gjitha rrugët e mundshme të shpirtit e të mendjes. Qytetet e tij metaforike apo me emra realë, e sjellin botën shqiptare në pamje nga më të ndryshmet dhe, siç ka vërejtur me të drejtë kritika, përbëjnë atdheun e tij shpirtëror. "Nëse dikund në letërsinë shqiptare do të gjente zbatim thënia e G.G. Markesit se Makondoja e romaneve të tij më parë se vend gjeografik është gjendje shpirtërore, atëherë pikërisht Mamaci dhe Barabia e romanit "Banketi i hijeve" të Zija Çelës, para se vendbanime, janë gjendje shpirtërore, të cilat në kontekstin e ngjarjeve në roman arrijnë të kuptimësohen. Ky roman është model letrar i përkryer për t'u ngritur në lartësi metafore mbi përmasat devijante të psikologjisë kolektive." (Ismail Syla, Rilindja, qershor 1997) Mbështetur mbi prejardhjen dhe ecurinë e kësaj bote, Zija Çela krijon botën e fiksionit, fantazisë, shtigjet e së mundshmes, të asaj që vjen dhe troket nga larg. Depërtimi në thellësi i intuitës dhe imagjinatës krijuese, shikuar nga kjo perspektivë, del i një dhuntie përmasash madhore. Secila dekadë shënon për autorin lëvizje të veçanta përpara, si në përkapjen e botës, ashtu edhe në përsosjen artistike dhe estetike të diskursit letrar. Zija Çela krijues e vuan rëndë krizën e vlerave shpirtërore. Kur nuk u mungon hapësira për të qenë të lirë, përkundrazi, pikërisht kur janë të lirë, lavidanët e Fifarës (romani „Goja e Botës") nuk dinë t'i japin vlerë lirisë, përkundrazi e gërryejnë nga themeli qytetin e tyre, e bëjnë model abuzimi, arenë tregu të egër, ku lufta për pushtet e pasurim, metodat mafioze, grykësia e bërrylave dhe stërkëmbësave janë brutalisht marramendëse dhe vënë çdo gjë në lëvizje. Modeli i lirisë shqiptare e trondit shkrimtarin që, sa më tepër e vuan bjerrjen e vlerave shpirtërore të qytetit të vet, po aq e acarojnë veprimet e protagonistëve. Dhe, me synimin si nëntekst që të ndryshojnë, merr penën-kamzhik për t'u mëshuar dhe për t'i mëshiruar njëherësh, ashtu si në romanet e këtij cikli që, së bashku me "Arkipelagun", shkrimtari Mehmet Kraja i ka cilësuar si "saga alegorike më e madhe e letërsisë shqipe". Edhe në nivel të diskursit narrativ, ky autor i veçantë është i formatit të madh. Turbulencat e brendshme, të kontrolluara e të artikuluara me mjeshtëri, janë tharmi estetik i kësaj poetike. Rrëfimi i Zija Çelës të mban përherë zgjuar, meritë edhe e ritmit të gjallë të detajeve, të nxit kërshërinë për atë që sjell fjalia, pasusi i radhës, ritmi i situatave që rrjedhin pandërprerë. Në këtë diskurs narrativ, tërë personazhet e korpusit të madh janë në lidhje e raporte të gjalla komunikimi me njëri-tjetrin dhe lexuesi bën kujdes të përqendruar për statusin e tyre, karakterin, filozofinë, anën njerëzore. Ja përse, siç kemi argumentuar edhe më parë, besojmë se Zija Çela është shkrimtar formati me qëndrim dhe vizion qartësisht të formuar ndaj njeriut dhe botës. Është përditshmëria, kërkimi dhe vetëkërkimi dramatik i saj që e nxisin dhe e shqetësojnë këtë shkrimtar, tema që e ndjell dhe përthith ndjeshmërinë e frymëzimit të autorit; është vizioni i tij ndaj realitetit të sotëm shqiptar dhe përtej këtij realitetit, si kapërcim i kohës reale; janë fuqia dhe origjinaliteti i ekspresionit narrativ, perceptimi dhe filozofia origjinale mbi gjithësinë; janë rezonancat e kumteve të forta dhe fryma gjithëherë e pranishme e dashurisë përballë urrejtjes, e jetës përballë vdekjes, që e bëjnë shkrimtar të madh Zija Çelën. Mund të thuhet se tërë proza tregimtare dhe romanore e autorit përbën librin e tij unik, atë me shumë kapituj, në përputhje me natyrën dhe rrugën krijuese konsekuente që në hapat e parë të krijimtarisë së tij. Të gjithë përbërësit e poetikës narrative, personazhet, perspektivat e narratorit, koha, hapësira metaforike dhe konkrete, të kurorëzuara në bukuri rrëfimi, në romanet e Zija Çelës rrezatojnë fuqi tërheqëse, magjike, edhe për faktin se vizioni i shkrimtarit shpërfaqet qartë në tekst, deri edhe si thurje fjalësh, si intonim e ngjyrim, si figurë, si imazh dhe komunikim. Pikërisht për marrëdhënien e tekstit me lexuesin, L. Tahiri arrin në këtë cilësim në një studim të saj: "Ashtu si veprimtaria e Ismail Kadaresë, që e ka mundësuar lirinë e mendimit në kohën e diktaturës më të egër, proza e Zija Çelës e ushqen kreativitetin e leximit në epokën e sotme të kulturës së popullarizuar të konsumit, ndoshta duke vërtetuar kështu faktin se letërsia ka qenë tradicionalisht mjeti më efikas i shqiptarëve për t'u rezistuar ideologjive totalitare, çfarëdo qofshin ato. Me veprën e tij, Zija Çela arrin të krijojë një autoritet të ri, atë të lexuesit, duke iu kundërvënë jo vetëm dogmës së realizmit socialist, që synonte të parandalonte çdo shkëndijë të mendimit kritik te lexuesi, por duke u shkëputur edhe nga realizmi komercial, që e shndërron në konsumator pasiv lexuesin. Një përqasje e këtillë e autorit i shkon për shtat edhe raportit modern të lexuesit me letërsinë." (Gazeta Shqiptare, 2/9 shtator 2012) Ëndërrimi i Zija Çelës për mirëkuptim dhe harmoni mes njerëzve shquhet si tundimi më prekës, më i bukuri në veprën e madhe të tij. Dhe kur komunikohet me tundimet e botës krijuese të Zija Çelës, mbase arrihet të kuptohet më përafërt struktura e botës shpirtërore të autorit, hapësira e trualli ku lind dhe rritet letërsia e tij. Është dhunti kjo e një shkrimtari të madh, i cili jeton prore nën tundimin e sinjaleve, të porosive që pandërprerë vijnë nga thellësitë e qenies dhe të ekzistencës së njerëzimit.

BOTA E MAGJISHME E PIKTORIT FATMIR HAXHIU

Nga Enver Kushi



Fatmir Haxhiu i përket atij brezi piktorësh, që bënë epokë në gjysmën e dytë të shek. XX. Ai i qëndroi besnik deri në fund parimeve të tij krijuese: realizmit dhe pasqyrimit me vërtetësi të momenteve kyçe të historisë sonë kombëtare. Nuk është i rastit fakti, që ai ju përkushtua me aq pathos tablosë kompozicionale, duke na lënë vepra të nivelit europian. Në këto tablo historia e shqiptarëve erdhi epike, dramatike, duke na kujtuar eposin tonë dhe tragjizmin, që e përshkon atë. Nuk e teproj, po të them se tabloja "Me shpatë në dorë", një nga më të mirat e Haxhiut, mund të vendoset denjësisht në çdo galeri botërore. Përpara piktuarve të Fatmir Haxhiut ndjen jo vetëm emocione, por edhe dinamizëm të brendshëm, lëvizje, nerv, "zhurmë", hingëllima kuajsh, zëra njerëzorë, thirrje luftarake, grahmat e fundit të atyre që bien në fushëbeteja. Atje është bota e trazuar shqiptare e ballkanase, por dhe bota e trazuar e vetë piktorit.

Mbaj mend që, poeti brilant Frederik Rrepshja, njeri me shije aristokratike për artin, kur binte fjala për pikturën shqiptare, më thonte se ashtu si në letërsinë shqipe kemi një kryevepër realiste, siç është "Lumi i vdekur" i Jakov Xoxës, në pikturë kemi Fatmir Haxhiun, që të trondit me tablotë realiste dhe gjallërinë e figurave. Kam qenë me fat, që nga mesi i viteve '80 dhe vitet '90, kam ndjekur nga afër, gjatë procesit krijues, shumë nga punët e Fatmirit. Edhe në dy shkrime të tjera, "Hingëllima e ngrirë e kuajve", botuar pasi piktori shkoi dhe "Këmbanat duhet të bien", botuar në mars 2005, kam shprehur mendimet e mia modeste për artistin e papërsëritshëm, mikun tim, që më mungon nga 10 marsi i vitit 2001. Shënimet e mëposhtme në formë kujtimesh, janë një homazh për njeriun dhe piktorin Fatmir Haxhiu. Të ishe mik i Fatmir Haxhiut ishte privilegj, të cilin si shumë të tjerë, e kam patur edhe unë. Tek ai dhe familja e tij, kam ndjerë ngrohtësi njerëzore, veçanërisht në disa momente dhimbjesh, apo fatgoditje gri, që kanë qenë jo të pakta dhe bashkëshoqëruese prej vitesh e jetës time ...

1.

Nuk e di se në cilin vit, iu dha mundësia Fatmirit, që të kishte studion e tij. Ndoshta në vitet '70 të shekullit që lamë pas, kur shumë piktorë dhe skulptorë të Tiranës u bënë me studio. Atëherë ato u kthyen jo vetëm në ambiente pune, por edhe në shkolla të vërteta arti. Në studiot e Odise Paskalit, Abdurrahim Buzës, Janaq Paços, Guri Madhit, Foto Stamos, Shaban Hadërit, Ksenofon Dilos, Sali Shijakut, Naxhi Bakallit, Mumtaz Dhramit, Kristaq Ramës etj., krijohej dhe debatohej për artin, procesin krijues, mjeshtrat e mëdhenj botërorë, planet krijuese, debatohej për magjinë e ngjyrave dhe shkollave të ndryshme të pikturimit, që padyshim ishin në kundërshtim me parimet e ngurtësuara të realizmit socialist.

Fatmir Haxhiu, studion e tij e kishte në katin e parë të një godine të vjetër trekatëshe, e cila ishte në krahë të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, ose në vendin nga ku niseshin autobusët urbanë për në Kamëz. Godina e vjetër, me dritaret e mbyllura me grila ngjyrëgjelbër, që dukeshin si syverbër, nuk e di pse më dukej e vetmuar, e braktisur nga njerëzit dhe e trishtuar. Ndoshta këtë ndjesi e krijonte fasada e saj e rrjepur, muret e lagësht, mungesa e ballkoneve dhe grilat vazhdmisht të mbyllura të dritareve.

E megjithatë, kur hyje në studion e Fatmirit, në të majtë të hyrjes së katit të parë të kësaj godine fatkeqe, si e dalë nga romanet e Balzakut. çliroheshe nga ideja e braktisjes apo e vetmisë, që ajo të krijonte. Studioja kishte shumë dritë, që vinte nga hapësirat e mëdha të xhamta dhe sapo hyje, vështrimi menjëherë përqëndrohej në telajot e përmasave të ndryshme, vendosur në qendër të studios. Në to, syri të kapte punë të saponisura, të tjera që ishin drejt përfundimit apo dhe të përfunduara, por që mjeshtri akoma kërkonte t'i kishte pranë. Fatmirin rrallë, shumë rrallë e gjeje ulur. I gjallë, hokatar e i qeshur, me penelat në duar, i veshur me rrobat e punës, ku dalloheshin njollat e bojërave, të priste me thirrjen: "Oh kush na erdhi! Sa mirë bëre që erdhe!". Ndjeja në zërin e tij të ngrohtë, sinqeritet të veçantë dhe gëzim të brendshëm. Sepse Fatmir Haxhiu i çiltër si ai, u jepte të gjithëve, veçanërisht atyre që i konsideronte shokë dhe miq të vërtetë, shumë nga shprti i tij i madh. Në fillimet e njohjes me të, jo vetëm isha i drojtur, por e kisha të vështirë t'i bëja ndonjë vërejtje apo sugjerim, që ai kërkonte për punët e tij. Ndoshta kjo nuk ishte thjesht droje apo mungesë kulture në të kuptuarit dhe zbërthimin e pikturës.

Puna në Kinostudio, bisedat me emra të njohur të filmit shqiptar, si regjisorë, piktorë etj., shfletimi i shumë albumeve të piktorëve të njohur botëror në bibliotekën e Akademisë së Arteve, leximi i disa botimeve të kohës për pikturën dhe skulpturën, kishin shtuar njohuritë e mia për artet figurative. Në pikturën e Fatmir Hahiut, më pëlqente realizmi, dinamizmi i brendshëm i kompozimeve, portretet e shumta, dhënë gjithmonë në lëvizje, kuajt e pranishëm thuajse në shumicën e tablove dhe pikturuar mjeshtërisht prej tij. Rrija gjatë para tablove, ndërsa ai vazhdonte të punonte e të më "sajdiste", duke folur për tema të ndryshme. Pastaj tërhiqesha ngadalë, për ta lënë të qetë në punën krijuese.

2.

Pranë derës së studios ose pranë portës së madhe, që dukej si hyrje kështjelle, sepse herë-herë ajo më ngjasonte me një kështjellë, jo vetëm nga hapësira e madhe e saj, por dhe nga llojet e armëve, që ishin në të, si shpata, pushkë, mitralozë, automatikë, revolverë, uniformat ushtarake të periudhave të ndryshme, mburoja etj, por dhe me historinë që ishte fiksuar nëpër shumë telajo, ishte një tavolinë jo shumë e madhe. Mbi tavolinë, rrëmujshëm shpërndaheshin fletë të bardha, skica të ndryshme, bocete, fotografi, lapsa, penela të vegjël. Në një skaj të tavolinës dallohej një receptor i vjetër telefoni, ndoshta i viteve '50 ose dhe më i hershëm, nga ata që janë përdorur në ushtri. Fatmiri herë-herë shkëputej nga puna, rrotullonte mekanzmin si mulli kafeje të receptorit të tij dhe lidhej me Letin. Unë lëvizja nga tavolina rrëmujë për tek etazheri i librave dhe albumeve të shumtë të piktorëve të mëdhenj botëror. Më bënin përshtypje titujt e librave në shqip dhe gjuhë të huaj, ku vendin më të madh e zinin botimet mbi historinë e Shqipërisë, apo atë botërore. Nuk mungonin albumet me kostumet popullore shqiptare, fotografitë me peizazhe nga natyra e bukur e vendit tonë.

3

Në historinë e kulturës botërore gjenë shembuj jo të paktë të krijuesve, që vuajnë nga narcizmi. Narcizmi në art, për mendimin tim, në një farë kuptimi është vetëvrasje për shkrimtarin, piktorin, skulptorin, kompozitorin, për artistin në përgjithësi. Autorët e kryeveprave të artit dhe kulturës botërore, që nga qytetërimet e lashta e deri në ditët tona, gjithmonë kanë qenë të pakënaqur me veprat, që kanë realizuar. Edhe në kulturën shqiptare, ka shembuj të personaliteteve me emër, që janë rrethuar nga heshtja në kohën kur kanë krijuar, me modesti të admiruar, larg zhurmave apo borive lajkatare, i janë ruajtur narcizmit. Piktori Fatmir Haxhiu asnjëherë nuk u dashurua me vetveten, asnjëherë nuk u kënaq me veprat e tij, ndonëse ajo u vlerësua brenda dhe jashtë vendit në ekspozitat e çelura në Itali, Francë, Greqi, Austri, Kinë etj. Shumë punë të tij janë pronë e individëve të veçantë koleksionistë apo institucioneve të ndryshme, si në Spanjë, Angli, Austri, Zvicër, Itali, Greqi, Turqi e deri në SH.B.A, Japoni e Kinë.

Mbaj mend tri punë, shumë dinjitoze të tij, të cilat i kam ndjekur gjatë realizimit të tyre: "Tereadorët", "Dashuria e kuajve" dhe një tablo me motive nga Skënderbejada. Dy të parat janë në Spanjë dhe për fat të keq, nuk u ekspozuan para dy vitesh ne ekspozitën retrospektive të Haxhiut, çelur në Galerinë Kombëtare të Arteve. Tablonë "Tereadorët", sapo e përfundonte, të nesërmen e ndryshonte nga e para. Me të ai u mor muaj të tërë, gjithmonë i pakënaqur, derisa më në fund e vendosi në pjesën e pasme të studios, të përfunduar, ndoshta për të mos e patur para syve, sepse prapë mund ta ndryshonte. Atëherë unë i dhashë për të lexuar një tregim të shkëlqyer të një prej prozatorëve më të dashur për mua, Heminguejit. Mbaj mend që për këtë temë, gjithashtu folëm gjatë e ndoshta atmosfera e tregimit të Heminguejit, mund të ketë ndikuar sadopak në tablonë "Toreadorët".

4

Në orën trembëdhjetë e pesëmbëdhjetë minuta, ai linte penelin dhe bëhej gati për të shkuar në shtëpi. Pasi mbyllte portën e madhe të studios kështjellë dhe lutjeve për ta shoqëruar edhe unë në shtëpi, sepse Leti kishte përgatitur

(Vijon në faqe 9)



FLUTURA E NËNËS SIME

Tregim nga Istref Haxhillari

Teksa motra zbriste shkallët e shtëpisë, përkrye portës u dha një flutur e kaltër, me pika të lehta bojëgruri, e bukur magji. Praruar nga rrezet e diellit në perëndim, zhytej fashave të dritës, flatronte mbi kokat tona, fshikte krahët mureve, tavanit, kanatave.

Motra mbajti frymën.

- Tataja! - belbëzoi e mallëngjyer.

Lot malli vezulluan faqeve të rreshkura.

U kthye majë gishtave, hapi derën. Flutura u derdh korridorit, përshkoi kuzhinën, kryqëzoi këmbët e vogla *mbi oxhak*, u rrotullua të orientohej. Kërceu mbi perden e dritares së lumit, vështroi cazë matanë ballkonit, ktheu kokën, sikur donte ta thoshte diçka me gjuhë flatrash. Njihte çdo qoshe të fshehtë nga ato që ne me zor i shquanim. Fëshfëritja e krahëve u ngrit mbi heshtjen misterioze, muzikë e ëmbël pikuar prej qiellit, çau cipën e hollë të plagës dhe ajo zuri të pikojë gjak. Zemra m'u mblodh lëmsh. Si ia kisha dalë dhjetë vjet të ndrydhja mallin për nënën time, si dreqin kisha qeshur e bërë shaka, ndërsa ajo prehej në varrezat e qytetit? *Krijesa bojëgruri pruri jehonën e një kohe të artë, kur Tataja i jepte jetë shtëpisë*. Vitet rrëshqitën mbrapsht, zëri melodioz vërshoi lumë i rrëmbyer pas shirave litar të pranverës, a jehonë ardhur nga lart, të kallëzonte përrallat e fëmijërisë...

Sa histori të vjetra zhytur humbellës së moteve tregonte nëna ime e mençur, thua ndrynte në mish, eshtra e gjak të fshehtat e botës të cilat nuk i shteri një jetë të tërë! Njihte majë gishtave çdo shtëpi, arë e rrugë mbushur dëngëza me ngjarje, si qenë dikur e si ndryshuan vragave të kohës, dinte çdo varr të vjetër, sheshuar prej kohës, se njerëzia harruar pas punëve të përditshme i patën lënë pas dore. Mbante mend kullat e Jasharit senenë kur i përlau përroi i fryrë për qamet si të mos qenë kurrë, e dinte ku e pati shtëpinë xha Seli dhe ku e ndërtoi më vonë, i kujtohej hakmarrja e Spahinjve me kolonelin e frëngut që deshi të çnderonte Nadiren, çupën më të bukur të fshatit.

Ledhatonte një rrënjëz domate të shkelur, ngulte sytë diku, harkonte vetullat, para se të dëftente bëmat e çuditshme, ku fantazia ime prej fëmije mezi depërtonte. Personazhet imagjinare lëvrinin nga Guri i Kamjes e Valamara te guvat e Malit të Thatë, nga brigjet e rrëpira të Shkumbinit te Liqeni i Ohrit. Rrëfimet mbanin aromën e barit të kositur ku pluskon era e luleshtrydheve, kundërmimin e dheut kthyer nga parmenda, fërfërimën e pikave të shiut në të mbaruar të ditës. *P*eizazhet kishin ngjyrat e ftoit të lulëzuar, lulekaçeve të porsaçelura, gjetheve të arrës ngjyer në të gjelbër. Mbushej me frymë të çlodhej dhe tok me fjalët fironin bota e stisur, e bukura e dheut, divi, ariu i kafenjtë. Ndërsa vija e ujit, kopshti i vaditur, filizi i drejtuar i domates ishin aty njëlloj si më parë, mendja ime e njomë orvatej të kuptonte si i ia dilte arra të ngjyente një më një tërë ato fletë!

E sëndisja sa s'thuhet me kureshtjen time të mallkuar, po tinës vija re se në një farë mënyre e çlodhja nga andrallat. Shpesh s'kishte nge, sajonte aty për aty përralla të reja, ose fillonte nga e para të vjetrat, të më hiqte qafe.

- Më nxori nga mendtë! - e dëgjova t'i thoshte një mbrëmje hake Këzes, - bëra si bëra çalltisa një, po do ti humba fillin. Ai s'dha e mori, e vazhdoi gjer në fund pa gabuar, ke parë kështu malukati?

Bari i kositur livadheve, yjet kupës qiellore, oshtima e erës zemrës së dimrit, kënga e përrenjve gufuar nga bora e shkrirë e gazmonin. Harmonia e botës, paqja, mirësia njerëzore ishin parime e saj më të larta. Nuk njihja tjetër të prekte aq fisnikërisht zogun e rrëzuar nga shtrofulla, një filiz të çapëlyer kumbulle, këmbën e kalit të plagosur, nanurisur me shprehje hirplote si të qenë fëmijët e saj. Ku i gjente tërë ato fjalë? Si ia dilte të shkërbente njërin pas tjetrit zërin e çjerrë të sprijës së ligë, pastaj pëshpërimën e ëmbël të engjëllit? Si arrinte të bënte bashkë fjalët e njerëzve me hungërimat, mjaullitjet, bulurimat e kafshëve? Sa dua ta dëgjoj tani atë zë plot ngjyra, të shijoj pamjen e ëmbël prej nuseje me sy të perënduar nga dhuntia e rrëfimit!

I mësova një për një përrallat me xhinde, katallanë, botën e nëndheshme të vdekatarëve, historitë e burrave zulmëmëdhenj që vulosën dikur fatet e vendit. Të folurit e pleqve, zërin e ngjirur të kapedanit, britmat e komitëve, i mbajta mend gjer vonë, pa ditur se do të më hynin aq shumë në punën time të ardhshme. Kur shkruaj, ndiej vështrimin e syve të saj prej qiellit dhe ngutem të mbush faqet njërën pas tjetrës. E shtrenjta nënë më dha leksionin e parë të letërsisë.

Librat e mi mbajnë hiret e saj...

Tetë vjet s'u mësua me qytetin, thua pati ardhur mikeshë për pak kohë, priste të kthehej atje ku i bënte shpirti rehat. Dilte në ballkon, kulloste sytë maleve ku gjelbëronte lisi, rrugëve mbushur me kalimtarë, masës stërmadhe të ujit në liqen.

- Pashë xha Minin sot, - tregoi një mbrëmje, - ishte plakur e kërrusur i shkreti, ama u çmalla, sikur solli një grusht dhe' fshati poshtë ballkonit.

Sytë i ndrisnin nga gëzimi.

Të nesërmen kërkoi ta shpinim në fshat.

- Sa të çmallem me njerëzit, - psherëtiu e menduar.

- Nja dy-tre ditë, - i thashë buzagaz.

- Epo çdo të rri më shumë! - u gjegj serioze.

Mbështetur krahut të motrës u ra kryq e tërthor udhëve të fshatit, bekoi me ujë e kripë varret e të parëve, takoi moshatarët pakësuar së tepërmi viteve të fundit. Sytë e mbushur binin të malluar mbi njerëzit, shtëpitë, kasollet, të mbjellat. Çdo fillim gushti vinte me babanë të shinin thekrën në Kozic, qëndronin dy javë larg shtëpisë. Tani nuk ngjitej dot ta shihte për herë të fundit. Lot të nxehtë iu mblodhën nën mjekër.

Në mbrëmje zuri vendin e dikurshëm pas trungut të arrës së madhe, plasaritur e zgavruar nga vitet. Dielli në të perënduar lyente me purpur bashkat e reve, tisi ngjyrë bronzi ndehej si njëherë e një kohë mbi gjethnajën vigane, flladi erëmirë ia ledhatonte cullufet mikeshës së vjetër. Kushedi sa herë pati kuvenduar aty me moshataret, kushedi sa herë patën qeshur e qarë me gazet e brengat e jetës. Tani shumica preheshin në pllajën me tuma dheu matanë lumit, të gjallat rrëgjuar pleqërie, nuk çapiteshin dot gjer te arra. Sytë e mjegulluar nga lotët u endën skutave ku rrinin atëherë. Tikua hundëmadhe shtrohej mbi koritën kthyer përmbys, pinte duhan, nuk linte njeri pa ngarë. Këzja ulur në bisht për qosh trungut numëronte dertet e pambaruara.

Befas iu bë se Ishka pas saj, lëvizi vendit, i vuri dorën në pëqi.

- Erdhe, tata Selviko? Të kemi pritur, na mbetën sytë udhës së qytetit!

S'pati fat e zeza, burrë sa për të thënë, një e dy çapin aty e mbante, nxirrte gulçin.

- Ç't'i bësh! - bashkoi dorën më të sajën, - ky qe fati yt.

- Pse kaq i hidhur?

- E de, mjaft u qave, ka më keq.

- Ashtu xhanëm! - fshiu hundët me mëngën e fustanit.

- S'e paske harruar zakonin, sa herë të kam thënë? Tuhaf njeri mbete!

- Uh, harrova, ama dhe ti!

- Për të mirën tënde e kam.

- Mirë të thotë, - e ngau Këzja, - na e shpife!

- E de, mirë, oj po kjo!

Qeshën të gjitha.

- Sheqere, ti je moj derëbardhë? Sa më paska zënë malli! - iu kthye rrënjës së dalë të arrës, ku rrinte duarkryq me sytë përdhe.

Ajo tundi kokën si t'i thoshte:

- Unë që mos qofsha, hanko Selviko!

- Si nuk fole njëherë, vetëm dëgjo e qesh.

- Tani s'mundem, - iu bë të përgjigjej Sheqerja.

- Epo s'ke se si!

Ajri kërciste, thua shpirtrat e uritur nga malli orvateshin ta ceknin me duar prej ajri. Dhe s'kishin faj, i la të prisnin gjatë!

- Ndjesë paçin, - ngriti zërin, - sa të mira ishin!

Ku ta dinte ç'i ndodhi? Ndoshta mosha bënte të vetën, ndoshta shpirti i ngazëllyer në atë perëndimi të hatashëm dielli u bë njësh me to.

Përkëdheli me sy siluetat e mbledhura për hatrin e saj, rregulloi shaminë, i vuri dorën në sup së bijës, zverdhur gjethe ftoi.

- Se si m'u duk, - u shfajësua, - thua erdhën vërtet!...

Në krye të javës nuk më nxinte shtëpia, një lëmsh në fund të barkut më pengonte të merrja frymë lirisht. Pse kërkoi ta shpinim *edhe njëherë atje*? Pse ndenji aq gjatë? Mos përfundoi në varreza dhe nuk donin të më thoshin? Mora gjithë ankth rrugën e fshatit ta shtija edhe njëherë ndër sy. Përfund arës së lumit shqova



siluetën e drejtë, supet e ngritura, floknajën verdhashe dhe më vajti zemra në vend. Ecte sa ecte, ndalonte pak, bënte më tej të merrte sa më shumë mbresa.

Motra e ndiqte kokëvarur.

Vrapova sa do ta kishte zili çdo kampion atletike, i hodha krahët rreth qafës, i futa kokën në gji, e nuhata...

E pamundur të ngopesha, sikur edhe e kisha edhe s'e kisha aty.

- Ngadalë, ore, më mbyte! - qeshi me masë.

Si më pa të zbehur, e kuptoi.

- Mos bëj kështu, ja ku e ke nënën tënde. S'i kam mbaruar të gjitha punët e kësaj bote, tërë ata nipa e mbesa pa martuar!

Nuk ia vura veshin.

- Erdha të marr, - i thashë.

M'i hodhi sytë e bukur, të lodhur.

- Prit ore, të çmallem cazë, ku dihet çka shkruar Zoti?

- Mjaft sivjet, ja erdhi moti, - zvarrita fjalët sa më qetë munda.

Nuk i thashë se mezi e shtyva një javë, se po të ikte andej nga e thërriste s'di se kush, do të marrosesha, se ishte përtej mundësive të duroja...

Ende kërthi, një mëngjes gushti në valën e punëve, u gdhiva aq sëmurë, sa të gjithë ma hoqën fillin, përveç saj.

- Nuk do të vdesë, - u tha motrave.

Ato prenë të qarat...

- Pse aq e sigurt? - e pyeta vite më vonë.

- E pashë në sytë e tu, - u përgjigj gjysmë me shaka, - nuk vuaje nga ndonjë sëmundje, hidhje vickla si mushkat se të lashë vetëm atë ditë...

Njëlloj si atëherë më dhembte trupi, më çanin kockat, mendja më vinte rrotull, s'isha as në qiell, as në tokë.

I erdhi keq, ma mori kokën në gji, siç bënte gjithnjë në vogëlinë time.

- Po ti qenke prush, o bir!

Përfshiu me sy të rrëmbushur shtëpinë, pusin, arrën, bahçen e mollëve gjer tutje ku arrinte vështrimi. Ia kishte ënda të rrinte edhe ca, të çmallej me njerëzit, dheun, varret e të afërmve, po unë e desha të tërën për vete.

Rëndova më tepër.

- Njeriu s'ngopet kurrë me vendin e tij, - psherëtiu.

Sa u kthye zuri shtratin. Humbi gjallërinë e dikurshme, bebëzat iu çngjyrosën. E gdhinte me sytë tretur rrugës së Tiranës, ku qëllonte të vonohesha me tim vëlla.

- Do të vinë, ke për të parë, - i jepte kurajë gruaja.

Lutej me vete të kishte të drejtë.

- Ah, moj bijë, nënë mos qofsh, veç për keq shkon mendja.

Ktheheshim, i vinte çehrja, na prekte duart e ngrira nga të ftohtit e janarit.

- Sa i ëmbël evlati! - pëshpëriste me zë të mpakur...

Flutura ndaloi mbi supet e motrës, nguli këmbët leshrave, përplasi krahët të ruante ekuilibrin. Sa herë matej të ngrihej fluturim, ndërronte mendje, kthehej t'i terte lotët.

Nuk i ndava sytë...

Ditën fatale erdhëm afër mëngjesit. S'u ankua, lëvizi paksa kokën, na vështroi me sy të shuar. Thirrëm ambulancën, e zumë për krahësh të zbrisnim shkallët. Këmbët mezi i hidhte, më shumë e mbanim peshë.

- Pret makina! - e nguta.

Shpejtoi pak hapin, më hodhi sytë e murrëtuar, sikur donte të thoshte:

" S'e shikon si jam katandisur, o bir? "

Ato fjalë më gjëmojnë në vesh sot e kësaj dite. Si nuk telefonova të mos e gdhinte natën në ballkon atij janari të acartë?! Si nuk më shkoi mendja ta shpija më parë te mjeku? Përse vonova aq shumë?

- E le pas dore, - më tha atëherë shoku im Kimi.

Desha t'i shkrehesha, po sakaq e kuptova, sytë e tij të çiltër thoshin të vërtetën! Dhjetë vjet mbajta mbi shpinë barrën e rëndë të fajit. Qava, thirra si i marrë, përplasa kokën pas oxhakut pa kurrfarë dobie.

Guri i fajit u fundos thellë e më thellë.

Plaga zuri kore...

I thashë vëllait të njoftonte motrën e madhe në Tiranë. Ajo ngriti sytë ta shihte, thua do t'i vinte atij çasti. Si nuk e pa, u ndeh pa frymë, mbylli sytë. U mblodhëm gjithë sa ishim, e përmendëm. T'i kishte ardhur Shqipja, do të mbaronte, nuk mund të ikte pa e parë për herë të fundit.

Tërë natën në jerm, jepte e merrte.

Ne qanim fshehtas.

- Nuk do ta shohim më kurrë, - çau heshtjen një zë i ngashëryer.

Gruaja ime u sul jashtë, duke shkulur leshrat.

Ne, pjellat e saj, që as guxonim ta sillnim në mendje vdekjen, u dorëzuam. Motrat dilnin një nga një, mekeshin së qari diku, ktheheshin me bebëza flakë të kuqe.

Tataja i diktoi, nuk u mashtrua as tani në grahmat e fundit.

- Mos ikni, - u tha me ndërprerje zëri, - dua t'u shoh, s'kam kohë.

Kaloi sytë nga motra e madhe te vëllai, i fundit i fëmijëve.

- I vogli i nënës, - lëvizi buzët mundimshëm të prapmen herë.

Mbylli sytë...

Flutura kaltëroshe fëshfëriti krahët u ngrit, më preku shkarazi llërën, iku si të kishte përmbushur misionin e vet qiellor. Vitet s'paskëshin bërë tjetër përveçse të zbërdhulnin së kujtimet si fotografitë e vjetra në mur. Malli kishte marrë fytyrën e pritjes. U plasa në dysheme, e qava përsëdyti të bukurën time leshra flori. Motra fshiu lotët me cep të shamisë, u qas, mbështeti dorën supit tim, më ledhatoi me dashurinë e vet dhe nënës përzier së toku.

- E zuri malli, pa u kthye, - pëshpëriti e përmalluar, - të qe zemëruar nuk vinte.

Unë nuk e mblidhja dot veten...

(Vijon nga faqja 9)

një drekë të shijshme, kapërcente me shpejtësi rrugën e Kavajës. Në orën trembëdhjetë e tridhjetë minuta, dilte nga dyqani i bukës, që ndodhej poshtë pallatit përballë dhe me hap të shpejtë kalonte mes lulishtes Rinia, tek ura e Lanës, për të dalë në trotuarin në krah të Piramidës. Në orën katërmbëdhjetë, gjithmonë në këtë orë, ulej në tavolinën e ngrënies, ku nuk mungonte asgjë, falë përkushtimit të Farziletit. Pasdite do të rikthehej në studio nga e njëjta rrugë dhe me të njëjtin regjim të rreptë pune dhe pasioni, do të vazhdonte të hidhte në telajo portrete, peizazhe, kompozime...

5

Fatmir Haxhiu, nga të rrallët piktorë shqiptarë, ndoshta dhe i vetmi, figurën e kalit e ka të pranishme në shumicën e tablove kompozicionale të tij dhe në shumë punë të përmasave më të vogla. Ai ishte njohës i thellë i kalit. Dhe jo vetëm i anatomisë. Piktori, në rradhë të parë, njihte shpirtin e kësaj qënie fisnike, shumë më fisnike se çdo qënie tjetër, përfshirë këtu edhe njeriun. Ai e adhuronte dhe e dashuronte kalin, jo vetëm për faktin se në ushtri kishte qenë pranë kuajve, por edhe se vetë ai, me natyrën e çiltër, sinqeritetin, nuhatjen e së keqes, shpirtin e madh, siç duket e ndjente veten mirë pranë tyre. Piktori dhe njeriu Fatmir Haxhiu, që luftoi dhe besoi shumë në lirinë e vërtetë e dinjitetin e njeriut, gjatë jetës së tij ndjeu dhe provoi falsitetin, intrigën, shpifjen, cmirën. Ai që u fali të tjerëve mirësi, sinqeritet, duke i shprehur hapur mendimet e tij, në shumë raste provoi të kundërtën. Siç dëshmon në kujtimet e veta, i biri, Artan Haxhiu, piktori në vitet 1981 – 1982, në kulmin e kokëprerjeve në ushtri nga diktatura, kaloi një traumë të vërtetë: në një foto të madhe botuar në gazetë, ku me "udhëheqësin" kishin dalë shumë piktorë e skulptorë, portretin e tij e retushuan, pastaj nxituan ta largojnë si pedagog nga Instituti i Lartë i Arteve, tablonë "Kalimi Divizionit të Parë në Veri" e dogjën, në emisione të Radiotelevizionit nuk e ftonin më si dikur etj., etj.

Piktori kishte të drejtë: kuajt ishin më të çiltër, më fisnikë, më të mirë.

Kur unë, (mund të ketë qenë viti 1999), i tregova se doja të shkruaja një novelë për kuajt dhe ëndrrat e tyre, Fatmiri sa herë që e takoja, më fliste me pathos, për botën fisnike të kuajve, kodet e marrëdhënieve dhe mirëkuptimit mes tyre dhe njeriut, për dashurinë që fal kali, kur e kupton se i zoti e do me të vërtetë, për sakrificat që bën gjithashtu ai për njeriun, apo për egërsinë e tij, kur nuhat pabesinë e njeriut.

...Dhe kur pashë të përfunduar tablonë "Dashuria e kuajve" (1998), ndoshta e fundit me këtë motiv, kuptova botën e madhe, përtej njerëzores të kalit. Tabloja në fjalë, e cila ndodhet ne Spanjë, ka shumë mirësi, shumë ngrohtësi, shumë fisnikëri edhe nga krijuesi i saj Fatmir Haxhiu. Ajo, me gjuhën e ngjyrave, ku dy kuajt e përqafuar me njëri-tjetrin në një hapësirë të jashtëzakonshme dhe atmosferë tejet të tejdukshme, duket se i flet shumë botës së trazuar njerëzore, për fat të keq e mbytur nga vesi dhe shumë prapësira të tjera.

6

Fatmir Haxhiu shkoi në prag të Ditës së Verës, më 10 mars të vitit 2001. Them "shkoi", sepse fjala vdekje ose ndërroi jetë, tingëllon keq para emrit të çdo krijuesi të fushës së artit, kulturës apo shkencës. Ai pati një goditje të beftë në zemër, jo në ndonjë fushëbetejë lufte, por në një fushëbetejë tjetër: atë të shahut. Vetëm kështu mund të shkonte ai si qindra luftëtarë të tablove, që kishte pikturuar gjatë gjithë jetës. Fatmir Haxhiu shkoi me një peng të madh, sepse nuk arriti të realizojë, ndoshta ëndrrën e tij të fundit, pikturën murale "Beteja e Fushë Kosovës". Gjatë vitit 2000 dhe pak kohë para se të shkonte, piktori kishte rrugëtuar për në Kosovë, ku ishte njohur me vendin, ku më 1389 ishte zhvilluar beteja e ballkanasve të bashkuar me ushtrinë otomane. Në Tiranë ai punoi intensivisht dhe bëri gati bocetin, që do ta realizonte gjatë muajve prill ose maj në Muzeun e Prishtinës. Pikturën murale do t'ia dhuronte Kosovës. Boceti mbeti i parealizuar dhe është në dhomën studio të shtëpisë së piktorit ku ruhet me kujdes nga familja e tij.

Tashmë që Kosova që prej 17 shkurtit tw vitit 2018 është e pavarur, nuk e di pse, ashtu si në poemën "Milosao", ku në fund personazhi kryesor kërkon të shohë për të fundit herë Shkodrën, unë kërkoj që të hapet dritarja e madhe e shtëpisë së piktorit Fatmir Haxhiu, nga ku shpirti i tij të mund të shohë Kosovën e lirë e të pavarur dhe kuajt jo më të ngrirë që prej 600 vitesh të Fushë Kosovës.

(Bajram Sefaj: "Përballë Kolosit", Faik Konica, 2021 - Prishtinë)

KONTURET E PAKRYERA PËR NJË VEPËR TË PËRKRYER

Nga Shaip Beqiri



Indodhur në prag të të tetëdhjetave, më se gjashtëdhjetë prej të cilëve i ka kaluar me penë e mikrofon në dorë, para letrës së bardhë e llambave të ndezura të kamerës, Bajram Sefaj mëton të vërë kulmin e tërë kësaj përvoje krijuese brenda kapakëve të një libri aspak të rëndomtë për Ismail Kadarenë dhe për veten e vet. E kujtoj shkrimin e parë të këtij autori "Shkruan Ymeri pa u ndalur...", botuar në Prishtinë para plot gjashtëdhjetë vjetësh, një portret krejt i rëndomtë për një djalosh që kishte botuar vjershën, skicën dhe tregimin e parë, për të ndjekur një jetë të tërë njeriun që në tërë këtë kohë epokash të ndryshme nuk ka bërë asgjë tjetër përveç që ka mbajtur të gërshetuara deri në shkrirje të plotë gazetarinë dhe letërsinë. Janë shumë autorë gjithandej që kanë ndjekur një udhë të tillë në krijimtarinë e tyre, të tillë ka paksa tepër edhe ndër ne, por në këtë cak asnjëri nuk është si Bajram Sefaj. Në kapërcyell mileniumesh, koha kur Ismail Kadare zuri majat e afirmimit të veprës së tij letrare në përmasa botërore, siç nuk e kishte bërë askush tjetër nga shqiptarët e as nga harku i gjerë i Gadishullit Ilirik përpara tij, natyrisht që përafërsisht në atë përmasë u bënë edhe botime librash nga më të ndryshëm për të dhe sidomos për veprën e tij me vlerë sipërane artistike. Pikërisht në këtë periudhë kohe tridhjetëvjeçare, kur u mbarështuan, u shkruan dhe u krijuan afërsisht aq tituj librash për Kadarenë dhe veprën e tij, Bajram Sefaj përgjatë tërë kësaj kohe mblodhi lëndën e librit të vet për Kolosin. Ai nuk e fsheh drojën, ngurrimin e hamendjen që kishte nëse do t'ia dilte ta bënte të prekshme një ëndërr të vet kaq të paarritshme. Ndjekja në kohë të gjatë e gjurmëve të penës vetjake, duke parë emrin e vet në ballina jo të pakta librash, e ka mësuar se çdo libër, qoftë edhe me mëtesë sado të vogël, së paku duhet të ketë shtyllën e vet kurrizore. Mbërthimi pas asaj shtylle, që është përkthimi dhe ndikimi i fenomenit të tij në njohjen kaq të gjerë të veprës së Kadaresë në botë, autorit tonë i jep shkas të gjurmojë, duke gërmuar pareshtur për të shpënë më tej idenë e tij të ballafaqimit me Kolosin. Veshja me pjesëza e copëza të tjera, duke ngallmuar nëpër skeletin e idesë për përkthimin e çdo gjëje tjetër që po i vjen për dore, sigurisht që ka jo pak përparësi, por nuk mbetet pa dobësi e pa ngathtësi të caktuara. Kjo mënyrë shkrimi i detyrohet pikësëpari përsëritjes së të njëjtave të dhëna, cilësime, epitete e formulime pafundësisht të pakursyera. Herën e parë, të gjitha këto të përftojnë përshtypjen sikur je duke soditur shkumëzimin e një rrjedhe në reliev të ashpër guror, që është natyra e shkrimit me pasion e emfazë, por paskëtaj të shfaqet papritur uji i kulluar i asaj rrjedhe që shpërthen vetvetishëm, duke u shpërndarë gjithandej atij relievi rrëfimor, tek i cili lë prapa vazhdën e ndritur... Autori ka vënë në përdorim çdo formë të shkrimit, të gjitha mënyrat e thurjes së tij, që nga skica, miniatura, monologu pa fund, dialogu i përkorë, reportazhi, rrëfenja, eseja e trajtesa. Kur ndalesh dhe i vëzhgon me kujdes, të del se ai në të vërtetë ka bërë konturët e hollësishme të një poeme të pakryer për veprën e përkryer të shkrimtarit gjenial shqiptar. Në soditjen time të kësaj ngrehine të Sefajt, dua të bëj një parantezë që e jep më të plotë vëzhgimin e autorit te hollësitë çmeritëse. Nuk është thënë më kot që edhe djalli atje fshihet. Tërë shkumëzimi prej sharjesh, shpifjesh e shtjellash të tjera të adhurimit apo të zhgënjimit, nuk do ta bënin më mirë, më bukur e më thellë portretin e Kadaresë sesa e bën Sefaj me dy fjali krejtësisht të rëndomta: «Më kujtohet, si të kishte ndodhur sot paradite, Kadare as që më falënderoi për këtë gjest modest. Ani, s'ka lidhje, shkrimtari i shquar, ka punë më të rëndësishme!» Nëse është e mjaftueshme dashuria në punë të shkrimit, ky libër i Bajram Sefajt qëndron te majat e kësaj piramide. Disa mesazhe jo rrallë lexohen më thellë e më bukur në shkëlqimin e syve të atij që i përçon ata sesa në gjëmimin e artilerisë së rëndë të fjalëve kumbuese. Për të tjerat mund të flitet gjerësisht dhe me jo pak vërejtje. Derisa autori me kaq përvojë krijuese e urtësi njerëzore e shpall një libër të vet **jetësor**, le të jetë për ne një libër dashurie, të cilit i japin ngjyrim përmasat e letërsisë të papërsëritshme të Ismail Kadaresë.





ROLAND GJOZA: POEZITË – 14 LIBRA

EGOJA DHE ALTEREGOJA E NJË POETI NË AMERIKË

EGO - Më në fund unë mund të shkruaj ndryshe në Amerikë. Gjithsesi: Walcome në terminalin e aeroportit JEK në Nju Jork, a nuk është një shpresë?!

ALTEREGO - Pse gënjen veten, pse s'thua të vërtetën se ti ke dështuar me kohë në poezi dhe Amerika të shërben si një alibi. Ti je një frikacak, nuk erdhe kurrsesi për t'i shërbyer poezisë po ekzistencës banale. E ç'të pret? Nj punë manuale, rraskapitëse, se ti nuk ke asnjë zanat. S'di as të ngulësh një gozhdë...

EGO - Po kam një shpresë, të siguroj se diçka e mirë do të ndodhë me mua. Ma ndien zemra po ta them me guxim se mua do të më ecë.

ALTEREGO – Ti je një dështak optimist. Ty të prej barku i Nju Jorkut, jo koka e tij. Ti je thjesht një numër në statistikat e emigracionit. Unë nuk shoh asnjë shenjëz sado të vogël drite dhe ti e parandien këtë, po s'do ta pohosh, se nuk të lë hunda.

EGO - E vërteta është me ty gjithmonë, po ajo është shumë cinike. Po vuaj. S'po më ecën fare, po unë nuk e them me zë, kam turp, po vetëm gënjej, se ndryshe do t'ia kisha hequr vetes. Ti e pe si filloi zbrazja e iluzioneve, erdha me dy valixhe me libra e dorëshkrime, librat i dhurova, dorëshkrimet i dogja. Pse? Mua më kishin lënë të gjitha: e para letërsia, madje habitesha si kisha shkruar disa libra me poezi dhe prozë.

ALTEREGO – Ti ishe i harruar dhe u harrove sërish. Zure një punë të rëndomtë që të siguroje ca para për qiranë, taksat dhe ushqimin dhe gëzimi yt më i madh ishte kur muaji mbyllej mirë. Dhe kjo do të vazhdonte gjersa ti të mendoje për t'u kthyer, po të vinte turp të kthehesh, se kishe gënjyer.

EGO - Po ç'të bëja? Erdha me shumë dëshirë, pa e kuptuar se thjesht iu kisha besuar iluzioneve. Ishte një përplasje e egër me realitetin. Kisha fituar dekorin e Nju Jorkut, po s'më kishte hapur derën njeri për të hyrë brenda. Mbeta jashtë duke gënjyer se isha brenda.

ALTEREGO – Dhe s'hoqe dorë nga iluzionet. Kjo vinte nga pafuqia jote. Ti, gjithmonë prej paaftësisë ke pritur të ndodhte ndonjë mrekulli. E mohon?

EGO - Jo. Jam një provues i krisur. Dua të jem i sinqertë me ty. Me pasaportë jam amerikan, po s'ndjehem i tillë, sepse jam mbyllur, nuk jam shfaqur. Të bësh një kërcim të tillë kaq të hareshëm, me një ëndërr të çmendur se pikërisht në Nju Jork do të ndodhë ajo që të është pëshpëritur në ekstazë prej një fuqie të panjohur. Duro! Përpara e ke! Po çfarë kam? Heshtje! Kur i kisha humbur shpresat, plotësisht i dështuar, i harruar, i harruar, tmerrësisht i harruar, një telefonatë në mëngjes herët, një zë i ngrohtë gruaje; të kam gjetur një punë, mos e refuzo! Dhe unë, pa u menduar, si Shvejku: Pranoj, zonjë! Faleminderit!

ALTEREGO – Sërish fitoi iluzioni tek ty, sepse ti këmbëngulshëm nuk u përpoqe ta gjeje fatin me punë, po prite të vinte ai tek ty dhe të ndodhte ajo mrekullia që veç mrekulli nuk është!

EGO - Një tryezë e madhe, një kompjuter ku shkrova gati tremijë poezi, pesëmbëdhjetë romane, qindra ese, tregime. Më dukej vetja si në një bibliotekë. Kush ishte ajo grua që ma gjeti atë punë?

ALTEREGO – Dhe gënjeve veten. Po me entuziazëm. Nuk rroje në Nju Jork, s'merrje metronë, nuk banoje në një shtëpi me qira, nuk shikoje varfërinë që të rrethonte, po e kishe mendjen tek ato që shkruaje me aq frymëzim, pa e çarë kryet për të përmirësuar jetesën, për ta lënë atë punë, të ngjiteshe lart më në fund, të mos e ndieje veten thjesht një spektator lozhe i dekorit të Nju Jorkut! Nuk i hyre brenda, as që të interesonte sepse ti ishe dështaku i jetës dhe i suksesshmi i iluzionit. E ç'fitove?

EGO - Librat!

ALTEREGO - Sa lexues ke?

EGO - Ndoshta asnjë! Mbase jam lexuesi i tyre i vetëm.

ALTEREGO - Kush ishte ajo grua? E njohe më në fund?

EGO - Jo!

ALTEREGO - Poezia. Dhe të mori më qafë!

EGO - Vërtet?! Më pëlqen ta besoj.

ALTEREGO - Unë prisja tjetër gjë. Që ti të hiqje dorë nga iluzioni përfundimisht, t'i lije librat që s'të dhanë asgjë dhe të përplaseshe me jetën, të bëje prokopi. Por ti ke lindur nën njën një yll aventurier. Edhe tani që flas ti ke ndërmend të shkruash, romanin e ri. Të paktën të bëje një pauzë, të vije kryet mbi dy pëllëmbët e duarve e të bije në mendime si *Mendimtari i Rodenit*. Diçka më e mirë do të dilte, padyshim, por ti nuk vë mend dhe prej *Mendimtarit të Rodenit*.Ka mbetur fama, por jo mësimi i tij. Je i pandreqshëm!

EGO - Ke të drejtë. Ti thua të vërteta me fytyrë nga jeta, unë them të vërteta me fytyrë nga iluzioni. Sa të trishtë e ke ti, sa të gëzuar e kam unë! Sepse ia arrita edhe pse ti më quan një dështak të suksesshëm me atë ironinë tënde morbide. A nuk është një festë e paharruar që një botues të tregojë për mua një gjest të lartë kalorësiak: të ma botojë në katërmbëdhjetë libra poezitë e Amerikës? Ti më thoshe të bëja të kundërtën e asaj që më thoshte poezia. Dhe ta dish, poezia është më e fortë se jeta, natyrisht dhe më e fortë se vdekja. Dhe në qofsha i dështuar, prapëseprapë jam i lumtur që shkruaj poezi. Si u shkruan ato? Si u botua një pjesë e tyre? Nëpër portale, gazeta elektronike. Pikërisht aty i ranë në sy mikut tim Xhevair Lleshi, shkrimtarit dhe botuesit të njohur, që më nxiti t'i botoj në katërmbëdhjetë libra. Nuk kisha para, se unë nuk luftova për jetën që të bëhesha i pasur, po ishte dashamirësia dhe ndihma e tij që ky projekt kaq ambicioz u realizua. Po tani?

ALTEREGO - Asgjë. Po ajo heshtje do të ndjekë se asnjëherë s'më dëgjove, nuk iu binde të vërtetës. Nuk të mbështes në këtë përpjekje të fundit (se ti je plak) për të bërë njëfarë emri. Ti do të thuash se nuk e bën për emër. Po të gjithë e duan famën.

EGO - Ti s'më ke kuptuar kurrë. Vetëm më ke tallur. Pa e kuptuar se ajo që duhet të ndodhë, pra kjo sakrificë për poezinë, edhe të mos doja, do të ndodhte.

ALTEREGO - Jo, ti e ke ndjellë. E ke lutur, je përgjëruar për të, pa fare krenari, pa fare finesë. Sikur e ke detyruar që të vijë. Dhe ajo për mëshirë ka ardhur.

EGO - Jo. Këtu gabon. Vinte poezia kur kisha ndjesinë e poshtërimit dhe përuljes për të më dhënë kurajë dhe vetëbesim. Dhe dalëngadalë, i marrosur pas saj, nuk e di sesi një ditë rashë në gjunjë dhe i hapa kutinë duke i treguar unazën: i propozova për martesë! Jo, tha, jo dhe jo! E ndoqa nëpër strite dhe avenju nga njëri cep i Nju Jorkut te tjetri, gjersa i humba shpresat. Por ajo erdhi vetë me atë parfumin trullosës prej një femre të lirë që shkon me kë t'i teket. Dhe s'më braktisi në orët më të këqija, në metro, në autobusë, në parqe, nëpër kate gratacielësh, në orët e *Times Square*, kur unë kisha punën, në orët më madhështore përplot lumturi për të tjerët dhe shumë vetmi dhe mërzi për mua, gjersa një ditë e bëra timen përfundimisht. Në Amerikë u bëra poet. Nuk e di si ndodhi kjo. Shkrova aq shumë poezi në çastet kur sirenat e Uliksit ma bënin me dorë dhe unë krejt naiv dhe i pambrojtur, si një ballkanas aventurier, në vend që të mposhtja tundimin e madh, shkoja drejt tyre, sepse kisha poezinë, i besoja asaj, i dashuruar marrëzisht pas saj, i çmendur pothuajse. Dhe nuk e prisja që një ditë poezitë do të dilnin në dritë, në disa vëllime, sepse më fort i kisha shkruar në errësirën para agimit kur nisesha në punë dhe në errësirën e natës kur kthehesha në shtëpi. Pra këto janë poezi të errësirës së Amerikës, kur lindin më fort shpikjet dhe Apoloni zbret në *Times Square* dhe merr poshtë në metro që të popullojë vetminë e poetëve. Kështu paskësh qenë e thënë, që unë 70 vjeçari të kisha në shpirt njëzetvjeçarin e përjetshëm...

Do të më lërë një ditë? Bashkë me vdekjen, sigurisht.

ALTEREGO - Po e përsëris, ti je një dështak plak!

EGO - Fuck You!

GJASHTË POEZI

KËTU S'MË NJEH NJERI

Libri 1 f.43

këtu s'më njeh njeri
dhe ketrat që i shoh përditë
kanë frikë prej meje
dhe zogjtë kur kaloj e ndryshojnë këngën
dhe ujërat e pellgut te parku marrin një ngjyrë mavi prej brenge
diku dëgjohet boria e makinës si qyqe
dhe treni trokon mbi çati gjëmshëm
si luftë botërore e papritur
qukapiku ende s'e ka hapur vrimën
dhe krimbi manjolën po ha
tjetër ndriçim ka agimi
mbi thinjat e mia të rralla
këtë ma tregojnë pasqyrat
e ujërave ku lahen makinat
diçka po ndodh kur eci
dhe gratë se si më shohin
janë gati të më japin ndihmë
dhe vajzat tregohen të sjellshme
po shkon? sa keq që na vjen
po shkon përgjithmonë? ç'të bësh
një ditë të gjithë do të ikim
por ja, që kurrë s'e mendojmë!
dhe unë që e fsheh ku po shkoj
kam dashuri dhe për plehrat
një trashaluqe që s'shihet me sy
merr prej meje një shenjëz
dhe çehrja e saj vrarëlije
çelet si lulja mbi pleh
jam gati t'i jap dashuri dhe nje vrasësi
dhe çastet e mërzisë më të thellë
më duken më të shtrenjtë se balzaku
dhe shkoj të shoh si del hëna
nga fundi i oqeanit
e plotë e kuqe e mistershme
mbi ujërat si vaginë e përgjakur
prej saj të lindja dhe unë!
dhe shoh si kalon gjersa vjen agu
natyra e ka në dorë, ave maria
ndoshta nuk bie
më le të dëgjoj ende bethovenin dhe bahun.

NËNA PO GATUAN BUKË

Libri 1, f.42

nëna po gatuan bukë
kryqin bën
dhe pëshpërit lutje
moj, nënë, kush të shikon na heq fillin
nuk gatuhet bukë në amerikë!
landush, ti vëri mendt punës
pa nëna bën gati brumin
dhe mblatën shtyp përsipër
me shenjën e zotit krisht
e bëj për shëndetin tënd
plastë syri i lig
dhe të marrshin të keqen!
kjo bukë të bëri poet!

LOTËT E GRAVE

Libri 1, f. 30

gratë mbajnë çelësa argjendi në dorë
janë çelësa loti
ato janë të padukshëm, po
unë i shoh si feksin e vezullojnë
një të tillë mban dhe gruaja ime e vogël
është tretur
është mbledhur sa një grusht
çelësin shtrëngon fort në gishtërinj
që nga mëngjesi i akullt i nju jorkut
gjer në natën e gjatë pa gjumë
po se përdor, s'hap e s'mbyll asgjë
se ai çelës s'hap dyer
dyer s'mbyll, se nuk di të gjitha gratë e fashion,
të mollëve mondan të nju jorkut
blumingdell, safora, mejsi
tërë ditën qëndrojnë në këmbë



si qirinjtë e katedraleve të vjetra, ende të pa ndezur në shandan
orë pa fund qëndrojnë në këmbë
duke u buzëqeshur blerësve me një thank you të ëmbël
njëmilion thank you në ditë
një milion thank you më në fund vjen nata
nata, po më e errët dhe më e dendur plot melankoli dhe marramendje është nata e metrosë
të gjorat gra e gjora gruaja ime e vogël
i dhembin këmbët shputat i ziejnë
variçet i çajnë si thikë
në pulpa e në kofshë damarët e ënjtur
ngjiten e zbresin si zhivë
plot gra borgjeze janë zbukuruar prej saj në fashion
veshur e mbathur me firmato,
rrotulluar para pasqyrës, e, si te dukem?
ndërsa ajo ka shtyrë karrot, ka ngarkuar e shkarkuar
pa e harruar atë thank you, very good
thank you, very good
një milion herë thank you, very good!
gruaja ime e vogël
e ka mbajtur të qarën me dorën e shtrënguar në gojë
ne sytë e buhavitur e ka mbajtur dorën
ka pasur turp të qajë në metro
në sy të njerëzve i ka ardhur zor
sa hyn në shtëpi kërcet çelësi
çelësi i lotit në qepallë
dhe shpërthen një krua e vogël, një lumë, një oqean
mbushet shtëpia, hëna, nju jorku
prandaj shkëlqen turbullt nju jorku natën
nga lotët e grave

STACIONET JANË PREJ XHINSESH

Libri 3, f. 20

vjen dita
stacionet janë prej xhinsesh
këpucësh najk
kafesh të gjata amerikane

vjen nata
stacionet janë prej puthjesh
me një aureolë përsipër
si në ikonat e lashta
qëndroj aty për disa minuta
pres një vajzë të bukur
po ajo më vjen nga kujtimet
nëpër dritat e reklamave

stacionet si puthje
me një aureolë përsipër
si në ikonat e onufrit
ajo më vjen nga kujtimet
me takat e larta
fundin e shkurtër
ishin vitet gjashtëdhjetë
kur vajzat imitonin sofia loren

2

nata vjen për të shuar gjithçka
në nju jorkun e pagjumë
në grataçiela nuk fiken dritat kurrë
reklamat si zjarre që s'shuhen
vë duart mbi to
t'i ngroh
vë buzët
m'i puth rita ora
bebe rexha
dua lipa m'i puth
më mbushen duart me të kuq buzësh
si me flamuj
janë motrat e mia të mrekullueshme

në nju jorkun e pagjumë
gjërave mund t'iu shohësh vetëm pjesën
të tërën e ka marrë nata
në qytetin e bilionerëve
që janë mësuar si nata të marrin gjithçk
eci
në qytetin e boshatisur nga ëndrrat.
këtu
njerëzit lindin zgjuar
dhe zgjuar vdesin
nuk di si rrojnë pa fjetur njujorkezët
zotin prej ajri
e kanë kthyer në zot teknologjik
in god we trust
ky varg nga bibla
në dollar.

mos shikoni lart
po kthejini sytë poshtë
te bankat, kuletat
zoti është bërë para.

in god we trust.

eci
në qytetin e boshatisur nga ëndrrat.

E ZBEHTË ISHE MBRËMË

Libri 1, f. 30

e zbehtë ishe mbrëmë
po e kaluam me një heshtje prej mbrëmjeje
i zbehtë isha unë
po shkoi ashtu si lumi nën urë
s'tregojmë më asgjë për vete
ç'kishim e dhamë për fëmijët që u rritën
dy qenie pa brendësi
dy boshësi që plotësojnë dy plotësi
tani s'kemi ç'japim më
e zbehtë ishe mbrëmë
po e kaluam me një heshtje prej mbrëmjeje
i zbehtë isha unë
po shkoi ashtu si lumi nën urë
kur të vijë vdekja kemi vdekur qëkur

MUNGOJNË GISHTËRINJTË E TU

Libri 1, f. 161

e dashur, këtij qielli në manhattan
i mungojnë gishtërinjtë e tu
s'ka qenë asnjëherë kaq i pastër dhe blu
më shkruaj një letër me qiell
si në kohët klasike
palose qiellin
vëri buzët për ta puthur
si një lindje dielli
pastaj hidhe në postat ajrore të grataçielave
dhe nise për tek unë

E pres
po ende s'ka mbërritur
marr grataçielat me radhë
të gjej letrën tënde
ç›idiot që jam!
i njëjti qiell i pastër dhe blu
mungojnë gishtërinjtë e tu

MOTIVI ROMANTIK I MALIT

Premisë për interpretimin e prometeikes në letërsinë shqipe

Nga Skënder KARRIQI

1- Imazhi epror i heroit lirik

Studiuesja franceze Èlise Radix bën fjalë për një frymë të përgjithshme në fillim të shekullit XIX, të cilën ajo e cilëson si *prometeiane* dhe që zbulohet përmes një serie imazhesh romantike me vlera simbolike e, mbi të gjitha, përmes një shfaqjeje të përsëritshme, edhe pse ashtu e maskuar, të profilit të Titanit[1]. Çelësi për të kuptuar këtë seri imazhesh është vizioni i shkëmbit, i shenjuar fillimisht si shkëmbi (mali) i Kaukazit, përndryshe vendi i dënimit, i refuzimit kokëfortë, i revoltës, i izolimit, i dhimbjes dhe i soditjes tragjike. Në këtë kuptim ky vizion do të jetë shenjë tipologjike përsa i përket formës dhe përmbajtjes së produktit letrar romantik. Kështu, përgjatë përvojës krijuese romantike këtë vizion do ta gjejmë në imazhet e malit, majës, çukës, kreshtës, kodrës, bregu etj, si të prejardhura nga imazhi i një shkëmbi romantik (Kaukazi). Jo në pak raste këtë vizion shenjues tipologjik do ta gjejmë edhe të nënkuptuar qartësisht nëpërmjet kuptimeve ndajfoljore vendore (poshtë, lart, tutje, përtej, tej etj)

Vizioni i Titanit të gozhduar apo të lidhur në shkëmbin apo malin e tij, ishte i tillë që mund të korrenspondonte me shumë ide të vyera për romantikët. Por ajo çka është e rëndësishme ka të bëjë me faktin se ky vizion ngrihet në nivelin e një motivi thelbësisht romantik, që ka si përmbajtje ndjesinë e të qënit *mbi* masën (lart, sipër saj, mbi majë). Kjo është një ndjesi epërsie që, padyshim, lidhet me modelin olimpik-hyjnor, sipas të cilit epërsia intelektuale dhe morale përputhet apo është e lidhur, në kuptimin e të shprehurit, me të qënit *lart, mbi* mal (shkëmb,majë, çukë kodër, breg etj). Në këtë kuptim mund të bëhet fjalë për olimpizëm në letërsinë dhe veçanërisht poezinë romantike, produkt i të cilit është *poezia e majës* dhe më gjerë, poetika e kësaj poezie, në themel të së cilës është imazhi epror i heroit lirik. Ky ishte momenti i shkëputjes nga tradita epike e legjitimimit të ligjërimit letrar nëpërmjet Muzave. Edhe në i pafshim praktika të tilla, ato janë thjesht elemente të formave të retotikës poetike klasike në nivele rudimentare, pasi vendin e tyre në poetikën romantike e ze heroi lirik gjithmonë *mbi* malin, (majën, shkëmbin, kepin, kreshtën, bregun) romantik. Largimi prej këtyre formave klasike të tipit *Këndo hyjneshë mërin e Akil Pelidit...,* apo minimizimi rudimentar i tyre, ishte një tregues i rëndësishëm formal dhe konceptual i veçorive të romantizmit si metoda që do t'i hapte rrugë afirmimit të unit poetik romantik, i cili nëpërmjet udhëtimit dhe kënvështrimit epror, do të legjitimojë ligjërimin e vet poetik.

2-Olimpi i zotave, Kaukazi i poetëve

Arketipi i këtij këndvështrimi të ri për romantikët është titani Promete, i lidhur dhe i braktisur në malin shkëmb të Kaukazit. Tek ai romantikët do të gjejnë sivëllain e tyre, duke iu referuar mitit të tij si shprehje e titanizmit dhe prometeizmit të tyre. Në përvojat e para, pikërisht shkëmbi-mal paraqitet si një vend i rrezikshëm, ku rrebeli (Prometeu) vuan dënimin, por edhe një vend i panjohur dhe për këtë arsye edhe ekzotik.

Në traditën mitologjike shkelësit e rendit hyjnor apo përbetuesit gremiseshin në Tartar. Kështu ka ndodhur me shokët e Prometeut (*Titanomanika),* kështu ka ndoshur me gjigandët (*Gjigandomanika*), kështu ka ndodhur me Atlantin e po kështu ka ndodhur me Tantalin e Titiun. Ndërsa me Prometeun ndodh ndryshe: ai gozhdohet apo lidhet me zinxhirë në shkëmbin - mal të Kaukazit. Zeusi (Jupitri) me këtë dënim krijoi një Olimp tjetër ,(përndryshe Kaukazin) me heroin olimpik (përndryshe kaukazian), Prometeun, të cilit do t'i referoheshin të gjithë ata që, në emër të njerëzimit, do të kërkonin një altrrnativë tjetër, filozofia e së cilës do të ishte humanizmi. Ky është një gabim fatal i Zeusit, por që duhet të klasifikohet në ato gabimet që do të ndodhnin domosdoshmërisht. Olimpi ishte i zotave, Kaukazi apo shkëmbi-mal (romantik) do të ishte i njerëzve dhe parasëgjithash i atyre njerëzve të veçantë, *poetëve*, të cilët në rrugën e afirmimit të tyre (nëpërmjet njërit prej më të denjëve, gjeniut Gëte) arritën deri në konceptimin e *poetit krijues* me të njëjtat atribute si të Zotit. Jo mohimi, por përballja, kundërqëndrimi, të maturit me Zotin, ishte fitorja e çmueshme, metafizike, me produktin e vet, frymën humaniste.

Imazhe të tilla romantike (në male, shkëmbinj, kodra, brigje, kreshta etj) të cilat do të legjitimojnë panoramimin dhe ligjërimin poetik romantik dhe që lidhen pikësëpari me nevojën e shprehjes së unit poetik romantik, do të gjenden tek poetët evropianë. Këto imazhe, duke qenë referenca në praktikat e këmbimeve kulturore-letrare të shek XIX, domosdoshmërisht do të reflektojnë, drejtpërdrejt apo tërthorazi, në kultura të tjera.

3- Mishërime poetike evropiane

Mishërimin poetik të kësaj tradite Èlise Radix e ve re që në poemat e para të Lamarttine-it, tek vëllimi *Meditime poetike* ku *ky motiv duket në lidhje* ***me një tingull religjoz*** *që* ***shpërndahet në pamje të peizazhit*** *dhe ku vjen të strehohet ai që nuk shikon gjë të përbashkët ndërmjet tokës dhe tij*).[2] Më pas në këtë udhë do të shfaqet më qartësisht Alfred de Vigny me poemën *Moisiu.*

Nga Nebua shterpë duke ngjitur malin
Moisiu, njeriu i Zotit, ndalet dhe pa krenari
Mbi një horizont të gjerë hedh një vështrim të gjatë.[3]

Në këto vargje vihet re se *mali është konceptuar si një vend i ngritjes në sensin gjeometrik* ***të lëvizjes ngjitëse ... ngrihet në një rang superior eminent***[4]. Simbolikisht mali pra, e ngren në një pozicion të volitshëm atë që e ngjit, (në rastin konkret Moisiun) dhe i lejon të hyjë në kontakt me Zotin. Është pikërisht kjo ngjitje e vetmuar e heroit biblik të kthyer në një hero romantik që e shkëput atë nga njerëzit e tjerë, duke e vendosur mbi ta. Falë pozicionit *të ngritur, të lartë, mbi*, ky vend (mali, shkëmbi, kodra, bregu, etj) bëhet burim i epërsisë, në kuptimin që me të lidhet forca, aftësia e heroit, në kuptimin e gjerë të kësaj fjale. Që nga maja e lartë e malit (në rastin konkret të Moisiut në vargjet e Vigny-së), shikimi i tij përfshin universin, siç duket nga togfjalëshat poetikë ***horizont i gjerë*** dhe ***vështrim i gjatë***. Deri pak më parë Mojsiu është kokulur, jo krenar. Fill pas dominimit në lartësi ai karakterizohet në qëndrimin e tij nga një dukje prometeike, sikurse mund ta shohim në vargjet :

Dhe në këmbë para Zotit Mojsiu duke zënë vend
Në mjegullën e errët fliste ballë për ballë.

Pozicioni në këmbë i Moisiut, në mos hakmarrës, të paktën është kurajoz për të kontestuar gjendjen njerëzore, për të arritur në shfaqjen më të plotë të asaj që ne e quajtëm dukje prometeike, e cila kulmon në qëndrimin *ballë për ballë*, qëndrim të cilin Èlise Radix e komenton të tillë, që sjell situatë lufte apo barazie ndërmjet kundërshtarëve. Ky motiv i shkëmbit- mal i ka mundësuar heroit biblik të shndërruar në hero romantik, takimin me Zotin, pra i ka lejuar të pamundurën. Pikërisht ky hero, i ardhur prej fundeve drejt majës, vendoset në pozicionin e forces, duke e ndjerë veten moralisht të denjë për të kërkuar nga Zoti shpjegime për egzistencën e vet. Në të njëjtën kohë kjo ngjitje e heroit tonë është edhe ndarje, është edhe veçim, është vetmi dhe ekzil i heroit të zhgënjyer, dyshues, i cili për këtë arsye, tenton qiellin për të marrë përgjigje rreth pyetjeve të tij ekzistenciale. Padyshim që ky do të jetë një hap i rëndësishësishëm i qëllimit prometeik për të sfiduar Zotin (Zeusin, Jupiterin), që rrinte mbi Olimp. Në këtë kuptim mali (shkëmbi, kodra, bregu apo kreshta) bëhet streha e privilegjuar e heroit romantik (përkatësisht poetit) dhe më gjerë, njeriut në vështirësi për të jetuar. Pikërisht me këtë vend dominues (i lartë, mbi) lidhet shprehja e unit romantik si kundërvenie ndaj Zotit, e nuancuar në variante të shumta letrare, e për më tepër, që nga ky vend do të shohim projektimin e deri shprehjen e elegjisë dhe lirizmit romantik. Lidhur me një asosacion të tillë të malit (shkëmbit, kodrës, bregut, kreshtës) romantik(e) do shpjegohet magjia rusoiane të natyrtës .

Interesantnt në këndvështrimin tonë është edhe Senancour[5] me veprën *Oberman,* në të cilën personazhi me të njëjtin emër gjen veten mbi malet, mbi majat paqësore, atje ku *mendimi nuk është i ndruajtur, përkundrazi, është më aktiv*[6]. Senancour e paraqet personazhin e vet fill pas mbrritjes në një majë të vendosur simbolikisht dhe poetikisht sipër një deti resh. Në këtë vend dominant Oberman ka ndjesinë e një ëndrre kozmike, i ndodhur në një botë hapësinore, por edhe në kontakt me botën poshtë, tokën e njerëzve: është pikërisht maja që i ruan lidhjet me të. Ky stacion hapësinor i Oberman-it është një gjetje intuitive e traditës mitike. Si argument të ndjesive të tij romantike heroi në fjalë i majave rrëfen anekdotën në lidhje me Rousseau-in si më poshtë: Disa njerëz një ditë mirëpritën në një majë mali ku mblidhnin bimë, filozofin e shquar. Ata ishin të bindur se ai, si dashamirës i shpallur i natyrës, do t'u mbante një ligjëratë elokuente. Por filozofi ulet në tokë, luan me një fije bari dhe me vështrim të tretur në hapësirë, nuk flet asnjë fjalë. Ndërkaq njerëzit e kuptuan se ai e kishte thënë ligjëratën e tij të heshtur.

Mali (shkëmbi, kodra, bregu apo kreshta), për autorë të tjerë do të jetë vendi i mërgimit, i vuajtjeve dhe i dënimit politik të heroit. Një kuptim të tillë psh e gjejmë tek Hygoi, i cili e kishte provuar mbi supet e veta mërgimin politik. Si i tillë ai e përfytyron veten në shkëmbin e Guernesey-it. Këtij ishulli ai i dedikon romanin *Punëtorët e detit*, ku evokon këtë *shkëmb të mikpritjes* dhe të *lirisë*[7]. Ndërsa në një nga veprat e rinisë së tij dhe pikërisht *Shpella e Islandës*, me anë të një subjekti të paraqitur në vetën e tretë, autori transmeton dhimbjen nëpërmjet personazhit Shumaker. Në këtë vepër dominon imazhi i heroit, ulur në një shkëmb të rrahur vazhdimisht nga dallgët në mes të detit, tek sa vuan mungesën e vajzës së tij, zëri i së cilës i vjen i ëmbël nga larg. Për më tepër, akoma me më shumë dhimbje, heroi vuan mosmirënjohjen e njerëzve për të cilët sakrifikoi. Megjithatë ky vend dënimi dhe izolimi politik, jo vetëm që nuk e ngushton, por e zgjeron hapësirën e heroit, i cili rritet virtualisht mbi këtë shkëmb dominues, deri në përmasat e njerëzve të mëdhenj, që pranojnë fatin e tyre tragjik në këmbim të shërbimit ndaj njerëzve.

4- Sublimimi

Nga lartësia ku ndodhet poeti, poetikisht bëhet gur, bëhet mal. Nëpërmjet këtij asosacioni (mal-poet, shkëmb-poet etj), që në shkallën më të lartë përjetohet si një imazh simbolik, mund të hidhet dritë edhe mbi ndjesinë e sublimimit të heroit lirik romantik. Me përmbajtjen e kësaj ndjesie lidhet kuptimi i parë latin i fjalës *sublime*, që do të thotë *lëvizje ngritëse*. Është sublim ai që ngrihet *sipër të tjerëve, sipër meje*. Akoma më i rëndësishëm është kuptimi i sublimes si një tranzicion deri në cakun e ruajtjes së ekuilibrave dhe shumë-shumë, deri tek një destabilizim i përkohshëm. Gjithçka përtej këtyre kufijve do të ishte tejkalim i masës, i shenjuar si i dëmshëm ky në të gjitha qytetërimet antike.

Ky kuptim i sublimes na ndihmon të bëjmë diferencën. Gëte, siç kemi përmendur nga ç'na thotë vetë ai, hoqi dorë nga Prometeu se nuk i pëlqente fryma qiellpërmbysëse e Titanit. Në rastin romantik heroi lirik (përndryshe poeti apo personazhi paralel i tij), merr një pozicion ilegal, si një Promete, që me zjarrin e tij ve në diskutim rregullin dhe botën. Pra në rastin

1 Élise Radix. *L'Homme- Prométhée vainqueur au XIX-e siècle*. L'Harmattan, Paris, 2006, fq 22.

2 Èlise Radix, vepër e cituar, fq 23, ku citohet Lamartine, *Méditations poétiques* , (Vepra poetike e plotë), *"Biblothéque de la pléiade"*, Gallimard, Paris, 1963.

3 Po aty, ku citohet Alfred de Vigny, *Poema antike dhe moderne*, (Vepra e plotë), Gallimard, Paris, 1986

4 Po aty

5 Èlise Radix, Vepër e cituar, fq 25, ku citohet Senancour, *Oberman*, Paris, 1984.

6 Po aty

7 Po aty, fq 26.

romantik s'kemi thjesht sublimim por një të tillë të shoqëruar nga revolta dhe dëshira për ta ndryshuar gjendjen. Ky personazh i sublimuar dhe i revoltuar njëkohësisht, qoftë dhe një kundërvënës i butë, me ndriçimin e tij që nga lart vështron armiqtë e tij, ndërkohë që here-herë në pozicione soditëse, mediton thellë në kuptime të ndryshme, por gjithsesi për fatin e njerëzve, apo përshkruhet në raport me ta. Është pikërisht kjo lartësi sublime, që e zbut dhe e shndërron revoltën e tij deri në *urtësi* dhe *maturi*.

***

Èlise Radix duke konkluduar për motivin e malit shprehet: Është një fenomen i vërtetë letrar që *ky motiv i shkëmbit kthehet në majë, në një pike kulminante nga ku mund të pushtohet Universi*[8]. Ky përcaktim të ndriçon që shprehjen romantike ta shohësh të lidhur me një përmasë prometeike, e cila përpara se të ketë shprehjen e vet përmbajtësore, ka shprehjen e vet formale funksionale. E në këtë kuptim strukturat poetike dominohen nga kompozime, ku ndërthuren imazhe të lartësisë dhe hapësirës, që në lidhje me heroin, përbëjnë kushtin e: *a)* përftimit të informacionit, *b)* të veçimit si moment i formimit dhe shprehjes së individualitetit, *c)* të meditimit si akt i prodhimit të ideve ndriçuese për të tjerët, për njerëzimin. Një këndvështrim i tillë padyshim, merr vlerë metodike në kërkim të argumenteve formale dhe përmbajtsore të prometeikes në letërsinë shqipe, si një veçori që e karakrerizon atë në të gjitha periudhat historike të zhvillimit të saj, por që si kulmim ka periudhën e Rilindjes Kombëtare.

8 Po aty, fq 28

NEOREALIZMI I NJË POETI MODERN

-Rreth librit "Britmat e muzgut modern" të poetit Marash Mirashi-

Nga Emrije Krosi

Poezia është manushaqja që e kanë mbytur ferrat dhe Qielli i saj në Shqipërinë e këtyre dekadave, ka vetëm pak dritë të mugët, pasi Univesri i librit nuk është më *superiorja* por thjesh një frymëzim fatal, që të *gjithë ngadhnjimtarët* për të qenë poetë, janë *çlirues të zellit të frymëzimit* në emër të shpirtit të lirë. Shumë poetë shqiptarë si ***Migjeni***, apo ***Ali Asllani***, e kanë "skalitur" *britmën* dhe *çmerimën* e madhe *shoqërore* dhe *kombëtare*, për padrejtësinë *sociale* dhe *njerëzore*, nëpërmjet vargjeve të tyre, një realitet *britmues ndaj së keqes*, sepse poetët vetëm *identifikojnë problemet* por nuk kanë fuqi ti zgjidhin ato. E keqja e shoqërisë shqiptare e ulur këmbëkryq në këto tridhjetë vite , ashtu si magjia e shkrimeve migjeniane, ajo që mbijeton ndër vite dhe mote, është edhe gjendja aktuale e njeriut sot, e cila mjerisht përmban tipare të *shumta ekspresioniste*, (Vinca:2002), që përpuqen në realitetin e trishtë të një tranzicioni të gjatë, ku elementet poetike, *metaforat e forta, simbolet* dhe *krahasimi*, japin pamje të shumta *surrealiste* me tipare të *ekspresionizmit* dhe *ekszistencializmit*, se në kontekstin e një *letërsie sociale*, (Rugova: 1996), pezia e Mirashit rrok jo vetëm realitetin, por "operon" deri në skutat më të thella të shpirtit shqiptar, me dhimbje pafund të shkatërrimit të shoqërisë dhe familje në emër të demo(n)kracisë.

***

Poeti ***Marash Mirashi,*** duke qenë një *gazetar shëtitës*, për vite me radhë në të vetmin ekran publik të shqiptarëve TVSH-së, njeh çdo skutë të vendit tonë, por edhe *mentalitetin e shoqërisë tonë*, ndaj edhe libri "*Britma e muzgut modern*" (Mirashi: 2021) derdh *neorrealizmin* e poetit, duke e ndarë librin në katër pjesë:

statujat nuk ëndërrojnë ndryshimin e motit, (me 14 poezi)
këmbana fatesh të trishta, (14 poezi)
lumenjtë kanë mbetur vetëm, (11 poezi)
refrenet e vitit të çmendur 1997, (10 poezi).

Libri hapet me poezinë "***Burri i ditur i qytetit***", ku pas një *përshkrimi* të *qytetit të çmendur*, me lloj-lloj shtresash sociale, dhe gjithëfarëlloji *vesesh* dhe *huqesh*, duke *epitetuar* në *formë enumeracioni*, *metaforash* (Fogelin: 1988) nëpërmjet vargjeve: *silueta hyjnoer sa vjen e shuhet/**rrugëve mes njerzve, në thellësi**/burri i ditur i këtij qyteti/**është i dënuar /me vetmi***, f.10, që në fillesë *ironia* e poetit është shtrirë horizontalisht dhe vertikalisht, një ndërthurje mes *njëmendësisë* dhe *socioreales*, gjatë rrugëtimit të tij poetik. Në poezinë: "***Refreni fatal***", vargjet: ***përditë dëgjoj si përpëlitet,/shpirti i mbytur i shoqërisë/ në një filxhan kafeje/ mbi tavolinë***, f. 15 poeti ecën mbi *plojën e ironisë*, (Jankélevitch: 1999), se një shoqëri që *vetëm vegjeton si një amfib*, që zvarritet, që mënjanohet, që ironizon, që fshihet, që hesht, që fle, që luan *melodramën e fatit të tij kolektiv*, kurrë nuk do të ketë *qytetërim* dhe *përparim*. Poezitë: "***Lavazh i trurit", "Ibrahimi", "Jetë nate në metropol", "Adoleshentët", "Në Roling Hills nuk ka aristokratë***", tematika socile është e mprestë, sa vetë *satira* ku *ironia kërkon një farë vëmendje*, (Parker: 2011), poeti në mënyrë intensive përpiqet të "zbutë" lexuesin, duke e ndarë qenie e tij në tre: *unin tim*/ *të vërtetën/* (*britma ime),* se potretizimi i "maskës" reale shoqërore, vjen edhe nga vargu: ***në këtë qytet, shiu i imët/ njësoj lag statujat, si njerzit***/*.../Një* ***tingull këmbane nga Kisha e Shën Palit/vjen deri tek busti i Papa Vojtilës***/*.../të* ***mbytur në kafene,/thashetheme , marrëzi/në këtë qytet/me jetë monotone***/*nën shi*/ f.22, nga poezia: "***Statujat nuk ëndërrojnë ndryshimin e motit",*** kemi një përthyerje një përrrokje që na sjell *krahasimin* apo *pranëvënien* me tjetër poezi atë të *Bardhyl Londos*, (Krosi: 2021), (de)kodimi dhe (ç)mitizimi i qytetit, si dhe (de)kodimi i metaforës së shiut, ku *simbolika e ujit* ka po ashtu *katër aspekte ciklike të ujit* (*shiu, burimet, lumenjtë, deti e bora*), *si katër periudhat e jetës*, (*rinia, pjekuria, pleqëria* e *vdekja*) se shiu/uji është një dukuri natyrore që rilind jetën, por edhe si *pastrim moral* dhe *katarsis*, apo si *pagëzim* që për besimin e krishterë/ortodoks (simboliozn rilindje dhe pastrimin emocional) nga Gjon Pagëzori, por edhe në besim islam, në Suren Furkan, " *edhe Ai është, që i lëshon erërat myzhde në prag të mëshirës së Tij (shiut) dhe Ne lëshuam prej qiellit ujë të pastër*" (El Furkan: 1989), por vetë "shiu" simbolizon, trishtimin, ankthin, refuzimin, dëshpërimin, nëpërmjte vargut: ***në këtë qytet/me jetë monotone/nën shi/,*** duke tranferuar besimin në (mënyrë përmbysëse), si ndeshje *ironike metaforike*, (Hamon: 1996). Pamja e Shqipërisë, migjeniane, dyzohet edhe ndaj *depresionit kolektiv*, ku teknologjia, luksi, interneti, ka sjellë "skllavërim" njerzor *në fasoneri, në ndërtim, në minierë*, që nën *smogun e Tiranës, rendin, vigjëlojnë*, *mëtojnë*, *mëkatojnë*, *iluzionojnë*, *vrapojnë*, *emigrojnë*, kjo pamje *surreale*, mes *eksitencializmit* dhe *ekspresionizmit* nëpërmjet vargjeve: *kapanoni i ftohtë gumëzhin/* ***nga metali i makinerive modrene/që rrëzuan dhunshëm, pa mëshirë****/ kalanë ilire të mbretërisë tënde*, f. 45, nga; "***Skllavja e bisnesit fason***", duke na servirur këto tematika të forta sociale si:

tematikat dhe problematika,(varfëria, mjerimi, papunësia, prostitucioni, fataliteti, stresi etj.),

përshkrimi i personazheve, (adoleshentët, fëmijët e rrugës, vajzat dhe gratë e fasonerive,

studentët, intelektualët, moralisët, dhe (anti)patriarkalistët),

idetë poetike (kritika kundër sistemit social-shoqëror, politik dhe fetar)

vizionet mbresore rrëfyese (indiferenca individuale, politike dhe intelektuale nga njëra anë,

"plogështia" dhe frenimi shoqërore nga ana tjetër),

mjetet stilistikore shprehëse, (ironia, sarkazma, grotesku). Letërsia postmoderniste

shoqërohet me *tone ironike* dhe *tallëse*, shoqërohet shpesh edhe me *sarkazëm,* edhe si ironi e fjalës por edhe *ironi e situatës*, (Dado: 2020), është një teknikë rrëfimi (më shumë romanor) meqë e vë lexuesin para *qëndrimit emocional*, të trajtohen dukuri sociale dhe shoqërore, në mënyre ironike dhe satirike. Ironia shkon deri në *paradoksin postmodernist*, në formë edhe distance kritike me realitetin, se poezia është thjesht gjuhë e ngarkuar me kuptim deri në shkallën dhe *natyrën shenjore,* (Wilde: 1981), pa pretenduar se përgjigja specifike për lexuesit, mund të ketë "emocione" të lumtura apo trishtuese, pa arritur të kuptojmë *kuptimin parësor* të poezisë. Poezitë që shpalojnë "pamje mjerane migjeniane" vozitin nëpër faqet e librit, ashtu si poeti shëtitës në atdheut e tij të *çmendur* nga *grykësia*, të *përçudnuar* nga një demo(n)kraci të një *tranziconi të mbrapshtë* , ku edhe vetë ëdërrat janë të frikshme. Poezitë si: "***Nëna e dhembshur nga rrethina metropolitane", "Punëtori me mëditje i qytetit", "Makinisti i qytetit pa tren", "Pikturë vjeshte në fshatin pa njerëz", "Ullinjtë e kakomesë", "Tanku taksi", "Udhëtimi i gazetarëve në vitin '97"***, poeti nëpërmjet marrëzisë tonë kolektive, babëzisë për të "pushtuar" toka dhe prona, nëpërmjet ngushtimit të hapsirave tona, në emër të moderniteti *dekodon shenjat e metaforës së marrisë*;

<u>*metafora e marrëzisë së mjerimit*</u> ("***Në oborin e fëmijëve të varfër***", vargjet: *në oborr*

mbërritën njerëz me eskortë/ makina të shtrenjta, kamera, flokë me llak/qese me oriz, miell, makarona/ dhe kutërbimi parfumit nga pas, f.62),

<u>*metafora e marrëzisë së ikjes në emigracion,*</u> ("***Diçka e çuditshme po i ndodh diellit***",

vargjet: *ata po ikin/ me çanta mbi shpinë/plot tesha/që s'do të mjaftojnë/ për të fshirë lotët*, f.74.)

<u>*metafora e marrëzisë së zbrasjes së fshtatit*</u>, (zonat rurale), ("***Pikturë vjeshte në fshatin pa***

njerëz", vargjet: *ka mbërriur vjeshta në atdhe/një vjeshtë e gjatë/e tmerrshme/ku bien gjethet/njerëz dhe gjethe*, f.77),

<u>*metafora e marrësizë kolektive të vetvrasjeve*</u>, ("***Tanku taksi***" vargjet: *tanku më i çuditshëm*

në botë/tanku-taksi, f.96),

<u>*metafora e marrëzisë të vdekjeve danteske*</u>, ("***Nusja e re në autobuzin e Ferrit***", vargjet:

muaji i mjaltit/ishte mijëra kilometra larg/autobuzi ishte i vitit 1988/marrëzia e vitit 1997!, f.103). stili i *poezisë moderniste*, ka për qëllim që të bashkojë të gjithë copërat vizuale, në një njësi unike dhe origjinale, me dy pole të gjuhës; atë *metaforike* dhe atë *metonimike*, duke indentifikuar stilin individualist të poetit.

Si përfundim: poezia e gazetarit *Marash Mirashi*, është një poezi që ndërthur *realen* me *surrealen*, *ironinë* dhe *sarkazmën*, sepse vetë shoqëria shqiptare akoma rrok gjithë *marrëzinë tonë* tridhjetëvjeçare, ka mundur të luftojë, për lirinë dhe qenësinë e tij, si thelb i ekzistencializmit njerëzor, por që shoqërua jonë është sa *indiferente* aq edhe *naive*, *egoiste*, duke e quajtur *marrinë* dhe *thashethemin* si *modrenitet* dhe jo si *difekt* dhe *mungesë karakteri* dhe përgjegjësie shqërore. Një mesazh ky, që përçon poezia; *një popull që harron historinë , ka mundësi të përsëritë të njëjtat gabime në të ardhmen.*



BIBLIOGRAFIA.

Dado, Floresha: (2020), *Postmodrenizmi, poetikë e "antirregullit"*, "Kristalina -KH", Tiranë.
El – Furkan: (1989), Quran, përkth: Hfz.Sherif Ahmeti, Prishtinë.
Fogelin, Robert J: (1988), *Figuratively Speaking,* Neë Haven and London: Yale University Press.
Hamon, Philippe: (1996), *L'ironie littéraire: Essai sur les formes de l'écriture oblique*, Paris: Hachette.
Jankélevitch, Vladimir: (1999), *L'ironie,* Paris: Flammarion.
Krosi, Emrije: (20121), *Arratisja nga absurdi dhe depresioni shoqëror*, "ExLibris", Tiranë.
Mirash Marashi, (2021), *Britma e muzgut modern*, "Emal", Tiranë.
Parker, Fred: (2011), *The devil as muse : Blake, Byron, and the adversary*, Baylor, University Press
Rugova, Ibrahim, (1996), *Kahe dhe premisa...* " Eurorilindja", Tiranë.
Vinca, Agim, (2002), *Panteoni i ideve letrare*, "Camaj – Pipa", Shkodër.
Wilde, Alan, (1981), *Horizons of Assent: Modernism, Postmodernism, and the Ironic Imagination.* Baltimore: John Hopkins University Press.

DY POEZI NGA ARBEN NDRECA

Të mbrujtunit e bukës sate në një ditë korrikut

«Quando poi in un tratto vennero li
commissarij delli Turchi
cercando per la città vostra madre e li figliouli,
quella vostra madre fù subito nascosta...»
Historia della casa Musachia

I
... mandej more grunin
e verdhë të arave
të gjana të
qershorit të kaluem,
rritë mbas borës së
vlashkët të dimnit
të gjatë në diellin
e majit të kulluem
e të hanës së begatë

II

Miellit të bardhë
i lidhe unazën
si peng për bukën
që të mbruhet mirë
në gjoksin tand të vrullshëm
ku endje mendimet
e moteve në lëndinë.

III

I bane mysin
e ngadalë i fryve
prushit, pa çue hjellë
e në anë, mandej,
prite durueshëm që të piqej,
si modelja
fustanin Chanel.

IV

Në orën e drekës
bukën e avullt
ngushtove pranë
venës së kuqe në
bardhakun me lule
pranë llanit tand të majtë.

V

«Tanush! Muzakë!
(Eja! – e grishe – edhe ti o atë!)
Teodorë, të kërkon
jot' amë, se je e urtë.
Buka asht gati!»
[...]
Nën ftonin me hije të shkurtë.

Arben Ndreca ka lerë në Shkodër në vitin 1971. Studimet e mesme i ka kryer pranë shkollës artistike «Prenkë Jakova». Më tej, është diplomuar në Universitetin e Gjenovës, për gjuhë dhe letërsi të huaja (histori) për amerikanistikë dhe sllavistikë. Ka punuar si gazetar për disa vite për shtypin e huaj dhe atë shqiptar. Jep mësim gjuhë dhe letërsi angleze. Fatkeqësisht, mendon se letërsia është e lidhur me alpinizimin dhe detarinë.

Vorba e Eumeut

I

«As sot deti nuk solli shtegtarë
me anijet e drunjta që tash vijnë rrallë.
Valët e tij bijnë veç mbramjet,
muzgjet e buta, pak herë lajmet

për luftën e Trojës,
shtëllungat e tymit të flive zojës
Athinë, që mban anën e akejve
fitimtarë, të atyne që Hektorin morën zvarrë.

Nuk dij gja për Uliksin.
Deti, sot, veç tundi pak lisin
por fjalë për të nuk mbart
pa lejen e Poseidonit kokënaltë.»

Mendonte kështu bariu i derrave
dhe flakë i dha kërthijave në votër
kur dielli ra në perëndim
– si portokalli
në shportën e thurun –
me ofshamë e pikëllim.

«Ndoshta ka mbetë në fushë të Trojës
Uliksi i drejtë, i zgjuet, i gojës.
Drue ia asht thye shpata bronzit
ose parzmorja ia asht ça dysh
në shpinë të mazit si vetima.»

Iu largue sysh hija e mbretit
plakut që pranë zjarrit vështronte
vorbën ku ngrohej gjiza e ditës së re
–kërsiti në atë çast zjarri i ilnjes, motër
me lisin e Zeusit që nuk flet
e sheston ndër ré.

II

"Tashti mbrritëm, ndonëse pak vonë."
i foli Uliksi detarit të feakëve.
«Anija erdhi në bregun tonë!»
E mendja i rroku fytyrat e shokëve
që bashkë me të këtij bregu
Iu patën largue pa vàjë,
me shpresën e kthimit
gjithmonë të njomë shtalb
si gruni i blertë në mal, në maj.

Mbështeti një kambë
në buzë të anijes – fajkët
krisën lehtë – e dorës
së djathtë i dha hov, e pak ijes, para,
me kapë degën e një pishe
që motet ia kishin këputë
kryet pse kish tregue qëndresë.

Me halët e saj ende në grusht,
drejtoi shtatin.
«Zefir të mbarë!» i uroi lundërtarit.
«Bani sytë katër. Këtu nuk të mbron kush!
Je në tokën tande si zjarr i shkimbun,
o biri i Laertit të mplakun
në zhegun e arave e të aromës së barit!»

Sandalet e ngjelmta me
ujin e detit, puthitë në trinë,
e dizgat e lidhuna kryq deri në pulp
iu ngjeshën shtegut të ngushtë
pa ra krejt mbramja, e dijnë
se asht ende muzg.

Ngadalë iu zhduk krejt hija
që i printe para, me dritën
bashkë që e shtynte, në shpinë.

Mbaruen pishat.
Në terr nuk shquheshin tbana
veç uji i kronit diku larg
çonte një shushurimë të vobektë.
Vinte piskama e qyqes pushuese në errësinë
në një qershi të pavjelun kushedi sa herë.

«Në ujë të cektë, dola!» – buzëqeshi,
pse aty rruga gjendet lehtë.

Përmendi miqtë me emna rishtas,
ata që nuk mbrritën dhe ata që ishin mplakë.
Hyni mandej në një vneshtë të moçme, të ultë
që Eumeu çdo prag-pranverë krasitte
hijshëm për venë të bollshme në sofër,
për bukën e paktë.

III

Brendë, pranë votrës, plakut iu trazue gjumi.
Në traun ma të zi prej tymit, varun,
iu lëkund shpata e dikurshme në millë.
Nalt në pallat, mbretnesha shprishi pëlhurën
për herë të mbramë, nuk kishte ma fillë, as kohë
për tjetër endje.

Eumeu largoi prej zjarrit vorbën e gjizës së re
dhe çeli, për pak ma shumë voesë,
derën drunit gështenje.

Qershor 2020

TRISHTIMI NË HESHTJE

poezi nga

Stefan Martiko

THUNDRAT

Jam rrëmujë sapo zbres
Poshtë vetullave sytë ruajnë
Vështrimin e largët dhe
Buzët e mbyllura tregojnë
Që s'ishte hapur ende
Shpella. Nuk jam i bukur
Por kam kapur në çaste
Mendimin dhe nuk ia shoh
Në sy por
Vetëm mjekrën që dridhet
Më poshtë s'ka më asgjë të
Veçantë një trup që zbret
Poshtë e më poshtë deri
Te thonjtë ku shoh kalin
Tim t'i zhvokshen thundrat

10.6.06

NË ULËZ

Në Ulëz litari i këputur
I pasarelës. Dhe ai imazh
Turbullues që zhduket në një tunel
Po pse Ulza dhe jo një
Peizazh tjetër.Malet si thikë
Ngado që rrotullohesh pjesët
E tepërta t'i presin. Skena
Që njësoj si e Andeve ku
Po presin shqiponjën për
Vizitë prej mërzisë indianët
Edhe pse shqiponja e tyre
Para një shekulli
Mund të kishte vdekur
Ajo kësisoj s'kish qënë kurrë
Kohë reale por frigorifer i saj
Në Ulzë midis greminave
Dhe liqenit të mos
Jetosh tërë kohën por
Vetëm copëza të saj

26.5.06

ÇKA ËSHTË PËRHERË E PAMUNDUR

Nuk kam qejf për të shkuar
Më Venecia veç uroj që ta shoh
Përsëri në një ëndërr. Sepse nuk i
Kapërcej dot pengesat e nga
Shtrëngimi të bëhem zog nëpër
Qiej. Venecia mirë është aty
Ku është dhe qoftë
E bekuar duke më bërë
Përherë ftesa me gondolat
E saj si Mona Lizë ku në
Trishtimin e saj të tërë
Do të mbyten

12.5.06

LEJE PËR DËNIM ME VDEKJE

Vetëm sa për të dalë shëtitje. Nuk
Qe vetëm shëtitje. Ishte nevojë
E sforcuar për të parë
Si kënetës po i thahej shpirti. Dhe si
për detin ti atë çast po vdisje
Duke dalë në shëtitje mikun
E largët në horizont mund ta
Shihje. Dhe gjithçka tjetër që
Ta kishin grabitur si pershembull
Lejet për dënimet me vdekje që
Aq shpesh jepen për të vdekur
Jo si hero por si krimb
Qyteti

14.6.06

PREJ ILUZIONEVE E LAVA FYTYRËN

Unë jam mik i malit në dimër
Kur ai është vetëm me
Borën me ujqërit që ulërijnë në
Një lloj skllavërie e hanë nën
Borë veten. Dimri e kish
Ngulur flamurin në majën e
Hekurave e s'doli asnjë
Guximtar që flamurin ta shkulte
Vetëm unë isha nisur ngadalë-
Ngadalë dhe më larg m'u shfaq
Një pasqyrë e madhe që
Ishte Jezerca. Aty u pashë
Dhe lava fytyrën prej iluzioneve
Sepse maja ishte edhe më
Larg dhe zbrita bashkë me
Urinë e ujqërve

11.5.06

EMRI I GURIT

Mjete si pershembull sëpata kanë qënë
Mendja jonë edhe kur ishin prej
Guri. Koha në mes që na
Braktisi neve dhe mori
Emrin e gurit. Por as kafkat
Tona që me tru të freskët
Çdo shekull do të mbushen
Lëngjet që rrodhën shkërmoqën
Gurin e bronzin hekurin e
Derisa erdhi pika më e
Ndritshme ku çdo gjë do matej
Me shkëlqimin e floririt

11.5.06

DHIMBJE

Shkruaj në dhimbje e në gaz vdes
Atë që më sulet i jap mishin tim
E ushqej në një koritë gjaku pi
Dhe dehet. Një gurgull burimesh
Të largët më lajmërojnë për
Pranverën atëhere mishi fijëzohet për
Të thurur lulet e veta dhe nëpër
Petalet e hapura hyjnë ëndrrat
Me të cilat truri im ushqehet

11.5.08

SYRI I KALTËR

Afrohu dhe zhvishu fletë-fletë
Si pema dhe më trego ku është
Syri i kaltër i gjakut Atje ku
Turbullohemi dhe lëvizim për
T'u kthjelluar ku të ecim nën
Emrin e Bistricës ku metafora
E lumit vërtet mund të
Njolloset por brenda e ka
Syrin e Kaltër

6.6.06

NË DHOMËN E VOGËL

Sa pak e shumëzojmë veten
brenda dhomës së vogël
Nuk hapet asnjë vrimë nga dëshira
ku shumëzuesi të takohet
me herësin
Sa i vakët vrulli për t'u
përplasur me xhamat
Orët janë mbyllur brenda
ditës dhe minutat brenda orës
Në det niveli ra dhe një milimetër
Kali i parë i garës e uli
shpejtësinë dhe unë mbeta
vetëm. Pa tokë nën këmbë. Tani
shpejtësia bënë vorbulla në
dhomën e vogël

23.1.02

LUGETËRIT E PUSHTETIT

E gjallë në të çelur fytyra e
saj ia vlen si freskore
të pastrosh ajrin prej vetes zymtësinë
si plehu ta mbjellësh me një
bimë të tillë prej ku përherë
nisin marshimin ushtritë e të
gjelbërve. Me këta pushkatarë
si kukulla s'di si të sillesh
vetëm duke varur medalionin
e fytyrës tënde në jakë të
xhaketës për të ttembur
lugetërit e pushtetit që kanë
një milion mënyra
për të ngrënë njerëz
dhe Zeusi u shkulë mjekrën
që për zakon perëndive
u rritet

29.6.07

TRISHTIMI NË ECJE

Unë nuk i njoh elefantët me
peshën e rëndë mbi vete sikur
i mbyt trishtimi në
ecje. Në se dhe mendimi ka
këtë peshë mençuria si lule
do çelë pas një shekulli
Shumë mish dhe
kocka të rënda dhe tërë kjo
administratë shtetërore që i
shërben një mendjeje
kaq të vogël

11.6.07

SHPIRTI I TOKËS

Duke e çarë me plug
toka sikur nxirrte dritën
e hënës- një avull i lehtë
me një aromë të lashtë buke
Ati i atit të atit një psherëtimë të
thellë kish mbjellur brenda. Në
orën 5.00 të mëngjesit plugu
nxirrte nga toka hënën dhe
psherëtimën e ngrohtë të një shpirti
Ati im kish qënë kalorësi i
fundit dhe koha mbi tërë ne
kish qënë një grua që si pemë
veton edhe sot te bregu i lumit

16.1.04

NËPËR ANË

Nuk po kujtohesha ç'kisha tjetër
në anë. Kur përpara me asgjënë tjetër
fari nuk të shpëton
në çastin e mbytjes. Ai është paraçasti
Cigaren kërkoja dhe
trupin tënd të bardhë që një kohë tjetër
e shndërroi në statujë
Në anë kishte ca
mbeturina që më pas
do t'i hanim të uritur. Prostitutën
e parë të shëmtuar në anë të rrugës
dhe mllefin për tërë
taksixhinjtë e botës që për të
lozur me vetminë të kërkojnë
10-fishin e çmimit.Në anë
tani jam gati të ha veten
klithmën e fundit të shprehjes
Nëpër anë ku boshatiset më
shpejt tryeza dhe dëgjohet
fjala e fundit e mençur
Në anët boshe që i braktisën
si provincë dhe po rendin
drejt qendrës

15.2.03

EPIKË PËR NJË DRE

Cikël poetik nga

Alisa Velaj

NUK JEMI KAQ TË ZAKONTË

Sonte s'do të jemi kaq të zakontë dashuri.
Kjo strehë e harruar, vetmuar kaltërsive
aq shumë është e etur
për klithma zogjsh mbi ujëra.

Ag dhe muzg nëpër qiell, nëpër det.
Muzg, ag dhe një shtëpi e përndritur,
me një udhë para shtratit që zgjatet nëpër natë,
e marrë të përqafojë yje xixues.

Shtrat i papeshë, i ëmbël si drita
me një diell përmbi krye,
i një shtëpie që na bën të jemi kaq të pazakontë,
kaq të papeshë,
kaq prej harrimi dhe qiparisash të ringjallur.

Nuk jemi më kaq të zakontë dashuri.
Më larg vdekjes, më pranë zërave të erërave
që ndjellin dritën përmbi dete jemi.

Edhe jemi, pa qenë askurrë më parë
të pazakontë der në bjerratisje,
mu aty në zemër të errësirës!

QIPARIS QIELLI E ARKITRAU

- 1 -

Në arkitraun tim bulëzojne
karafila gjak te kuq, gjak.
Jehonën ua ndjen në palce
çdo kalimtar që aty kalon
kur përskuqet hëna.

Hëna përskuqur, kuqëluar
gjer në mugëtirë.
Hëna, shtëpia, nëna perdore
me nje bir plot hir!

duarsh, duarsh lule ankthi
kanë mbirë (pa mërdhirë)

- 2 -

Nëpër kulme që prekin qiellin
qiellin, qiparisi hënëzoet.

qiellon qiparisi mbi arkitrau
karafilat rriten me ajër dhe fjalë

nëpër shtat të bimës hyn e del
një djalë

pa fjalë...

- 3 -

Është bir
është nënë
është vegim shpendi
nepër qiparis

trung mendimi -
fjala e pathënë!

JEHONË

Në atë ishull, jo vetëm ajo është shtëpi.
Ka zogj e kaltërsi tej e ndanë atje.
Tokë e vogël, e vogël sa një këngë fëmije.
Fëmija këndon e hutohet fëmija.

Shtëpia e ishullt ka mjegull përmbi.
Mjegull anekënd shtëpisë.
Fëmija hutohet e ngazëllen nëpër këngë.
Pulëbardhat ia jehojnë zërin brigjeve.

Me zëra deti ngjizen foshnjat dhe ishujt.
Me zëra deti jehonave të ishullit.

EPIKË PËR NJË DRE

Janë ujëra të shkrirë borë, ujëra të shkrirë bore.
Liqen i qashtër ujësh kristalore.
Natyrë e përsosur, e ndritur si teh thike.
Dreri sheh veten në syprinën e qelqtë të liqenit dhe hesht.
Ngrica i strehoi dikur një vëlla.
Feks ndoshta dhe ai në shpirtin e ujanës.

Ngrita kokën dhe pashë -
ai dre ishte nisur drejt meje.

MËRGIM I PABUJË

E rrëkëllen për çdo mëngjes një lëng portokalli,
me sytë e saj blu përhumbur tejdetit.
Pulëbardhat atje rrëkëllejnë ujëra nëpër fyt
Ujëra me copa dielli ngjyrë portokalli.

Nëpër fyt të ditës ajo e lodhur nuk di ku të mërgojë.
Diku ku të ketë shpendë
që i ndjellin të tjera pamje.
Shpendë të amullt mendimi,
me këngë të zvarritura për diellin.

Rebeka kullon natë,
heshtje pemësh dhe çaj hithre.
Kryet e mbrëmjes mbështeten supeve të saj.
Mbrëmja është burrë që lëngëzon vetmi.

Ajo këtë nuk e di.
Ajo vetëm pi lëng portokalli
dhe hesht e hesht me një durim prej brigjesh.

Ajo patjetër do t'ja mbathë në ndonjë muzg
me gjakun e saj nëpër kapilarë.
Mbase gjaku nuk do te këndojë,
buçitja do të jetë e shurdher
dhe mërgimi do të jetë i pabujë...

AI DO TË VIJË

Dikush do të vijë.
Pema ashkla ashkla është, po të shpërbëhet.
Dikush me kujtesë lumi do të vijë.
Nëpër netët e tij, trungjet mbi ujëra lundronin atypari vetëm në heshtje.
Ai kurrë nuk u ngrintë hymn atyre, kurrë!
Dikush do të vijë dhe ne nuk do të jemi njësoj.
Dikush me krahët si degë të harlisura rreth shtatit tim.
Për çdo trung të përmbytur ujërave, ai mbjell një tjetër pemë.
Ai do të vijë.
Ai që rri zgjuar nga zgjimet e lumit.

TY

Mjafton një shenjë,
ashtu kalimthi,
si rrezje e vetme e dritës,
mbi një muranë vetmie
mes qiparisave.

Një shenjë ndoshta e padukshme,
si pëllumbi mbi kryq,
një mesditë të zakonshme,
kur guguftutë e mëngjesit,
këngën ngujuan në gjoks.

Një shenjë, i dashur, një shenjë,
si uji i gjallë i së dielës, -
pikë e vetme vese
mbi syrin tim të djathtë!

LUTJE

Unë i kam parë gjërat të bëhen
kur për një fije floku prekja zjarrin.

I kam parë gjërat të ndodhin
sa herë shenja dashurie
humbnim nëpër prush të ftohtë.

Ish mesnatë dashuri, e mban mend?
Na mpiheshin këmbët nën hirin e bardhë,
agimi kur zbardhëlleu pa asnjë lule frike.

MALL

Ndonjëherë do të mbjellim zambakë.
Tjera herë do të shohim një lule zjarri,
duke iu avitur murit plot lagështirë
të një shtëpie të harruar qëkur.

Do të mbledhim përherë një lloj bime,
ndërsa humbim e humbim
nëpër pyllin
e zbuluar rishmëz pranë shtëpisë.

Ishte ditë e vranët, jashtë binte shi me shtamba dhe vera kish marrë fund një herë e mirë ndonëse ishte ende muaj gusht. Nga dera e hapur e ballkonit vinin jehona të brerimës mbi kulme dhe pllaquritje veturash që shkonin pellgjeve plot ujë. Fqinja e krisur kish lëshuar listën e vet nga Spotify në zërim maksimal, sikur kërkonte të shembë murin me zëdhënës.

Ai ishte në dhomën e gjumit, duke futur rroba me rrëmbim në një valixhe të hapur mbi shtrat. Ajo, mbështetur te dera e dhomës, me duart lidhur mbi gjoks. Valixhja i dukej si kafshë që kish hapur nofullat dhe po i gllabëronte jetën.

-Pra kjo qenka zgjidhja jote. Të largohesh! Të ikësh!!

Ai nuk denjoi të përgjigjej, por rrobat fluturuan drejt valixhes më forcërisht.

-Përgjigju, qelbësirë!, thiri ajo. Pra kjo qenka zgjidhja jote!? Kjo!!

Zëri i doli i gërryer, si t'i kish shkuar përsipër me xunkth. Sytë iu rrëmbushën nga tronditja, e njëmijë gjemba i thumbuan gjymtyrët. E dinte që tash se do të urrente veten për këtë shfryrje, këtë dobësi. E vetmja punë më keq se largimi i tij do të jetë nëse ai rri nga dhimbja. Nga mëshira. Qifsha mëshirën tënde, mendoi ajo me vete; por në vend se ta forconte kjo sharje e plagosi edhe më fort.

Qifsha mëshirën tënde, u shfry prapë mes lotësh, pa ditur nëse këto fjalë i kish menduar a i kish thënë me zë.

Bluzat, kravatat, të linjtat. Bisha gojëhapur e katullaqur në shtrat po gllabëronte tashti imtësitë, cikërrimet, vogëlsirat që kishin shenjëzuar praninë e tij, pasi kish shkulur nga armari ravijëzimin e tij të madh.

"But if you loved me, why'd you leave me? Take my body. Take my body." Nga matanë murit po buçiste All I Want nga Kodaline, si për t'u vënë krypë mbi plagë dhe pikë mbi i tërë gabimeve drejtshkrimore në ekzistencë të saj.

Ai u ndal për një çast, pa u kthyer drejt saj, që ta inspektonte armarin bosh. Aty më s'kish ngelur asgjë. Asaj iu duk sikur ai po lyente zi me atë shikim, si te Rolling Stones, e i erdhi që ta godasë në shpinë. Por u përmbajt. Mirë më bëhet, mendoi.

Ai u kërrus për të mbyllur gojën e bishës, por u ndal përnjëherë kur pikasi foton mbi komodinë të gjumit. Ai, ajo, e vajza. Të tre të qeshur.

-A jo, këtë jo, ulëriti ajo, e u gjuajt drejt komodinës.

Të dy kapen nga një cep të fotos njëherësh, ndërsa Kodaline po bënte namin te fqinja. *"All I want is, and all I need is, to find somebody. I'll find somebody like you."*

-Lësho fotografinë, briti ai.

-Ik shporru, ia ktheu ajo, mos t'i shoh më sytë.

-Lësho, po të them!

Ajo s'iu përgjigj, e ai nisi t'ia shkulte foton nga dora. Ajo ulëriti, si ta kish goditur me thikë. Një herë, dy herë. Tri. Herët tjera ulërimë si këto kishin

ZGJIDHJA MË E MIRË

tregim nga

Shqiptar Oseku

mjaftuar që ai të tërhiqej me tmerr. Por kësaj radhe jo.

-Lësho fotografinë, të thonë!

-Ik shporru, ulëriti ajo duke qarë, ik shporru!

Një copë here u mundën në heshtje rreth fotos, ndërsa hijet u çonin dashuri në mur si dy jashtëtokësorë memecë. Dukur ai ia lëshoi duart, e u ul i dihatur në shtrat.

-Ti s'e ke këtë të drejtë, i tha me zë të ulët. S'ke të drejtë ta mbash këtë fotografi, e di vetë që s'ke.

-Ti ik shporru, tha ajo. Më bëhet qejfi që ik, s't'i shoh më sytë. Por ajo kurrë! Ajo ngel këtu!

Ai ia nguli sytë e kapsallitur, si për ta vrarë me ta.

-Nuk ta lë ty kurrën e kurrës, tha ai, a merr vesh. Kurrën e kurrës!

-Ajo ngel këtu!, tha ajo.

Ai rrodhi buzët e mblodhi duart në grushta, ndërsa nofullat i bluanin nga tërbimi. Një damar i fryrë, i enjtur, iu shfaq në ballë, si kur njeriu përmbahet me forcë nga një zor i madh. Mori frymë thellë, si kafshë e plagosur.

-Mendon se ta lë ty? Ty!?

U flug sërish mbi të, e mbi foton. Zunë të grindeshin prapë, një luftë e pafjaltë rreth një fotografie, ndërsa bota rreth tyre po firohej copë e çikë, e trerë e tjegulla të kulmit po u rrëzoheshin mbi krye, e muret po u thyheshin kudo.

Ai ishte më i fortë, por ajo kish qenë gjithmonë më e vendosur. Edhe kur ishin hasur së pari, ajo kish bërë hapin e parë. Njësoj edhe kur kishin vendosur të mbanin fëmijën, e të blenin banesën. Asaj iu kujtua se kjo ishte mbase hera e parë që ai po tregohej i vendosur: kjo kuptesë e ngarkoi me pikëllim.

Ai e kish ndarë mendjen ta merrte foton.

-Lëshoje moj, shfryu ai, duke ia shkulur nga duart.

Një si flakë e bardhë zemërate e djegu në rrënjë, një si prush i bardhë tërbimi e zhgënjimi e dhimbjesh e dëshpërimi e pikëllimi përnjëherësh. Ajo shtërngoi në çastin e fundit foton me duar, si me darë.

Një grisje shqeu përgjysëm natën, e shiun përjashtë. Foto u nda në dy. Atij i ngeli në dorë ajo dhe koka e vajzës, si frut i paarrirë. Ajo mbeti me foton e tij dhe të trupin e saj të shkokëzuar. *"I'll find somebody like you."*

Ai u ngrit, me gjysmën e fotos në dorë. E shikoi një copë here, mandej e puthi dhe e ruajti copën e vet në një xhep të këmishës. Mandej e mbërtheu valixhen me një vrull të ri, sikur të ish kujtuar për një premtim a vendim të vjetër.

-Lamtumirë, i tha para së të dilte.

Kur doli, përplasja e derës oshëtiu në mbarë rruzullin. Ndoshta kjo është zgjidhja më e mirë, mendoi ajo e mekur.

Lart mbi kulmin e thyer ajo pa retë e mbarsura dhe mbi to, në ekzosferë, satelitët që po endeshin si gjymtyrë të prera rreth një planeti maniak që i kish kasapuar e vërvitur atje, e akoma më tej planetet tjera, Diellin, yjet, e galaksat tjera tek po largoheshin ngadalë nga njëra-tjetra. E tërë gjithësia është në proces të entropisë, mendoi ajo, dhe ky mendim abstrakt çuditërisht arriti t'i zgjaste një fije ngushëllimi, si një fije kashte për të mbyturin.

Fqinja e krisur fiku muzikën dikur vonë, e një heshtja gërmadhash mbretëroi befas gjithandej. Nga dera ende e hapur e ballkonit vazhdoi të ndihet melodia e brerimës së rrallë mbi kulme, por veturat qenë zhdukur diku, tok me pellgjet poshtë tyre. Ajo përqafoi tërë natën gjer në mëngjes trupin e vajzës, të shkokëzuar si kish ngelur thuase nga një krim, e t'i fliste ngadalë fjalë ngushëllimi.

NË PRITJE

tregim nga

Osamu Dazai

Të gjitha ditët më shkuan në stacionin e vogël të trenit duke pritur dikë. Se cili ishte, nuk e di.

Gjithmonë kaloj andej për të psonisur markatën. Ulem në një bankë të ftohtë, vendos trastën e ushqimeve mbi gjunjë dhe shoh e humbur drejt turmës. Sa herë që mbërrin një tren, një turmë udhëtarësh gëlon furishëm prej vagonëve. Grupi i çrregullt niset drejt daljes në të kundërt me një grumbull tjetër që lëviz drejt pasarelës, dhe të gjithë njerëzit, me po të njëjtën fytyrë të ngrysur, ecin me hapa të vegjël por të ngutshëm drejt biletarisë. Më pas, pa e vrarë mendjen aspak ç'ndodh rreth tyre, nisin të ecin me ngut. Kalojnë fare pranë vendit ku qëndroj ulur, dalin në sheshin përballë stacionit, dhe secili zhduket në punë të tij. Nis të mendoj hutueshëm. Çfarë do të ndodhte nëse njëri prej tyre do të më buzëqeshte dhe do të më përshëndeste? Ah, jo! Pash' Zotin! Kjo mundësi kaq e vogël më bën të ndihem aq nervoze vetëm duke e menduar, sa më duket sikur dikush më ka hedhur ujë të ftohtë në qafë. Nuk mundem të marr dot frymë; megjithatë vazhdoj të pres për dikë. Kë mund të jem duke pritur? Çfarë njeriu mund të jetë? Por ndoshta ajo që mund të jem duke pritur mund të mos jetë një qenie njerëzore. E urrej faktin e të qenit njeri. Në të vërtetë kam frikë. Sa herë që gjendem surrat më surrat me dikë them gjëra të tilla si: "ç'kemi, si je?", apo "si po kalon?", përshëndet sa me thënë, ndjej sikur jam njeriu më i shtirur në botë. Ndihem aq keq sa më mirë të vdes. Dhe njerëzve të cilëve u flas kthehen në mbrojtje pa asnjë arsye, bëjnë lavdërime të mjegullta, dhe flasin për përshtypje që nuk janë aspak të vërteta. Kujdesi i tyre i detajshëm më bën të ndihem keq: bota është shumë herë më tepër e neveritshme dhe nuk mundem ta mbështes. Njerëzit shkëmbejnë përshëndetje të ftohta njëra pas tjetrës pa u lodhur, dhe kështu jeta vazhdon.

Mua nuk më pëlqen të përzihem me njerëzit. Prej kësaj, duke mos dashur të sjell ndonjë argument apo arsye kushedi sesa të veçantë, nuk u bëj kurrë vizita shokëve. Rehatia më e madhe për mua është të qëndroj në shtëpi me mamanë time rrobaqepëse, si dy të vetmuara, në heshtje. Por më në fund shpërtheu lufta, dhe ambienti në shtëpi u rëndua aq shumë sa më bëri të ndihesha fajtore që po rrija kot. Po ndihesha e turbulluar dhe s'po mundja të rigjeja qetësinë e mëparshme. Doja të bëja dhe unë diçka, ndonjë punë të mundimshme, të paktën aq sa të mundja. Humba gjithë besimin e fituar prej jetës që më kishte udhëhequr deri atë grimçast.

Nuk mund ta duroj dot gjithë këtë heshtje që ka mbuluar shtëpinë. Megjithatë, kur dal nis të kuptoj se nuk kam nga të mbytem. Kështu që vërtitem tregut tutje-tëhu, dhe në kthim, krejt natyrshëm shkoj e ulem në bankën e ftohtë. Kam mendimin se dikush do të vijë, por nëse vjen, ç'duhet të bëj? Kjo gjë më ndjell panik, por mund ta përballoj. Nëse do të ndodhë, do t'i rrëfej jetën time: jam gati dhe ky çast shënjon fatin tim. Këto ndjenja të dorëheqjes dhe fantazia e pafytyrë janë të ndërlidhura në një mënyrë tepër të çuditshme. Kjo ndjesi më ka vënë së poshtmi keqas. Bota përreth heshti: njerëzit që vërtiten nëpër stacion duken kaq të vegjël dhe të largët, si të ishe duke i parë me teleskop së prapthi. Ndjesia është e paqartë, si të jem duke ëndërruar zgjuar, duke mos ditur në jam gjallë a vdekur. Eh! Çfarë dreqin po pres? Kështu pra nuk isha asgjë më tepër veçse një grua e poshtër. E gjitha kjo prej shpërthimit të luftës, prej punës së tepërme pasi dua të ndihem e dobishme, mbase nuk është gjë tjetër veç një gënjeshtër, një justifikim fisnik për të rendur pas gjetjes së mundësive të realizimit të fantazive të mia të shfrenuara. Ja tek ulem me shikimin e përhumbur, por thellë brenda meje mund të shoh sesi rritet flaka e dëshirave më të shthurura.

Por, kë djallin po pres? Nuk kam absolutisht asnjë ide të qartë, vetëm disa mendime të vagullta dhe të ngatërruara; megjithatë vazhdoj të pres. Qysh prej fillimit të luftës kaloj kësi anësh çdo ditë pas psonisjes së markatës dhe ulem në këtë bankë të ftohtë duke pritur. Po sikur dikush të më buzëqeshë dhe të më flasë? Ah, jo, nuk je ti ai që po pres. Atëherë, çfarë? Çfarë pres? Bashkëshortin? Jo. Të fejuarin? Jo, as që bëhet fjalë. Një shok? Në asnjë mënyrë. Para? Kjo është qesharake. Ndonjë fantazmë? Ah jo, të lutem.

Diçka më fisnike dhe më të gëzueshme, diçka të mrekullueshme. Për shembull, diçka si pranvera. Jo, nuk është kjo. Gjethe të gjelbërta. Në muajin maj. Uji i ftohtë dhe i kristaltë rrjedh nëpër fushat e grunjta. Jo, aq më pak këtë. Oh, por unë ende jam duke pritur, me zemrën që më rreh. Njerëzit kalojnë njëri pas tjetrit mu nën hundën time. Nuk është ky, as ky tjetri. Me trastën e ushqimeve në krahë, dridhem dhe pres me gjithë zemër. Ju kërkoj vetëm të mos më harroni. Ju lutem mos e harroni vajzën njëzetepak vjeçe që vinte çdo ditë në stacion dhe kthehej në shtëpi e boshatisur. Ju lutem më kujtoni dhe mos qeshni me mua. Nuk do tua them emrin e stacionit. Dhe pavarësisht kësaj, mbase do të më shihni ndonjë ditë.

Përkthyer nga spanjishtja
Antonio Çikollari



TONI MORISON: TË SHKRUARIT ËSHTË E VETMJA GJË PËR TË CILËN JAM KRIJUAR

Intervistoi: BRANKA BOGAVAC

Lajmi për marrjen çmimit "Nobel" nga Toni Morison jehoi në gjithë botën si bombë, sepse Morison ishte zezake. Një çmim i tillë është i pari në histori që i jepej një zezakeje amerikane.

Por Toni Morison nuk është romanciere e panjohur: në vitin 1988 ka fituar çmimin "Pulitzer" për romanin "Belloved" dhe, ç'është më e jashtëzakonshmja, dy herë ka qenë në listën e librave më të shitur në SHBA. Morisoni është gjithashtu një profesoreshë e shquar dhe shefe katedre në Universitetin e Prinstonit, i cili para pak kohësh nuk pranonte as hebrenj dhe as zezakë. Morisoni është drejtoreshë e shtëpisë botuese "Random House", ku ka botuar "Anxhela Devisin". Morisoni ka mbrojtur doktoraturën me temën: "Vetëvrasja në veprën e Uiljam Folknerit dhe të Virxhinaia Vulfit". Krahas gjashtë romaneve që i sollën famë botërore, ajo ka shkruar edhe komedinë muzikore "Nju-Orleans", që tashmë është shfaqur në Nju-Jork, si dhe pjesën teatrale "Dreaming Emet", kushtuar Martin Luter Kingut.

Kështu e ka shpjeguar përzgjedhjen e vet juria e çmimit "Nobel": "Arti i saj prej romanciereje, me një fantazi të fuqishme dhe shprehjen e pasur poetike, paraqet pamjen e një aspekti themelor të realitetit amerikan…". E, me të vërtetë, Morisoni zotëron stilin e vet eliptik, në të cilin fut të folurit e ndryshëm, që nga më letrari e deri tek të folurit popullor zezak.

Shkrimtarët e dashur të Toni Morisonit janë Kafka, Dostojevski, Markezi, Fuentesi, James, Sikey, Dikensi, Shekspiri, Gëtja, Jan Potocki, Xherard Menli Hopkinsi.

Para pak kohësh ajo ishte e ftuar në Francë, në Paris, ku mori pjesë në takimin e Akademisë Universale të Kulturës (edhe ajo është anëtare e Akademisë), ku marrin pjesë njerëzit më të shquar të botës së artit e letërsisë: Umberto Eko, Horhe Amado, nobelisti Vual Sojinka, Liv Ulman, Kueljar. Tema e takimit ishte "Intervencioni", në tëre kuptimet e kësaj fjale. Me Morisonin u takova në Sorbonë, ku u organizua ky takim ndërkombëtar.

Toni Morison është një femër me ngjyrë çokollate, e bukur, e bëshme, flokët i mban sipas modës afrikane dhe është mjaft e këndshme në bisedë. Kur flet duket sikur buzëqeshja i fluturon nga buzët, kur bëhet fjalë për ndonjë temë të këndshme, por kur flitet për gjëra serioze ajo duket e menduar, sikur të mbante mbi kurriz tërë botën. Ato ditë Toni Morisonit iu dha Urdhri "Legjioni i Nderit", që ia dorëzoi personalisht ministri i Kulturës, Zhak Tybon. Vetëm një javë para marrjes së çmimit "Nobel", në Sorbonë iu dha titulli "Doktor i Nderit", që ishte një dëshmi se ajo ishte bërë e njohur dhe e vlerësuar në Francë.

Fati i Toni Morisonit i ngjan disi përrallës së Hirushes. Pasardhëse e skllevërve zezakë, Morison me punën dhe zgjuarsinë e saj u ngjit në shkallën më të lartë të shoqërisë dhe të vlerësimit, duke marrë çmimin "Nobel" në letërsi, si e para zezake në historinë e njerëzimit. Pesëmbëdhjetë tetorin e kaluar ajo u njoftua me telefon se i ishte dhënë çmimi "Nobel". Kujtova se po më njoftonte një shoqe dhe se po fliste përçart, u shpreh ajo, sepse asnjë zezak amerikan nuk e kishte arritur më parë atë vlerësim të lartë.

"Jam lindur në një familje të varfër punëtorësh me katër fëmijë. Babai punonte në objekte të ndryshme ndërtimi dhe bënte punë të ndryshme: lante automjetet ose merrej me saldim. Unë jetoja në një qytet të vogël, ku pak a shumë tërë njerëzit ishin të varfër. Këtu kishte shumë të ardhur si polakë, çekë, italianë, meksikanë, zezakë e të bardhë. Barrierat shoqërore ekzistonin dhe njerëzit i mbanin brenda vetes, kurse fëmijët ndiqnin bashkërisht shkollën, sepse kishte vetëm një gjimnaz. Shoqja ime më e mirë ka qenë Rozmari Magazini, origjinën e së cilës e merrni me mend. Por në Loren nuk kishte geto të zezakëve. (Toni Morison lindi në vitin 1931, në shtetin Ohajo, afër Klivlendit.)

Pjesën më të madhe të kohës në këtë qytet e kaloja në bibliotekë. Ajo ishte e varfër, prandaj arrita t'i lexoj të tëra librat që ndodheshin në etazherët e saj: kishte aty edhe poezi të klasikëve anglezë dhe amerikane. Në atë kohë as që ëndërroja për letërsi, por dëshiroja të bëhesha balerinë. Kështu fillova të ndjek baletin, por isha e detyruar të ndërprisja kursin, sepse nuk kishim para për të paguar orët e mësimit."

Si kanë qenë hapat tuaj të parë drejt suksesit?

Të ishe grua, të ishe me ngjyrë dhe e varfër në një qytet industrial të Perëndimit të Mesëm, ishte një e metë e madhe, por pikërisht kjo gjë më bëri shumë të përgjegjshme. Gjithmonë e kam ditur se do të isha e detyruar të punoja, se do të martohesha dhe do të bëhesha nënë. Por këto unë nuk i konsideroja si barrë të rëndë. Ngaqë isha një nxënëse e shkëlqyer në mësime, prindërit vendosën që të më "provonin" një vit në fakultet, "vetëm një vit", që u pasua edhe me të tjerë. Kështu filloi, por që të shkoja për studime dhe t'i vazhdoja ato, im atë u detyrua të bënte edhe një punë tjetër. Po ashtu edhe nëna qe e detyruar të punësohej, kur u nisa për në Uashington, në Harvard (i vetmi universitet për zezakët në Amerikë). Më vonë edhe unë kam dhënë gjuhë angleze në fakultet, u martova me një arkitekt nga Xhamajka dhe linda dy djem, që tashmë janë të rritur.

Si keni filluar të shkruani?

Nuk kisha ndër mend të bëhesha shkrimtare. Nuk zotëroja asgjë, me përjashtim të fantazisë, aftësi të rrallë për ironi, melankoli dhe një respekt të pazakontë ndaj fjalës. Nga martesa filloi të më merrej fryma, prandaj u divorcova dhe vetëm pas kësaj fillova të shkruaj për kënaqësinë time, fshehurazi, sikur kjo gjë të ishte diçka e turpshme. Ishte viti 1965, kohë konfuzioni dhe e papërshtatshme, kur u bë gjithashtu një periudhë e turbullt në evolucionin e marrëdhënieve midis racave. Fillova të shkruaj për t'i sqaruar vetes disa gjëra, krijova ca rregulla, sepse nëse kuptohej ideja e së kaluarës, ajo mund të ndihmonte në konceptimin e së ardhmes. Prandaj fillova të shkruaj, siç thashë, për të krijuar rregullin, të bukurën, jetën në atë që më rrethonte e që ishte vetëm kaos, mjerim dhe vdekje. Historia e zezakëve në Amerikë është një tradhti dhe mashtrim i vërtetë, e deformuar dhe e konceptuar keq. Ajo fsheh pasuri, ngjyra, ngrohtësi, fuqi që gjithmonë mbahej e fshehur, sidomos për sa u përket grave. Prandaj shkruaj për të dëshmuar, dhe vështrimi im në tërësi nuk është si ai i zezakëve të tjerë. Libri për mua është një botë e re që ka ekzistuar, por që asnjëherë nuk është marrë parasysh. Kur shoh një maskë afrikane, në të njëjtën kohë shoh se sa e vjetër, primitive dhe e fuqishme është ajo, po ashtu edhe sa moderne e bashkëkohore. Dëshiroj që librat e mi të zotërojnë veçori të artit prehistorik, që të zëvendësojnë ushqimin, të cilën na e ofron muzika. Gjithashtu, dëshiroj që zezakët ta zotërojnë përsëri atë kohë kur doli në dritë xhazi, sepse ata e shpikën atë muzikë, të lirë e të improvizuar. Sipas mendimit tim edhe gjuha zotëron muzikën e saj, të vetën.

Ju mbani një qëndrim normal ndaj të bardhëve, pa asnjë lloj urrejtjeje ataviste?

Sikur të shkruaja për të bardhët, ashtu siç shprehen ata për zezakët, me stereotipa të njëjtë, vetëm se do të tregoja dobësinë time. Nuk dua as të mbivlerësoj zezakët dhe as të nënvlerësoj të bardhët, sepse nuk më pëlqen të përdor asnjë lloj strategjie të dominimit racor. Qindra vjet me radhë zezakët u janë drejtuar të bardhëve me fjalët: "Nuk është e rëndësishme raca, rëndësi ka njeriu! Zezakun shikojeni si qenie njerëzore, gjykojeni atë mbi bazën e karakterit dhe të punës që bën". Por të bardhët janë përgjigjur: "Vetëm raca është e rëndësishme!" Prandaj

edhe sot dallimet racore që kanë ekzistuar me shekuj, realisht janë të pranishme dhe interesimi vetëm me fjalë nga ana e njerëzve përparimtarë, nuk do të bëjë që ato të zhduken me të vërtetë. Në Amerikë jeta politike, kulturore dhe ekonomike është mbështetur në konstruksionin e identitetit të racës së bardhë. Ndërkohë që zezakët i detyron e keqja për ta parë gjithmonë veten viktimë e për të jetuar në këtë gjendje. Gratë, në përgjithësi, janë të prira që t'i nënshtrohen situatës. Me fjalë të tjera, identiteti amerikan fillon me racën e bardhë dhe gjininë mashkullore, pra me mashkullin. Sido që të jetë forca, rangu apo statusi i tij ekonomik, mashkulli gjithmonë mbetet mashkull dhe i jep përparësi vetes ndaj gruas. Nëse do të përpiqeni që prej tij të krijoni një qenie njerëzore, ajo do të jetë një përpjekje e vështirë. Në jetë duhen pranuar improvizimet.

Ju keni marrë pjesë në Parlamentin Ndërkombëtar të Shkrimtarëve, në Strasburg, ku ka marrë pjesë edhe Salman Ruzhdiu. Ç'mendim keni për rastin e tij?

Presionet, censura, ndëshkimet, nuk janë aspak gjë e re për artistët. Armiqtë e lirisë së mendimit dhe të shkruarit sot janë të larmishëm. Nuk janë më armiq vetëm tiranët me forcën e tyre totalitare, por, për shembull, në rastin e Ruzhdiut, është qeveria britanike ajo që vazhdon të mbajë marrëdhënie tregtare me Iranin.

Si e përjetuat lajmin e vlerësimit me çmimin "Nobel"?

Si një dhuratë që nuk kërkon revansh se ndryshe nuk do të quhej e tillë. Ky vlerësim me rëndësi botërore më obligon për të qenë më e vëmendshme për çdo fjalë që shpreh, sepse tashmë të gjitha regjistrohen. Por pikërisht për këtë gjë kërkoj të drejtën për të gabuar dhe nëse gaboj, dëshiroj ta pranoj atë.

Ju jeni shprehur: "Të shkruarit është e vetmja gjë për të cilën jam krijuar", megjithatë këtë gjë në veten tuaj e keni zbuluar me shumë vonesë.

Siç jam shprehur më sipër, kam filluar të shkruaj pas divorcit, isha e trishtuar dhe fillova t'i bëj vetes pyetje me shkrim. Shkruaja pa përjashtim çdo ditë, derisa m'u bë kërkesë e domosdoshme. Ndonëse të shkruarit nuk është punë e lehtë, përkundrazi, e vështirë, unë në të gjej kuptimin e jetës dhe të kënaqësinë që asgjë tjetër nuk mund të ma ofrojë. Por, sidoqoftë, nuk kam zgjidhje tjetër, më vështirë e kam të mos shkruaj sesa të shkruaj.

Ju jeni profesoreshë dhe shefe e katedrës së gjuhës angleze në Prinston. A nuk keni menduar që pas marrjes së çmimit "Nobel" t'i përkushtoheni plotësisht letërsisë?

Nuk kam dëshirë të braktis fakultetin dhe studentët e mi, sepse është e vetmja mënyrë për të mbajtur kontakt me realitetin, për të zbuluar gjëra të reja dhe për t'u pasuruar nga ana intelektuale. Për mua të jesh profesor do të thotë të mësosh pa ndërprerje dhe të rifreskosh idetë personale.

Nikol Zand, gazetar letrar i "Le Monde" thotë: "Me siguri që Toni Morisonit i është kujtuar dashuria e gjyshes së vet, një ish-skllave, e cila e ka mëkuar fëmijërinë e saj me rrëfime dhe folklorin e zezakëve të Jugut, duke e rrethuar me rituale dhe fise hyjnore. Ajo e shpinte në botën e magjisë dhe të fantazmave drithëruese, në botën ku ëndrrat kishin më shumë fuqi se realiteti dhe që familja i ruante që nga Xhorxhia e Alabama, pra, që nga paraardhësit e saj zezakë. Kështu, Toni trashëgoi tërë kapitalin e legjendave dhe të ëndrrave, të cilat i kanë shërbyer si frymëzim. Toni Morison konsiderohet si një nga romancieret më të talentuara zezake".

Tradita është pjesë përbërëse e qenies sonë. Gjyshja ime ishte një tregimtare e vërtetë, kurse gjyshi lexonte vetëm Biblën që e dinte përmendësh. Nëna ime ishte jashtëzakonisht energjike dhe mbahet mend se kur gjente krimba në miell protestonte tek Ruzvelti. Ajo më ka përkrahur për të ndjekur studimet, në vend që të martohesha. Por desha të shtoj edhe faktin se në shtëpinë tonë fjala "skllav" përmendej si një refren dhe se kujtimet e skllavërisë ishin tepër të gjalla. Prandaj falënderoj Perëndinë që nënën e kam ende gjallë dhe që ia arriti ditës kur çmimi "Nobel" t'i jepej një trashëgimtareje skllave. Befasimi im i parë ka ndodhur para dymbëdhjetë viteve, kur fotografia më doli në faqen e parë të "News week". A e merrni dot me mend se ç'do të thoshte kjo? Unë, një zezake trashamane, me flokë të thinjur e me një bluzë ngjyrë rozë, të gjendesha në faqen e parë të së përjavshmes prestigjioze të të bardhëve? Kjo është dëshmi se shoqëria po evoluon dhe se nuk duhen humbur shpresat.

Ku e keni ndier personalisht diskriminimin?

Më shumë kam vuajtur për shkak të djemve të mi, kur i keqtrajtonin apo kur nuk i lejonin të shkonin diku; kisha frikë se nuk do të kishin mjaft forca për t'ju kundërvënë poshtërimit. Për shembull, në një vetëshërbim më ka rastisur të shoh një grua të bardhë, e cila, me një shprehje neverie në fytyrë, largohej nga im bir, që donte të zinte radhën pas saj. Këtu njeriu është i pafuqishëm, ndërsa ofendimi mbetet.

Keni shkruar librin të titulluar "Xhazi". Në të nuk bëhet fjalë për muzikën, por për jetën e dy të huajve që vijnë nga fshati në qytet për të jetuar atje. Por mua më intereson pikërisht koha e xhazit, ajo e viteve '20.

Atë vit shpesh e lidhin me Skot Ficxheraldin, Gertruda Stajnin dhe romanet me xhazin në sfond. Në të vërtetë, kjo është muzikë zezake. Tani është e vështirë ta përfytyrosh se çfarë përfaqësonte kjo muzikë për zezakët e rinj në atë kohë. Ajo qe një eksplozion i vërtetë, një tërmet, që bëri që gjeneratat të ndihen ndryshe. Para daljes së xhazit të rinjtë martoheshin e vinin kurorë, sepse ashtu duhej bërë, por pas daljes së xhazit lidheshin me njëri-tjetrin, sepse e zgjidhnin partnerin e vet. Kjo muzikë i afroi njerëzit. Zezakët nuk ishin më robër, trupi tashmë u përkiste vetëm atyre. Kur trupi është juaji tashmë kërkoni kënaqësinë, tundimin... Tanimë që muzika nuk është më e jona, romani ka zënë vendin e saj.

Libri juaj i parë titullohet "Syri më i kaltër".

Këtë libër e kam shkruar sepse po të isha më e re do të isha e lumtur sikur ta gjeja në bibliotekë. Kur po e shkruaja e dija se tek ne nuk ishte shkruar asgjë për vajzat zezake. Unë doja të tregoja se deri në ç'shkallë kanë qenë të shtypura zezaket dhe si e kapërcyen edhe racizmin edhe skllavërinë. Disa nga heroinat e mia përshtaten, ndërsa të tjerat nuk rezistojnë dot. Por unë nuk doja që këto viktima të zhduken, por vetëm që t'u jepej mundësia ta afirmonin veten. Ne do t'i tradhtonim ato nëse do të shpreheshim se vuajtjet e tyre nuk kanë zgjatur me breza të tërë. Ato nuk janë rrëfime të gëzueshme, por unë jam shkrimtare dhe jam e detyruar të tregoj të vërtetën. Në këtë libër, heroina është një vajzë njëmbëdhjetëvjeçare që ëndërron për flokë biond dhe sy të kaltër, siç njihet bukuria "klasike", sytë e kaltër të Shirli Tempëll. Por, meqenëse vogëlushja është zezake, do të shfaqet kontradikta në qenien e saj dhe ajo do

të lajthisë "duke ëndërruar" për "bukuroshen sykaltër". Ky është një shembull i skizofrenisë raciste dhe që i imponon një model të vetëm bashkësisë që është përjashtuar për shkak të ngjyrës së saj.

"Sula" është rrëfim mbi miqësinë e dy grave. Libri ka fituar çmimin e kritikës për vitin 1977. Ky libër është futur këtë vit në shkallën më të lartë të programit të letërsisë, në Francë. Mua më duket se për miqësinë joseksuale midis grave është shkruar fare pak, prandaj më tërhoqi kjo temë për të zbuluar se ku mbështetet kjo miqësi jashtë pranisë së njerëzve. Të kesh një mike është kaq e rëndësishme, saqë duhet të bësh gjithçka që ta ruash atë. Por heroina ime e kuptoi se ç'do të thoshte për të miqësia me shoqen, vetëm kur e humbi atë. Miqësia e tyre është një metaforë e dallgëve të mëdha që na fshikullojnë gjatë jetës.

Libri "Belloued" fitoi çmimin "Pulitzer" në vitin 1988 dhe në Amerikë bëhet bestseller, duke ju bërë të famshme në botë.

Temat e mia i gjej në mënyra të ndryshme. Nganjëherë më frymëzojnë ngjarje reale, siç është rasti i këtij libri. Nga mesi i shekullit të kaluar, një nënë më shumë dëshironte ta vriste të bijën sesa të lejonte që ajo të bëhej skllave. Ky rast atëherë pati jehonë të madhe, por mua ngjarja më shërbeu vetëm si zanafillë, ndërsa shtjellimi ishte fantazia ime.

"Kënga e Salomonit" është vlerësuar si romani më i mirë i vitit në Amerikën e Veriut.

Në të përshkruhen përpjekjet e një djaloshi zezak për të gjetur identitetin e vet, kemi një afresk të robërisë dhe të shfaqjes së legjendave afrikane.

Fjalimi juaj në Sorbonë, si pjesëmarrëse në Akademinë Universale të Kulturës, la mbresa të thella. A mund të më përmendni ndonjë fragment prej tij?

Sot, shpeshherë e ndiej pafuqishmërinë e fjalës para forcës së madhe e masive të së keqes, të kriminalitetit dhe indiferentizmit. Ne e dimë se edhe njerëzit më të këqij janë të aftë të lexojnë librat më të mirë, të dëgjojnë muzikë të shkëlqyer, të shohin tablo të mrekullueshme. Por, në të njëjtën kohë, ata janë të gatshëm për të kryer aktet më të këqija ndaj bashkëqytetarëve. Megjithatë, fjala është e domosdoshme dhe kjo është e vetmja gjë që disponojmë.

Për njëfarë kohe, jo shumë të largët, në Jugosllavi mbizotëronte koncepti totalitarist "moralisht i përshtatshëm", që do të thotë njeri i bindur. Tashmë në Amerikë qarkullon një koncept i ngjashëm "politikisht korrekt". Nga e ka burimin diçka e tillë?

Mua më shqetëson shumë origjina e kësaj ideologjie dhe qëndrimi i elementëve të së djathtës ekstreme në këtë kontekst. Ata bëjnë të pamundurën për të penguar evoluimin e mirësjelljes midis njerëzve dhe në shoqëri. Meshkujt tërbohen sepse nuk mund t'u drejtohen më grave me fjalën "ajo femra", por kjo nuk ka shumë vlerë. Gjërat serioze fillojnë kur në konviktin e studentëve, në dyert e të gjitha dhomave të gjumit zbardhin kryqet naziste. Ose kur studentët, "për t'u zbavitur", organizojnë "shitjen e skllevërve" në ankand. Kjo është zbavitëse për të bardhët, por mund ta merrni vetë me mend reaksionin e zezakëve. Nëse kjo gjë ndalohet, atëherë ata kërkojnë "të drejtën për t'u shprehur". Kjo është thikë me dy tehe. Mënyra më e mirë për të shmangur diskriminimin është që shprehjet tallëse ta humbin rëndësinë e tyre dhe që të minimizohen në aspektin intelektual. Prandaj asnjëherë nuk duhet të tregohemi të lëkundur që publikisht dhe në çdo rast të shprehim mendimin tonë në raste të tilla. Për sa i përket punës sime, unë asnjëherë nuk do të pranoj që dikush të më imponojë direktiva, qofshin meshkuj apo femra, të bardhë apo zezakë. Nëse do t'i isha nënshtruar ndarjes sipas racave, nuk do isha shkrimtare. Rritja e kriminalitetit midis të rinjve është fakt. Shkak i tij, krahas varfërisë, është sepse pothuajse të gjithë njerëzit në këtë vend disponojnë armë. Më lehtë është të sigurosh një armë sesa një libër, madje edhe të miturit nëpër shkolla mbajnë armë. Nuk e merrni dot me mend se sa është numri i gjyqeve midis grave e burrave, të cilët gjatë kohës së gjykimit, me marifet, fusin armë edhe në sallën e gjyqit. Gjatë procesit gjyqësor ata qëllojnë njëri-tjetrin nën hundën e policisë. Pra, derisa të mos kryhet çarmatimi i përgjithshëm brenda vendit, ne do të jetojmë në gjendje shtetrrethimi.

Përktheu nga serbishtja: Nikolla Sudar

Dhjetë vjet më parë u nda nga jeta përkthyesi i shquar Ramon Sanchez

SPANJOLLI QË E DESHËM TË GJITHË

Homazh për Ramon Sanchez-in

Nga Mira Meksi

Etakova në verën e vitit 1984 në shtëpinë botuese "8 Nëntori", kur, e porsadalë nga studimet universitare, iu bashkëngjita aradhes së punëtorëve të përkthimit të veprave të Enver Hoxhës në gjuhë të huaja. Ishte militant marksist-leninist, kishte katër vjet që punonte aty si redaktor në redaksinë e spanjishtes, qe spanjolli i parë në botë që njihja e që dukej sikur kishte dalë nga ndonjë faqe romani spanjoll i paraluftës për të përfaqësuar tërë racën e tij asturiase: truplartë, me ballë të lartë e mustaqe të plota ala Maupassant dhe me një emër të fshehë lufte, që i bënte nder portretit të tij: *Karlos*. Asaj kohe e pati mbaruar misionin e tij në Shqipëri, po kthehej në vendin e tij dhe stafetën e punës redaktoriale po ia linte një tjetër militanti spanjoll marksist-leninist, katalanasit që e pati zgjedhur emrin e tij të luftës ca më prozaik akoma, duke e marrë nga soji i shkrimtarëve barcelonas, që ishte *Andreu Martin*.

Në redaksinë e spanjishtes, që drejtohej nga Skënder Vuçini autoritar, pjesë e së cilës nisa të isha edhe unë, ndenja shumë pak kohë me Carlos-in tonë (kafet që pimë u numëruan me gishta), por mbaj mend mirë dy gjëra, që mund t'i shtohen portretit që bëra më lart: bllokun e përhershëm, nga i cili dukej sikur nuk ndahej një çast, dhe cigaren e markës franceze "Gitanes", nga e cila vërtet nuk ndahej kurrë, në kutinë intriguese të së cilës shfaqej një figurë e kaltër valltareje cigane, e mbështjellë nga një tym i bardhë. Mbaj mend se pyetja që i bëra për të, shpërtheu një rrëfim të gjatë e të papritur historik mbi atë markë cigaresh të hedhur në treg qysh në vitin 1910 e që pati ndërruar pamje gjithsaherë, ndonëse përherë kishte shenja dhe simbole spanjolle si *mantilla* etj. Më tregoi gjithçka, madje edhe emrin e disenjatorit të figurës së parë të paketës "Gitanes", dhe këtë e bëri me aq elegancë dhe gjuhë të pasur e të detajuar, por edhe me një lloj çapkënllëku dhe humori të hollë, që më mrekulloi tërë kohën që zgjati rrëfimi, gjersa në fund, për ta mbyllur, më tha jo pa një lloj krenarie dhe duke qeshur se "Gitanes" qe cigarja e Jacques Prévert-it, Albert Camus-së, Julio Cortázar-it dhe të tjerë shkrimtarëve dhe artistëve të famshëm. Dhe kështu, sa herë gjatë tërë miqësisë sonë 28-vjeçare do të vihej të më rrëfente diçka, përherë e bënte këtë me aq përkushtim, mjeshtëri, detajizime dhe humor, sa përherë më mrekullonte. Ndërsa blloku qe një pasuri e tërë në lëmin e përkthimit: aty Ramoni (pas kthimit në vendin e tij morëm vesh se emri i vërtetë i Carlos-it ishte *Ramon*) kish shtrirë tërë eksperiencën e tij katërvjeçare në përkthimin dhe redaktimin e teksteve, kryesisht politike, nga shqipja në spanjisht. Mbaj mend po ashtu se në bagazhin e tij, kur u largua po atë vit nga Shqipëria, kishte dhjetëra libra nga letërsia shqipe: Ramoni po linte pas fatin e përmbushur të militantit marksist-leninist dhe po i projektonte vetes një fat letërsie. Aty nga viti 1987, kur Ramoni iu fut seriozisht punës së vështirë të përkthimit letrar nga shqipja në spanjisht me veprën e Kadaresë, duke shkelur në udhë krejtësisht të panjohura (qe hera e parë që përkthehej drejtpërdrejt letërsi shqipe në spanjisht), blloku i tij i përhershëm u kthye "në një katalog të vogël, por të çmuar me zgjidhje dhe ekuivalenca, si dhe me shtigje që çonin në ndonjë përgjigje për pyetjet e shumta që po më dilnin gjatë punës së përkthimit", siç thotë ai vetë në librin "*Shqipëria në pasqyrën e letërsisë*".

Ishte viti 1991 dhe ndodhesha në Tarazona të Spanjës, në Shtëpinë e Përkthyesve, ku i qeshë futur punës së vështirë të përpilimit dhe përkthimit të një antologjie të poezisë bashkëkohore shqipe dhe ku ndihma e Ramonit, i cili erdhi disa herë për të punuar me mua në Tarazona, qe vërtet e çmuar, kishte raste dhe shpëtimtare; sipas shkrimeve dhe vlerësimeve që u bënë, doli të qe një nga antologjitë më të rëndësishme të poezisë shqipe botuar jashtë kufijve të Shqipërisë atyre viteve. Qe koha kur përpiqesha të përktheja në shqip mjeshtrit e letrave hispanoamerikane, kur rrekesha të botoja shkrime në shtypin spanjoll të kohës, me ndihmën e Ramonit, për

Është një nga kujtimet më të bukura që kam me Ramonin dhe që e përmendnim shpesh të dy, sepse në mbarim të ceremonisë së prezantimit të "*Pallatit të ëndrrave*", në një sallë të vogël të pallatit "Gaviria", ndezëm të katër së bashku një shandan - si shenjë bashkimi - e më pas Ramoni dhe unë dëgjuam nga Kadarenjtë fjalët: "Do të kthehemi sa më shpejt që të jetë e mundur në Shqipëri."

të bërë të njohur letërsinë shqipe dhe kur botoja poezi shqipe në spanjisht; qe koha kur takoja Gabriel Garcia Marquez-in në Barcelonë dhe kur Ramoni përkthente në spanjisht shkrimin tim të ndjeshëm për takimin me të dhe ia dërgonte Carmen Balcels-it, agjentes së tij letrare, me qëllim që të zbuste zemërimin e saj ndaj botimeve pirate në shqip të kolumbianit të madh.

Më kujtohet që më 23 shtator të atij viti, në sallonet e pallatit të famshëm "Gaviria" në Madrid, bëhej prezantimi i "*Pallatit të ëndrrave*" të Kadaresë në spanjisht, përkthyer nga Ramon Sanchez Lizarralde dhe botuar nga Muchnik, në një ceremoni ku qe ftuar dhe autori. Kishte pothuaj një vit që Kadareja kish braktisur Shqipërinë dhe qe strehuar në Francë, me një akt që synonte të bëhej kambana e alarmit në botë kundër diktaturës komuniste shqiptare, e cila vazhdonte të rezistonte ende, duke lënë një boshllëk të madh tek intelektualët shqiptarë. Ftesës së Ramonit për të marrë pjesë në ceremoni iu përgjigja vetëtimthi dhe fluturova drejt Madridit. Emocioni qe i madh jo vetëm pse takova Kadarenjtë pas një viti të gjatë e të vështirë ndarjeje dhe përjetova një klimë të përndezur feste, ku shumëkush nga personalitetet e botës së letrave hispanike fliste për shkrimtarin shqiptar si për një kandidat shumë pranë "Nobelit", por edhe pse takova dhe bisedova gjatë me Mario Muchnik-un, botuesin e njohur spanjoll të Kadaresë. Nga hebreu shtatshkurtër, entuziazmi dhe besnikëria e të cilit ndaj shkrimtarit shqiptar vazhdoi shumë gjatë, mësova për përpjekjet e jashtëzakonshme me vite të Ramonit jo vetëm për ta sjellë denjësisht në spanjisht nga origjinali shqip shkrimtarin e madh, por dhe për të gjetur një botues të denjë për ta botuar të përkthyer në spanjisht nga origjinali dhe jo nga frëngjishtja, siç bëhej. Është një nga kujtimet më të bukura që kam me Ramonin dhe që e përmendnim shpesh të dy, sepse në mbarim të ceremonisë së prezantimit të "*Pallatit të ëndrrave*", në një sallë të vogël të pallatit "Gaviria", ndezëm të katër së bashku një shandan - si shenjë bashkimi - e më pas Ramoni dhe unë dëgjuam nga Kadarenjtë fjalët: "Do të kthehemi sa më shpejt që të jetë e mundur në Shqipëri." Tri ditë më pas shkruanim të dy (ndonëse u botua vetëm me emrin tim) artikullin "Vetmia e madhe e Kadaresë" për gazetën "*Heraldo de Aragon*", ku i shpjegonim botës spanjolle të vërtetën e "arratisjes" së Kadaresë nga Shqipëria në vjeshtën e vitit 1990.

I rrëfej këto kujtime, që më prekin shpirtin, sepse mendoj se ato e përcaktojnë më së miri Ramonin tonë, mikun e të gjithë shqiptarëve, i cili, mbi të gjitha, ishte tejqyra e spanjollëve për të parë botën shqiptare: duke njohur si askush tjetër realitetin shqiptar, historinë, kulturën dhe letërsinë shqipe, ai kontribuoi në davaritjen apo zbutjen e paragjykimeve dhe pamjeve të shtrembëruara që spanjollët kishin për botën shqiptare, siç thotë edhe vetë në përmbledhjen e teksteve të tij mbi letrat shqipe, që botuesi i "Onufrit" pati dashamirësinë ta botonte dhe që unë e pagëzova me emrin "*Shqipëria në pasqyrën e letërsisë*".

Ramon Sanchez-i përbën një fenomen më vete si lëvrues i artit të komplikuar të përkthimit letrar: pa kryer studime të mirëfillta filologjike, pa pasur asnjë lloj tradite apo baze të mëparshme përkthimi të letërsisë shqipe në spanjisht ku të mund të mbështetej dhe në kushtet e mungesës së fjalorëve shqip-spanjisht dhe spanjisht–shqip (ky i fundit me plot mangësi është botuar vetëm në vitin 1999), arriti jo vetëm të përkthejë me sukses një pjesë shumë të çmuar të veprës së Kadaresë, por edhe të nderohet me Çmimin Kombëtar të Përkthimit në Spanjë, të japë leksione dhe konferenca të rëndësishme universiteteve të botës mbi përkthimin letrar në përgjithësi dhe atë të veprave të Kadaresë në veçanti, të ketë poste drejtuese në shoqatat e përkthyesve të Spanjës dhe të krijojë një revistë shumë të vlerësuar mbi përkthimin letrar të quajtur "El Trujaman".

Në një shkrim të titulluar "*Të ngratët përkthyes të mirë*" Garcia Marquez-i thotë se ajo që aspirojnë përkthyesit nuk janë dafinat mbi kokën e tyre, porse shmangia e qortimeve dhe "incidenteve". Dhe kjo



është e vërtetë. Por, sidoqoftë, duke qenë përkthimi letrar si një nga punët më të vështira, më anonime dhe më të keqpaguara, përkthyesit janë shumë bashkëpunues dhe solidarë mes tyre. Por bën vaki që nganjëherë të dalin edhe me "krenari të lënduar" nga marrëdhënia e punës me shoqi-shoqin, edhe kur janë miq të vjetër, siç shkruan Ramoni për një aventurë letrare që ndodhi mes tij dhe meje, me Kadarenë në mes, në shkrimin "Përkthyesi i ripërkthyer" dhe që ia vlen të rrëfehet.

Ndodhi që më 1994 Kadareja të zhvillonte një bisedë në Bibliotekën Kombëtare në Madrid mbi "Don Kishotin". Sipas Ramonit, e tëra biseda e tij në shqip ishte e improvizuar (pra nuk ekzistonte tekst i shkruar, me përjashtim të disa shënimeve) dhe përkthimi i saj në spanjisht (i bërë nga Ramoni) u regjistrua, për t'u zbardhur më pas, pa vënë dorë as autori dhe as përkthyesi, dhe botuar në një revistë spanjolle. Vite më vonë, me lejen e Kadaresë dhe për ta botuar në revistën "Mehr Licht", e përktheva nga spanjishtja në shqip të vetmin tekst ekzistues të bisedës së lartpërmendur dhe vetë autori punoi mbi përkthimin tim për t'i dhënë tekstit në shqip vlerën e origjinalit, çka u shënua edhe në botimin e saj në numrin 14 të "Mehr Licht" në vitin 2000. Këtu përfundon edhe marrëdhënia ime me tekstin, Kadarenë dhe Ramonin. Porse më 2001 botohet në shqip "Unaza në kthetra" e Kadaresë, ku është edhe biseda a konferenca në Bibliotekën Kombëtare në Madrid mbi "Don Kishotin", por kësaj here në shënimin që e shoqëron (dhe që nuk ishte formuluar prej meje) shkruhet: "Konferenca është improvizuar nga autori në gjuhën franceze, përkthimi spanjisht i botuar nga shtypi i Madridit mund të merret si i vetmi tekst i shkruar i saj." Dhe në fund: "Përktheu nga spanjishtja Mira Meksi." Kusurin për "mohimin" e tekstit të parë të shkruar nga Ramoni padrejtësisht e mora unë "përkthyesja e përkthyesit" dhe kohë më pas, kur u sqaruam të dy për keqkuptimin, të paktën midis nesh (Ramoni nuk e njihte botimin korrekt të konferencës së parë në "Mehr Licht"), vendosëm që shkrimin e Ramonit "Përkthyesi i ripërkthyer" ta botonim në shqip për hir të aventurës që mbante.

Njerëzit si Ramoni të imponojnë respekt dhe admirim, por edhe të frymëzojnë miqësi të vërtetë. Në lamtumirën që na la ne miqve të tij me anë të një teksti të shkurtër dërguar me *e-mail*, mes të tjerash shkruan se po largohet, përveçse i qetë dhe në paqe, ndoshta edhe me një lloj marramendjeje që shkakton konceptimi i "zhdukjes subjektive", si një nga gjërat më të ftohta dhe më të pakuptueshme të ekzistencës... Por me sa duket kjo "zhdukja subjektive" s'është veçse brenga dhe dhembja e madhe që shkaktoi ikja e Ramonit dhe kujtimi që lindi përnjëherë për të mbushur humbjen për spanjollin që e deshëm të gjithë, së bashku me mirënjohjen e madhe për atë çka bëri për kulturën tonë.

23 korrik 2011

Rodrigo García

LAMTUMIRË GABO DHE MERCEDES

Onufri